

# KUSH NA NËNÇMON?



E kuptuam ose jo se kush na nënçmon, përsëri nuk kemi bërë asgjë nëse nuk e kuptojmë shkakun pse dikush arrin të na nënçmojë neve.

Allahu i Madhërishëm na thotë: **“Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli përderisa ata nuk e ndryshojnë vetveten”**. Nëse synojmë të jemi popull i lartë, i respektuar, i përparuar dhe me ardhmëri të ndritshme, atëherë duhet të zbukurohemi me virtyte të larta, besim të palëkundshëm, vendosmëri në rrugën e vërtetë dhe zell në detyrimet tona të përditshme. Përndryshe, do të bëhemi gjah i lehtë për secilin që dëshiron të luajë me nderin, historinë dhe logjikën tonë.

1. Zoti na ka nderuar me udhëzime në Islam. Sepse nëpërmjet Islamit ne i kemi kuptuar shumë qartë detyrimet tona ndaj Krijuesit, krijesave dhe vetvetes e nuk i kemi dhënë vetëm një kaheje për t'i harruar anët tjera të bukura në gjithësi. Në mesin e shumë porosive, Muhamedi, lavdërimi dhe paqja qofshin për të, na udhëzon: **“Ndaj vetvetes ke detyrime, ndaj Zotit tënd ke detyrime, ndaj mysafirëve ke detyrime dhe ndaj familjes ke detyrime. Plotësoji detyrimet tua ndaj secilit që meriton”**. (Tirmidhiu) Mirëpo, kur këto gjëra nuk shihen të gjalla në mesin tonë, atëherë merr guximin aksh njeri të flasë dhe të tregojë sesi Islami tregon shkujdesje ndaj arsimimit, gruas, përparimit etj.

2. Secili popull ka historinë e vet dhe i lejohet të krenohet – pa i nënvlerësuar të tjerët – për atë që është, ndërsa mendjelehtësi është të krenohet për atë që nuk është. Është e padrejtë të tregohesh i madh duke u munduar ta ulësh tjetrin. Muajin e kaluar këtë marrëzi u mundua ta bëjë Akademia e shkencave dhe arteve në Maqedoni (ASHAM) kur e botoi Enciklopedinë e Maqedonisë duke bërë hesap se populli shqiptar është sikurse politikani shqiptar, sepse në vendet tona – siç thotë R. Qosja – historinë e bëjnë politikanët dhe politikën e bëjnë historianët...

3. Thuajse në çdo medie, në përditshmëri na qesin fall me kafe dhe na ofrojnë të lexojmë parashikimet e horoskopit. A nuk është turp? A nuk është nënçmim i tërë auditoriumit një gjë e tillë? Ku janë të zotët e mendjes të reagojnë? Ç’lidhje ka kafja me dashurinë time? Çfarë ndikimi ka ylli në xhepin tim? Çudi, shumë njerëz kur dëgjojnë fjalët e Allahut nuk i besojnë, madje tallen, ndërsa kur dikush luan me logjikën e tyre dhe sillet me ta sikurse ndaj një budallait, ai e dëgjon me vëmendje dhe i kushton rëndësi të veçantë. Kush më thotë, çfarë dallimi ka midis kësaj injorance dhe injorancës së hershme, kur njerëzit shpresonin në gjithçka përveç nga Allahu dhe kishin frikë nga gjithçka përveç nga Allahu.

Nënçmime ka edhe më shumë dhe nuk është nevoja të numërohen të gjitha. Qëllimi është, le të vetëdijsohemi, që ta kuptojmë se shkakun e gjithë nënçmimeve kthehet tek vetja jonë.

Jeta është përplot sfida, mirëpo me natyrshmëri të pastër, logjikë të shëndoshë, veprim të sinqertë dhe – para së gjithash – me ndihmën e Allahut do ta gjejmë dhe ndihmojmë të vërtetën, pavarësisht se çfarë pluhuri hidhet përreth.

O Allahu, të vërtetën na e bë të qartë dhe na mundëso ta pasojmë atë dhe të pavërtetën na e bë të qartë dhe na mundëso t'i largohemi asaj.

**Në emër të redaksisë: Omer BERISHA**

**AKTUALE**

Kur do të ndalet gjakderdhja? **3-7**  
PAS ENCIKLOPEDIË SË MAQEDONISË FSHIHET  
PYETJA KRYESORE:

“Nuk është me rëndësi kur kanë ardhur  
shqiptarët, por kur do të largohen prej  
Maqedonisë” **8-9**

HEKURUDHA STAMBOLL – MEDINË  
Turqia ndërmerr hapat e parë për të ringjallur  
hekurudhën drejt Hixhazit **10-12**

**KËNDI IM**

Sihri, si të ballafaqohemi me të... **13-15**  
Edukimi i shpirtit **16**

**AKIDE**

Si përkthehet: LA ILAHE IL-LALLAH **17-22**

**FIKH**

SI TA KËRKOSH DIJEN  
Perla dhe margaritarë për nxënësin  
e dijes **22-27**

**AVANCIMI PERSONAL**

Në kërkim të lumturisë **28-29**

**REDAKSIA**

Omer BERISHA – kryeredaktor  
Anëtarë të redaksisë:

Ahmed KALAJA, Bekir HALIMI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Ali SHABANI, Ismail BARDHOSHI,  
Talha KURTISHI, Bledar HAXHIU, Sedat SHABANI, Agron TERZIQI, Lulzim SUSURI, Genc PLUMBI, Zeki ÇERKEZI,  
Enver AZIZI, Bashkim BAJRAMI, Bilal TEQJA.  
Bashkëpunëtorë: Ekrem AVDIU dhe ENIS RAMA  
Roald HYSA – redaktor gjuhësor  
Halil BERISHA – redaktor teknik  
Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio) - ballina  
Sedat RAMADANI - shpërndarje dhe marketing

**Boton: Albislam**

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000  
email: [albislam@gmail.com](mailto:albislam@gmail.com)  
sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827  
Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për  
Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2  
ISSN: 1409-6250  
Tirazhi: 2000

**LIBRI**

Botimi i veprës së Hafiz Ali Korçës – Ngjarje e  
madhe kulturore **30-33**

**FAMILJA**

Një botë ku gruaja sundon fuqiptotë **34-36**  
Si ta kultivojmë logjikën e fëmijës? **36-38**

**TEFSIR**

Adhuroje Allahun deri në vdekje **38-40**

**HADITH**

Astrologjia shkencë apo magji? **41-45**

**BOTA ISLAME**

Republika e Irakut **46-53**

**FETVA DHE KONSULTIME**

Besëtytnitë janë shirk **54-57**

**HISTORI**

Historiku i islamit në Kinë **58-60**

**ABONIMI NJË VJEÇAR**

Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro  
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)  
e-mail: [albislam.abonues@gmail.com](mailto:albislam.abonues@gmail.com)

ALBISLAM DOOEL

Xhironlogaria: 300000002770453  
Komericialna Banka A. D. – Skopje  
Numri tatimor: 4030008038784

Abonimet me euro mund t'i bëni online nëpërmjet shërbimit  
PAYPAL. Të dhënat mund t'i gjeni në [www.revista-albislam.com](http://www.revista-albislam.com)

# KUR DO TË NDALET GJAKDERDHJA?

**Prandaj nuk lejohet që të shndërrohet xihadi te disa grupe në dhunë dhe nëpërkëmbje të gjërave të shenjta. Nuk lejohet që vrasja t'i paraprijë idesë, sqarimit dhe argumentimit.**

Islami është fe e vërtetë dhe puna për forcimin e tij është detyrim, prandaj muslimani duhet të përdorë çdo vepër të ligjshme fetarisht dhe të mundshme për ta arritur këtë qëllim. Mirëpo kjo nuk domethënë të shfrytëzojë çdo vepër, porse atë vepër të cilën e do dhe e pëlqen Allahu. Në këtë mënyrë njeriu e arrin qëllimin me pasojat më të vogla të mundshme dhe pa e kundërshtuar sheriatin.

Armiqtë përpiqen dhe hulumtojnë shkaqet me të cilat do të arrijnë pengimin e ecurisë së të vërtetës, apo shëmtimin e pamjes së atyre që veprojnë për këtë kauzë. Muslimanit nuk i lejohet që t'ua ofrojë atyre këto shkaqe, madje duhet të largohet maksimalisht prej tyre, e gjitha kjo në shërbim të realizimit të qëllimit, mbetjes së tij i pastër dhe larg nga çdo ndotje dhe t'i dështojë kurthet e armiqve.

Akoma jemi duke parë herë pas herë ballafaqime të rastësishme, të pallogaritura dhe konflikte të pabarabarta, të cilat disa herë i shkaktojnë disa islamistë e herë të tjera armiqtë e muslimanëve. Në këtë rast media luan një rol shumë të fëlliqur, duke ia veshur të gjithë këto gjëra muslimanëve dhe duke i shtrembëruar faktet, e me këtë sikurse dëshirojnë të tregojnë se qëllimi i tyre është mbetja e pamjeve të kufomave të hedhura në rrugë



veçori e vendeve islame dhe sikur e kanë si qëllim t'u tregojnë të gjithëve sa i lirë është gjaku i muslimanëve!

Këto kontribute dhanë fryte. Nuk ka mbetur armik i Islamit në lindje apo perëndim, i cili nuk është përgatitur për t'u zhytur në gjakun e muslimanëve nën parullat e fabrikuara dhe të rrejshme, siç janë “lufta kundër dhunës”, “ballafaqimi me terrorizmin” etj. Këto gjëra ia shtojnë edhe më shumë umetit vështirësitë dhe sprovat që po kalon.

Është e vërtetë se në kohë trazirash faktet nuk janë të qarta, përzihen flamujt dhe konceptet, dhe është shumë e vështirë të ndërlihen veprime të caktuara me synimet dhe synimet me mjetet. Prandaj nuk lejohet që të shndërrohet xhihadi te disa grupe në dhunë dhe nëpërkëmbje të gjërave të shenjta. Nuk lejohet që vrasja t'i paraprijë idesë, sqarimit dhe argumentimit. Nuk lejohet që dikush të mendojë se hapësira islame ka nevojë për shtimin e gjakderdhjes në vend të ndalimit të gjakderdhjes, atëherë kur shtohet padrejtësia. Nuk lejohet që të provokohen islamistët dhe të bien në kurth e të futen në ballafaqime për të cilat nuk janë përgatitur.

Nuk duhet disa islamistë të largohen nga xhihadi i vërtetë dhe rezistenca kundër okupatorëve, gjë të cilën dijetarët e këtij umeti e kanë sqaruar shumë mirë, duke i treguar rregullat fetare dhe të shkaktajnë kaosin dhe destabilizimin në vendet e sigurta muslimane me pretendime për të cilat nuk ka fakte fetare.

Nuk duhet të provokohet armiku pa nevojë në vende ku muslimanët kanë probleme sektare apo nacionale. Nëse i analizojmë rezultatet e këtyre veprimeve mund të vërejmë disa shenja dhe arsye për përzjerje të flamujve dhe koncepteve:

Muslimanët që ishin një “shenjtëri që

## “...Nuk duhet të provokohet armiku pa nevojë në vende ku muslimanët kanë probleme sektare apo nacionale...”

nuk preket” u shndërruan në “qëllim legal”.

Në Irak, irakianët sunitë vriten nga okupatorët, ekstremistët shiitë, madje edhe nga disa grupe islamiste sunite. Në Somali, vriteshin somalezët nga okupatorët e huaj, pastaj Etiopia, kurse pas largimit të tyre nuk u ndryshua gjendja, vazhdoi lufta mes dy grupeve somaleze, secili prej tyre e konsideron veten islamik. Në Pakistan, ushtria pakistaneze vret popullin e vet dhe i largon nga vendbanimet e veta, u hidhen granata mbi kokë njerëzve të pafajshëm, e askush nuk e di pse dhe kush i hedh ato. Kush vritet në këto raste? Ai ose është mik i talebanëve, ose bashkëpunëtor i të huajve ose ushtar i ushtrisë pakistaneze?!

Para kësaj kohe disa muxhahidinë afganë u bashkuan në luftën kundër sovjetikëve, e pas fitores disa radhë u ngritën kundër radhëve të tjera dhe luftuan mes vete. Në shumë shtete islame, siç janë Jemeni, Arabia Saudite, Maroku, Algjeria u realizuan disa aksione të çmendura dhe të pa llogaritura, ku në shumicën e rasteve muslimanët qenë viktimat, pa ndonjë gabim apo ndonjë arsye.

Ata nuk i sqaruan umetit, se si mund të fitojë Islami duke vrarë muslimanë dhe duke lejuar nëpërkëmbjen e gjakut dhe të pasurisë së tyre?! Ata gjithashtu nuk i sqaruan umetit pse vrasjen e muslimanëve dhe trishtimin e njerëzve të pafajshëm e konsiderojnë fitore, ose “betejë në rrugë të

Allahut”?!)

A u lejohet këtyre njerëzve ta tejkalojnë ajetin kuranor: **“...dhe mos mbytni veten tuaj** (duke mbytur njëri-tjetrin). **Vërtet, Allahu është i mëshirshëm për ju. Kush bën këtë** (që ndaloi Zoti) **qëllimisht dhe tejkalon kufijtë, Ne do ta hedhim atë në një zjarr të fortë. Dhe kjo është lehtë për Allahun**”. (Nisa: 29-30).

Imam Taberiu në tefsirin e tij thotë: **“dhe mos mbytni veten tuaj** (duke mbytur njëri-tjetrin)“, domethënë: mos vritni njëri tjetrin duke qenë të një feje, të një besimi dhe të një thirrjeje. Allahu i Lartësuar i bëri muslimanët një tërësi, prandaj ai që vret dikë është sikurse të ketë vrrarë vetveten”.

Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e ka qortuar ashpër personin që vret një musliman, duke thënë: **“Çdo mëkat Allahu e fal përveç atij që vdes si idhujtar, ose një besimtar që e vret ndonjë besimtar me qëllim. Ai që vret një besimtar (në kohë trazirash) dhe gëzohet me këtë vrasje, Allahu nuk pranon prej tij asnjë vepër, qoftë e madhe ose e vogël. Besimtari do të vazhdojë të jetë i mirë dhe me shpinë të lehtë (i pangarkuar), përderisa nuk prek gjak të ndaluar, e kur prek gjak të ndaluar ai shkatërrohet**”. (Sahih, e përcjell Ebu Davudi).

Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: **“Po qe se të gjithë banorët e qiellit dhe tokës marrin pjesë në derdhjen e gjakut të një besimtarit Allahu do t’i hedhë në zjarr**”. (Sahih, Tirmidhiu).

Abdullah ibën Amri, *radijallahu anhu*, tregon e thotë: E pashë Pejgamberin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, duke u rrotulluar rreth Qabes dhe thoshte: **“Sa e këndshme je dhe sa aromë të këndshme ke. Sa madhështore je dhe sa e shenjtë je. Pasha Atë që në Dorën e Tij është shpirti i Muhamedit, shenjtëria e besimtarit është**

**më e madhe tek Allahu se sa shenjtëria jote, pasuria dhe gjaku i tij**”. (Sahih, Ibën Maxhe).

Sprovimi i njerëzve në bazë të disa pikëpamjeve dhe metodologjive që bartin ata e jo në bazë të Fesë Islame, e nëse ata i pranojnë këto pikëpamje, shpëtojnë dhe ruajnë gjakun e tyre e nëse refuzojnë, atëherë derdhja e gjakut të tyre është e lejuar, kurse fotot e tyre paraqiten në internet, si “vrasje e renegatëve”. Edhe pse e shikuar fetarisht divergjencia mes dy grupeve të muslimanëve, kurrsesi nuk do të thotë mallkimi i njëri-tjetrit, edhe nëse kjo divergjencë arrin deri në luftë mes tyre.

Allahu Fuqplotë thotë: **“Nëse dy grupe besimtarësh tentojnë të luftojnë ndërmjet vete, ju pajtoni ata, e në qoftë se ndonjëri prej tyre e sulmon tjetrin, atëherë luftojeni atë grup që vërsulet me pa të drejtë, derisa t’i bindet udhëzimit të Allahut, e nëse kthehet, atëherë bëni pajtimin me drejtësinë ndërmjet tyre, mbani drejtësinë, se vërtet Allahu i do të drejtin**”. (Huxhurat: 9).

Allahu Fuqplotë në këtë ajet nuk e largoi cilësinë e besimtarit nga asnjë grup, edhe në qoftë se njëri prej tyre është grupi, i cili ka bërë padrejtësinë.

Mirëpo këdo që i kundërshton këto pikëpamje, ose refuzon të hyjë në këto flamuj të konsiderohet renegat, kjo pa dyshim është tejkalim i përkufizimeve fetare dhe nëpërkëmbje e shenjtërive të garantuara.

Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dërgoi një ekspeditë te një popull idhujtar. U ballafaquan dhe luftuan me ata. Një idhujtar kur synonte ndonjë besimtar luftonte kundër tij dhe e vriste. Një musliman e shfrytëzoi një pakujdesi të tij, e ky ishte Usame ibën Zejdi, dhe e ngriti shpatën për ta vrrarë. Në këtë moment ai

shqiptoi shehadetin duke thënë: la ilahe il-lallah, mirëpo ky e vrau. Kur erdhi lajmëtari te Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dhe i tregoi se si ishte zhvilluar lufta, mes të tjerave i tregoi edhe këtë rast. Atëherë Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e thirri Usame ibën Zejdin dhe e pyeti: Pse e vrave? Tha: Vrau shumë muslimanë, e vrau filanin dhe filanin dhe përmendi emrat e disa njerëzve, që kishte vrari ai njeri. Unë për këtë edhe e sulmova, e kur e pa shpatën te koka e tij tha: la ilahe il-lallah. Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i tha: E vrave? Tha: Po! Çfarë do të bësh me “la ilahe il-lallah”-un e tij në Ditën e Gjykimit? I tha: O i Dërguar i Allahut, kërko falje për mua. Ai përsëri tha: Çfarë do të bësh me “la ilahe il-lallah”-un e tij në Ditën e Gjykimit? Vazhdoi ta përsërisë disa herë këtë shprehje: Çfarë do të bësh me “la ilahe il-lallah”-un e tij në Ditën e Gjykimit?” (Muslimi).

Ata që bëjnë këso veprimesh i shtojnë armiqtë dhe rrethohen nga të gjithë.

Kjo i bën ata kafshatë më të lehtë para një lloji tjetër të armiqve të muslimanëve, sikurse është rasti me Iranin, i cili kujdeset maksimalisht për të hapur kanale komunikimi me këto lloje njerëzish për të depërtuar brenda tyre dhe për t'i mashtruar, duke iu ofruar përkrahje dhe strehim. Pastaj i shtyn disa prej tyre për të realizuar synime të veta, i shfrytëzon për të realizuar politika të caktuara, kurse të tjerët i fut nëpër burgje. Ku është në këtë rast ai që pretendon se ka flamurin e paqes?! Kurse historia na dëshmon se liderët e shiitëve gjatë etapave të ndryshme të jetës së gjatë të Umetit kanë qenë armiqtë më të rrezikshëm të Fesë Islame dhe muslimanëve.

Me këto veprime ata u japin hapësirë armiqve të Islamit për të realizuar komplotet dhe planet e tyre, për të

**“...Të takohesh me armiqtë e Fesë Islame në shkaktimin e dëmit të disa vendeve muslimane dhe popullit musliman është një gjë shumë e rrezikshme, nuk paralajmëron lajme të mira...”**

harxhuar kapacitetet e umetit, prangosjen, bllokimin dhe shkapërderdhjen e këtyre kapaciteteve.

Sidomos me ato aksione kaotike, ku synohen civilët e pafajshëm në shtetet arabe apo perëndimore. Ata si duket nuk e dinë, ose nuk e kanë kuptuar politikën e disa shteteve perëndimore, të cilat mbështeten në parimin e “sigurimit të arsyeve”, sepse sistemi demokratik, i cili sundon në ato vende i jep opinionit publik një pushtet të dukshëm. Prandaj kur nuk kanë arsye të mjaftueshme për të justifikuar politikat e tyre para opinionit publik, atëherë shërbimet sekrete marrin përsipër të sigurojnë arsyetime të përshtatshme. Ai që s’e kupton këtë detaj në konstelacionin politik perëndimor, nuk do të ketë mundësinë më pas të formojë pikëpamje të sakta mbi fitoren apo dështimin, sepse nuk do të mund të gjejë një betejë ku të dyja palët do ta festojnë fitoren pas përfundimit të saj.

Shembulli më i afërt është ajo që ndodhi me njëmbëdhjetë shtator të vitit 2001. Ata që e realizuan aksionin e festuan këtë aksion si fitore të madhe, kurse në anën tjetër shumica e analizave serioze tregojnë se shërbimet sekrete kanë luajtur një rol shumë të madh në lejimin e

ndodhjes së këtij shpërthimi, sepse neo-konservatorët kishin përgatitur një listë të madhe të qëllimeve, të cilat fillonin me Afganistanin dhe nuk përfundojnë me Irakun, për të cilat përgatitën sigurimin e arsyeve për të filluar realizimin e këtyre qëllimeve. Ky rast ua siguroi këto arsyetime.

Kjo e vërtetë na shpie te një e vërtetë tjetër. Disa aksione që i marrin përsipër ato grupe, pasi ndodhin shkaktojnë mundësi të llojllojshme, se kush mund të jetë realizuesi i tyre.

Analizat e ndryshme paraqesin edhe palë të ndryshme dhe të kundërta. Disa thonë se i ka bërë okupatori, disa thonë se i ka bërë Mosadi, disa thonë se i ka bërë shërbimi sekret iranian etj. Domethënë përzjerja e interesit dhe e synimeve janë bërë aq të komplikuar, saqë është shumë e vështirë të përcaktohet përfituesi kryesor nga këto aksione. E kjo gjë parashtron edhe dilemën rreth mekanizmit që pasojnë ato grupe në përcaktimin e interesit dhe të dëmit!

Të takohesh me armiq të Fesë Islame në shkaktimin e dëmit të disa vendeve muslimane dhe popullit musliman është një gjë shumë e rrezikshme, nuk paralajmëron lajme të mira. Ish-ministrja për punë të jashtme e Amerikës **Kondolea Rajs** para disa vitesh foli rreth një strategjie me titull “Kaosi i madh” në shtetet islame, që domethënë: ndarje dhe rregullimi i tyre sipas hirit amerikan dhe kjo nuk është diçka e huaj për ta. Mirëpo ajo që është për t’u habitur është përvetësimi i kësaj metode nga ana e disa islamistëve, të cilët synojnë kaosin në disa shtete arabe dhe islame për të dërguar aty forcat e ndryshme jobesimtare dhe shndërrimi i këtyre vendeve në mejdane luftërash, ku sipas mendimit të tyre do të realizohet fitorja. Ky pikëtakim i

çuditshëm jep një konstatim të rrezikshëm. E ky konstatim është se veprimet e këtyre rrymave në shumicën e rasteve janë shndërruar në “etapa” apo “hapa” të domosdoshme të planifikuesit perëndimor, i cili harton strategji afatgjata për të ri-vizatuar hartën e botës islame. E thënë ndryshe: nëse këto grupe i ndërpresin këto veprime, atëherë armiq të etim do të kenë nevojë të hulumtojnë alternativa të tjera për këtë detyrë dhe për të çuar më tutje planet e tyre.

Një musliman me besim të vërtetë nuk mund të del karshi thirrjes në fe të Allahut, ose karshi rezistencës kundër armiqve që sulmojnë vendet muslimane, ose të ndalojë atë që flijon çdo gjë për ta ngritur këtë fe, sepse Allahu Famëmadh, na ka krijuar vetëm për këtë qëllim, sikurse edhe ka thënë: **“Unë i krijova xhinët dhe njerëzit që të më adhurojnë”**. (Dharijat: 56). Për këtë gjë Allahu edhe na ka dhënë furnizim me pasuri të ndryshme. **“Dhe jepni për në rrugë të Allahut e mos e hidhni veten në rrezik dhe bëni mirë, se me të vërtetë Allahu i do bamirësit”**. (Bekare: 195).

Mirëpo e tërë kjo nuk mund të realizohet sipas përfytyrimeve personale ose shpresave të parregulluara me argumente fetare të urta dhe dispozitave të drejta të shariatit.

Allahu ynë, caktoi këtij umeti udhëzim, udhëzo të devijuarit e këtij umeti, ndale gjakderdhjen mes muslimanëve, ruaje fenë dhe sigurinë e tyre, ruaji nga kurthet e armiqve të brendshëm e të jashtëm, sepse Ti e ke këtë fuqi dhe i përgjigjesh lutjeve tona. Amin! ■

*Editoriali i revistës  
“El Bejan” nr. 265, shtator, 2009*

**Përktheu: Bekir HALIMI**

Pas Enciklopedisë së Maqedonisë fshihet pyetja kryesore:

# “NUK ËSHTË ME RËNDËSI KUR KANË ARDHUR SHQIPTARËT, POR KUR DO TË LARGOHEN PREJ MAQEDONISË”

Mbeturinat e politikës së Slobës, me sa duket në Maqedoni paraqiten me ndikim të vonuar. Në kohën kur serbët kuptuan se ku i çoi politika e tyre ndaj shqiptarëve, tek ne skanerët e Gruevskit i zbuluan SHIPTARËT

NIKOLLA MLLADENOV

Në maqedonasit jemi një popull i çuditshëm. Tek popujt e tjerë të Ballkanit njihemi si shkupjanë, bullgarë të Maqedonisë ose si serbë me të meta në të folur. Jemi trima edhe pse mobilizimit në 2001-shin nuk iu përgjigjën as dhjetë për qind e trimave më me famë. Në vitin 2002 e kthyem në pushtet **Brankon**, sepse nuk deshëm që vendin tonë ta ndajë **Ljubçoja** mes Shqipërisë dhe Bullgarisë. Pas ardhjes në pushtet rejtingu i LSDM-së morri të tatëpjetën, kur filloi zbatimin e marrëveshjes kornizë të Ohrit, marrëveshje e cila u nënshkrua për të parandaluar ndarjen e vendit. Ndarja e re e territoreve të komunave na shkaktoi neveri, por jo dhe aq, që të dalim në referendumin që asokohe e organizoi **Gruevski**. Çareja e kësaj mesele ishte glorifikimi i Gruevskit, i cili kërkoi një moratorium katër vjeçar për çështjet etnike. Nuk po i shihet fundi, as zbatimit të marrëveshjes së Ohrit, ndërsa na paralajmërohet edhe moratoriumi i saj, sepse gjoja nuk është e finalizuar. Vëllezër dhe shokë, kjo asses nuk do të ndodhë ashtu siç planifikoi “rilindësi”. Këto veprime janë vetëm një prej provave për natyrën e tij, natyrën e njeriut, i cili premton se të gjithë do t'i vërë në majë të gishtit, por nuk e di se si?

I ashtuquajturi Rilindësi erdhi me flatrat e shpresës së popullit dhe me pretendimin se popullit maqedonas do t'ia drejtojë përsëri shpinën dhe do t'ua kthejë krenarinë e humbur, në veçanti në lidhje me shqiptarët dhe mentorët e tyre të huaj. Kuptohet kushti i parë ishte eliminimi i **Ahmetit** nga qeveria,



sepse kuptohet, me terroristët nuk bëhet koalicion. Por çka ngeli nga ajo dëshirë? Derisa i shkonte sipas qejfit të Gruevskit, **Thaçi** përshëndetej me duartrokitje dhe quhej “vojvoda”, që më vonë do të transformohej në të keqen e paparë, ndaj së cilës edhe Ahmeti duhet të ketë zili.

Ju faleminderit për pyetjen, e di që Ahmeti tanimë prej një viti është pjesë e qeverisjes, por kjo nuk do të thotë që Gruevski ka hequr dorë nga synimi i tij të prodhohë një shqiptar me “pamje njerëzore”. Pasi e përqafoi Ahmetin filluan të përhapen fjalë, se qëllimi i tij është diskreditimi i Ahmetit, i cili pastaj do të zëvendësohet me **Selmanin**. Me propagandën e tij primitive arriti t'i bindë përkrasësit e tij, se me shqiptarët luan një lojë të dyfishtë. Dolën të kota ishin që t'i shpjegohej atij, se kjo lojë e dyfishtë është mënyra më e shpejtë e homogjenizimit të shqiptarëve në baza etnike. Tani ndodhi enciklopedia. Më intereson çfarë ndodhi me boshtin e pathyeshëm kurrizor të maqedonasve. Pas vetëm gjashtë ditë nën presionin e shqiptarëve, amerikanëve dhe



britanikëve enciklopedia shkon në remont.

Sidoqoftë ASHAM-i e meriton një lëvdatë. Falë nxitimit të saj doli në shesh gjoja patriotizmi i disa akademikëve. Ekipi i **Blazhe Ristovskit** e vërtetoi atë që shumëkush nuk dëshironte ta shihte. Pas brengës për emrin e shtetit fshihej dëshira për vonimin e hyrjes në NATO, aleancë kjo e cila është armë kriminele e globalizimit, proces ky i cili si pasojë e natyrës së tij kundërthënëse shkaktoi luftën në vitin 2001. Gruevski me rastin e publikimit të enciklopedisë në fjalimin e tij theksoi se kjo enciklopedi është skaneri autentik dhe i gjithanshëm i realitetit tonë. Ne si duket tani kemi hyrë në matricën e politikës së Milosheviqit, nga e cila Serbia vuan edhe sot. Mbeturinat e politikës së Slllobës, me sa duket në Maqedoni paraqiten me ndikim të vonuar. Në kohën kur serbët kuptuan se ku i çoi politika e tyre ndaj shqiptarëve, tek ne skanerët e Gruevskit i zbuluan SHIPTARËT. Pse hidhërohen kur ashtu thirren mes vete ishte pyetja jonë. Edhe mes vete thirremi makedonçinja (maqedonas të vogël), por nuk duam që me atë emër të thirremi edhe nga bota. Pasi mori fund fushata e Rankoviqit shqiptarët u shprehën se nuk pranojnë të emërohen me këtë term (shiptari), të cilit shpeshherë i bashkëngjiten përemrat “i trashë” dhe “i fëlliqur”. Nga e morëm atë të drejtë, që t’ia ndërrojnë dikujt emrin, kur anembanë botës dëgjohen piskamat dhe ulërimat tona nga grekët, që dëshirojnë të na ri-emërojnë.

Kuptohet puna e skanerit nuk u ndal këtu. Ai nuk e harroi tezën e Sheshelit sipas të cilës shqiptarët në Maqedoni kanë ardhur para katër shekujsh. Edhe po të ishte i saktë ky pohim, a thua vallë e njëjta përgjigje do të ishte adekuate nga ana intelektuale ndaj provokimeve të kohëpaskohshme shqiptare për ardhjen tonë prej përtej Karpateve? Çfarë rëndësi ka kjo, kur në botën e sotme edhe spanjollit, i cili ka ardhur dje në Maqedoni, me marrjen e nënshtetësisë maqedonase i gëzon të gjitha të drejtat sikurse ata që në Maqedoni

## “Ahmeti tanimë prej një viti është pjesë e qeverisjes, por kjo nuk do të thotë që Gruevski ka hequr dorë nga synimi i tij të prodhojë një shqiptar me “pamje njerëzore” ....”

jetojnë prej 10,000 vjet para Lekës. Mos vallë duhet ai që ka ardhur më vonë në vendin tonë t’i paguajë qira atij që ka ardhur më herët. Mos vallë me këtë logjikë do ta ndërtojmë popullin politik maqedonas, pas të cilit gjurmojnë shkencëtarët në hulumtimet e tyre gjoja shkencore.

Më falni, por pas kësaj që ndodhi u binda se për ASHAM-in nuk është me rëndësi periudha e ardhjes së shqiptarëve, por koha kur ata do të largohem prej Maqedonisë? Këto janë edhe indikatorët e fluturimeve të “bumbarëve” të TV Sitelit për mendimin publik të preferuar nga qeveria. Ngeli vetëm që në enciklopedinë e “zgjeruar dhe të plotësuar” të përfshihen me ofendime edhe vllahët, të cilët nëse nuk e keni ditur, kanë ardhur së bashku me SHIPTARËT (malësorët) dhe së bashku me ta duhen edhe të largohen.

E di se për shumicën e maqedonasve është e vështirë edhe vetëm të lexohet e jo më edhe të pranohet fakti se me parandalimin e urrejtjes ndaj shqiptarëve, që ushqehet sistematikisht nga disa qarqe do t’i arrijmë më shpejt synimet e proklamuarra; NATO-n dhe BE-në. Kësaj urrejtjeje, si element i pandarë i bashkëngjitet edhe antipatia ndaj Perëndimit, i cili për shumicën ka konsiderata të posaçme, përpos për maqedonasit. Kjo logjikë e Kalimeros i përshtatet fëmijëve e jo popujve që pohojnë se e kanë kuptuar botën në të cilën jetojnë... ■

**Editoriali i revistës “Fokus” të publikuar më 25 shtator 2009**

**Përktheu: T. KURTISHI**


# HEKURUDHA STAMBOLL – MEDINË TURQIA NDËRMERR HAPAT E PARË PËR TË RINGJALLUR HEKURUDHËN DREJT HIXHAZIT

Turqit këtë projekt e kanë emërtuar “projekti i shekullit” ose “ura e vëllazërisë”, pasi shpresojnë se do të jetë një lidhje, që do t'i rikthejë raportet e forta turke-arabe në të gjitha nivelet.

## ISLAMTODAY/PRESS

Turqia filloi hapat e parë për të ringjallur hekurudhën drejt Hixhazit, vijë e cila më parë lidhte shtetin osman dhe rajonin e Hixhazit dhe kjo 93 vjet pasi treni i fundit u nis nga Damasku dhe u ndal në stacionin e Medinës së Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Një zyrtar turk informon se puna në

këto ditë po ecën shpejt, që të përfundojë etapa specifike nëpër tokën turke - kështu bën të ditur gazeta turke “Zaman” (15.09.2009). Suat Hajri Aka, zv. Sekretar i ministrit të transportit të Turqisë, me rastin e një iftari në Ankara të organizuar nga Shoqata turke-amerikane e biznesmenëve u shpreh: “Veprimi në projektin e hekurudhës drejt Hixhazit u bë shumë shpejt, me



meritën e bashkëpunimit të shteteve nëpër të cilët do të kalojë hekurudha”; ai uroi gjithashtu se: “do të jetë një vijë që do t’i japë jetë dhe fuqi raporteve tregtare dhe kombëtare midis popujve të këtyre vendeve”. Suat Hajri theksoi se: “pas përfundimit të këtij projekti, të cilin ne e konsiderojmë si rrugë të paqes dhe begatisë për këtë anë, treni që do të niset nga Stambolli do të arrijë në Medinë për 24 orë”.

Turqit këtë projekt e kanë emërtuar “projekti i shekullit” ose “ura e vëllazërisë”, pasi shpresojnë se do të jetë një lidhje, që do t’i rikthejë raportet e forta turke-arabe në të gjitha nivelet. Ai do të fillojë nga veriu i Stambollit drejt jugut për të kaluar nëpër tokat e Sirisë dhe Jordanisë, që të arrijë kështu në stacionin e fundit në Medinë, duke përshkuar 3000 km.

Kjo hekurudhë ne versionin e vjetër të saj fillonte nga Damasku deri në Medinë, e cila kishte filluar të ndërtohet në vitin 1900 në kohën e sulltan Abulhamidit II. Qëllimi i saj ishte të lidhte Stambollin me tokat e veta në vendet arabe, që të arrinte deri në Medinë dhe Mekë. Mirëpo ngjarjet historike, të cilat ndodhën pas përfundimit të etapës së projektit Damask-Medinë, nuk lejuan të përfundohen etapat e tjera, pasi u prish gjithçka me planin e hartuar nga spiuni britanik i njohur me emrin “Lorenci i Arabisë” për të ndërprerë kështu ndihmat, të cilat nëpërmjet asaj hekurudhe do të arrinin shumë shpejt të forcat osmane në Hixhaz gjatë Luftës së Parë Botërore.

Ai gjithashtu përmendi se administrata publike e hekurudhave në Turqi, tashmë ka filluar realizimin e rolit të saj në këtë projekt gjigant, duke e inkuadruar linjën tani ekzistuese prej Edrene për Stamboll dhe duke vazhduar ndërtimin e linjës prej Stambollit për Ankara dhe Konja, dhe përkujtoi se Siria dhe Jordania realizimin e pjesës së tyre do ta fillojnë në vitin 2010,

**“Kur Sulltani vendosi ta ndërtojë këtë udhë, me qëllim që t’ua lehtësojë rrugëtimin haxhilerëve, të cilët vërtiteshin me javë e muaj nëpër lugina dhe male, që të arrijnë në vendet e shenjta, të gjithë e konsideruan këtë hekurudhë si projekt i parë i umetit...”**

ndërsa do të përfundojë ky projekt në Arabinë Saudite me fillimin e vitit 2012. Këtë nismë turke që e bëri me dije vitin e kaluar kryetari turk Abdullah Gyl numërohet si e para, e cila po merr dritën jeshile të realizimit për të ringjallur projektin e hekurudhës drejt Hixhazit, pas shumë nismave të mëparshme, që nuk u realizuan dot. E gjithë kjo me kujdesin e kryetarit Gyl dhe qeverisë (Partia për Drejtësi dhe Zhvillim) për t’i forcuar lidhjet me botën arabe – u shpreh Suat Hajri Aka.

Megjithëse ky është një projekt gjigant, qoftë nga ana e shpenzimeve dhe punës që do të bëhet, apo nga ana e përfitimeve të mëdha që priten me forcimin e raporteve turke-arabe, lehtësimin e transportit dhe tregtisë midis popujve nga të dy anët, prapë se prapë në media nuk u vërejt ndonjë gëzim, ndërsa zemrat e popujve muslimanë me fillimin e ndërtimit të parë të kësaj hekurudhe në kohën e sulltan Abulhamidit II u mbushën plot gëzim dhe hare, sepse e konsideronin projekt i gjithë umetit. Kur Sulltani vendosi ta ndërtojë këtë udhë, me qëllim që t’ua lehtësojë rrugëtimin haxhilerëve, të cilët vërtiteshin me javë e

muaj nëpër lugina dhe male, që të arrijnë në vendet e shenjta, të gjithë e konsideruan këtë hekurudhë si projekt i parë i umetit, që po rikthente tubimin e popujve muslimanë përreth shtetit osman, meqenëse asokohe ishte në fazën e rënies. Kjo u vërejt nga fluksi i kontributeve të shumta që erdhën nga besimtarët e të gjitha trojeve menjëherë sapo morën vesh thirrjen e sulltanit Abdulhamid drejtuar botës islame, të cilën ai e kishte lëshuar nëpërmjet sekretarit të vet Izet Pasha Abidi, për ta ndihmuar këtë projekt dhe jo të detyroheshin të merrnin borxh nga bankat evropiane. Atëherë vetë sulltani kontribuoi me 320.000 lira nga pasuria e tij personale, shahu i Iranit me 50,000, ndërsa nga Egjipti, Abas Hilmi pasha II dërgoi sasi të shumta materialesh për ndërtim. Në çdo vend të muslimanëve u formuan komisione për tubimin e kontributeve.

Sipas një filmi dokumentar të publikuar nga "El Xhezira" (shtator 2009), ku trajtonte temën e hekurudhës drejt Hixhazit, tregojë se entuziazmi dhe dëshira për t'u realizuar ai projekt kishte arritur në atë shkallë, sa që nëse ndodhte që hekurudha të kalonte nëpër tokën e dikujt, ai nuk pranonte asses pagesë për të. Ushtarët ia falnin kohën e tyre të lirë punës fizike në këtë projekt, ndërsa familjet bënë çmos që fëmija ta zëvendësojë babanë e vet në ndërmarrjen e hekurudhës, pasi besonin se është një punë e shenjtë dhe e lartë. Në këtë linjë u punua derisa u harxhuan 4 milionë lira, që nga fillimi në 1900 e deri në 1908, pasi u ndërtuan këto stacione: Damask – Der'a – Nablus – Aman – Hajfa – Mean – Tebuk – Medain Salih – Medinë. Gjatësia e kësaj hekurudhe ishte 1302 km dhe përshkohej për 56 orë.

Sipas deklaratave të arkeologut ekspert saudit Dr. Sad Rashid dhënë gazetës londineze "Sharkul Eusat" mësojmë se

hekurudha e Hixhazit "nuk kishte si synim të fundit Medinë, por planifikohej që të arrinte deri në Mekë dhe pastaj në Jemen, që të plotësojë vizionin, të bëjë lehtësime për një numër sa më të madh haxhilerësh, krahas rolit të rëndësishëm në transportin e mallrave, armëve dhe njerëzve".

Mirëpo, gëzimi i muslimanëve me të mirat e atij projekti nuk zgjati shumë, pasi spiuni britanik i njohur me emrin "Lorenci i Arabisë" i sugjeroi qeverisë britanike që ta prishë këtë linjë dhe të shkulë binarët në vitin 1917, tamam kur po ashpërsoheshin flakët e Luftës së Parë Botërore. Kjo u bë me qëllim që t'i presë rrugën ndihmave për ushtrinë osmane, ndërsa po përleshej me forcat britanike, si dhe me forcat revolucionare arabe, të cilat ishin bërë aleatë kundër shtetit osman në rajonin e Hixhazit. Me gjithë vitalitetin dhe rëndësinë e këtij projekti, edhe pse i ngrirë, ka pasur disa përpjekje nga udhëheqësit e Sirisë, Jordanisë dhe Arabisë Saudite për të rikthyer funksionimin e projektit në vitet 1955, 1966 dhe 1978, mirëpo çështja mbaronte vetëm me shprehjen e nijeteve dhe marrjes së vendimeve, pa pasur ndonjëherë veprime praktike. Vitin e kaluar u shpall iniciativa turke, që nënkuptonte ringjalljen e këtij projekti, që do të shtrihet nga Stambolli dhe jo vetëm nga Damasku që të arrijë në Medinë e Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Tashmë janë freskuar shpresat për tu realizuar njetet kësaj radhe, sidomos pasi qeveria turke shpalli fillimin e punimeve konkrete për këtë projekt. ■

**përktheu: Omer B.**



# SIHRI, SI TË BALLAFAQOHEMI ME TË...

Sëmundjet psikike janë realitet dhe nuk munden të anashkalohen plotësisht, duke i konsideruar sihr ose prekje (mess), ashtu si nuk mundet të nënvlerësohet mjekësia moderne dhe metodat e saj të mjekimit.

## DR. MUHAMED IBRAHIM EL-HAMED

Kushtet dhe veprimet për parandalimin e sihrit:

1. Besimi i shëndoshë që nuk është i njolllosur me shirk apo me ndonjë formë të risisë (bidatit). Bindja dhe besimi i fortë janë kështjella mbrojtëse e besimtarit, prandaj besimtari duhet të ruhet nga gjërat, që e dobësojnë imanin e tij, që shkaktojnë dyshime, që i çojnë njerëzit të kërkojnë ndihmë prej magjistarëve.

2. Mbështetja e plotë tek Allahu (tevekuli) dhe bindja se Allahu është i Vetmi që mund të sjelli dobi dhe dëm. Mbështetja tek Allahu është prej shkaqeve më të mëdha për parandalimin dhe largimin e sprovave. I Lartësuarit thotë: **“Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai.”** (Talak, 3)

Atij që i mjafton Allahu, dhe atij që kërkon mbrojtje vetëm prej Allahut, atij nuk do t'i bëjë dëm asgjë përpos gjërave me të cilat Allahu i sprovon të gjithë njerëzit, si i ftohti, nxehtësia, uria dhe etja, na thotë Ibën Kajimi, Allahu e mëshiroftë.

Allahu, subhanehu ue teala, për shejtanin dhe pushtetin e tij thotë: **“Pushteti i djallit është vetëm mbi ata, që i binden atij dhe adhurojnë zota të tjerë veç Allahut.”** (Nahl, 100)

3. Frika e vetme e jonë duhet të jetë frika prej Allahut, Sunduesit të botës së dukshme dhe asaj të padukshme.

4. Shmangia nga të zhyturit thellë në çështjet dhe temat rreth iluzioneve dhe fantazmave.

5. Kërkimi i strehimit tek Allahu në vazhdimësi.

6. Pastrimi i zemrës, synimi fisnik dhe mosmashtrimi i muslimanëve.

7. Kujdesi i veçantë për faljen e namazit në kohën e vet, me xhemat, me përulje dhe përkushtim. Moskujdesi për namazin i hap rrugë forcimit të ndikimit të shejtanit.

8. Përmendja e shpeshtë e Allahut dhe kujdesi ndaj lutjeve të mëngjesit, mbrëmjes, si dhe lutjeve që i ka bërë i Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, në situata të ndryshme.

9. Kërkimi i mbrojtjes prej Allahut për

## “...Vendet e papastra janë vendtubimi i djajve...”

fëmijët dhe familjen.

10. Pendimi dhe kërkimi i faljes. Gjërat që i ndodhin njeriut janë pasojë e mëkateve të tij. Me pendim fshihen gjurmët e mëkatit.

11. Pastrimi i shtëpisë prej fotografive, statujave, qenve, mjeteve muzikore dhe të gjitha mjeteve që e drejtojnë vëmendjen e njeriut tek gjërat e dëmshme, ose tek ato të padobishmet.

12. Pastërtia - abdesi, guslli dhe pastrimi i gjërave që konsiderohen papastërti në Islam. Vendet e papastra janë vendtubimi i djajve.

13. Duaja e sinqertë, që të jemi vazhdimisht nën mbrojtjen e Allahut, subhanehu ue teal.

14. Leximi i Kuranit në shtëpi, në veçanti leximi i kaptinës El Bekare.

15. Kur të shohësh diçka të bukur tek vetja, ose tek të tjerët le të thotë: Mashalla, tebarekallah la kuvete il-la bil-lah.

16. Devotshmëria, e cila nënkupton zbatimin e urdhrave të Allahut dhe largimi prej gjërave dhe veprimeve që i ka ndaluar.

17. Durimi, shpresa për shpërblim për çdo sprovë, e cila na ndodh dhe mendimi i mirë për Allahun e Madhëruar.

Nëse një njeri sprovohet më sëmundje si sihri, mësyshi, ankthi, depresioni dhe gjendje të ngjashme nuk është e ndaluar që në situata të këtilla të mjekohet me procedurat terapeutike, të cilat nuk janë të ndaluara fetarisht. Atij i lejohet të konsultohet me mjekë, të profileve të ndryshëm, madje edhe me psikiatër. Sëmundjet psikike janë realitet dhe nuk mundën të anashkalohen plotësisht, duke i konsideruar sihr ose prekje (mess), ashtu si nuk mundet të nënvlerësohet mjekësia moderne dhe metodat e saj të mjekimit.

Shërimi me rukje është gjithashtu i lejuar dhe ajo me lejen e Allahut, e ka ndikimin e saj pozitiv.

### **Përkufizimi i rukjes dhe disa rregulla lidhur me të:**

Rukje është leximi, i cili i bëhet të sëmurit në raste të mësyshit, kafshimit të akrepit, sihrit, helmimit, dhimbjes, brengës, mërzisë, çmendurisë, frikës, epilepsisë etj.

### **Kushtet që duhet t'i plotësojë dikush për rukje janë:**

Të lexohen ajete të Kuranit, lutje të lejuara fetarisht (në të cilat nuk ka gjëra të ndaluara si shirku, kërkimi i ndërmmjetësimit dhe të ngjashme).

Të lexohet arabisht përpos në raste kur një gjë e tillë është e pamundshme.

Të mos mbështetet (plotësisht dhe vetëm) të rukja, sepse ajo është vetëm sebeb, i cili mund të jetë i dobishëm, por mundet edhe mos të ndikojë.

Ajo që lexohet duhet të ketë kuptim të qartë (mos të ketë kuptime në ndryshme).

Ndalohet lutja e tjetërkujt përpos Allahut.

Ndalohen fjalët e ndaluara, fyerjet dhe sharjet.

Leximi i rukjes të bëhet në vend të pastër dhe në gjendje të pastërtisë fetare të atij që i bëhet rukje.

### **Disa cilësi që duhet t'i ketë ai që bën rukje:**

Të jetë i njohur për besim të pastër, me devotshmëri, me kujdes ndaj namazit me xhemat, t'i ruaj fshehtësitë e të sëmurëve, të jetë optimist, njeri që inkurajon e jo njeri që është pesimist dhe shpresëhumbur. Duhet të jetë i vendosur, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për t'u mbrojtur nga ngacmimet dhe sulmet e djajve.

Mjekimi me rukje prej një personi tjetër lejohet, edhe pse rukja që njeriu ia bën vetes është më e preferuar. Kur njeriu i bën rukje vetes del në shesh plotësimi i imanit të tij,

askush sikurse ai vetë nuk është i interesuar për shërim, sa më shumë të shprehet nevoja e njeriut për ndihmën e Allahut, aq më afër është zgjidhja dhe shërimi. Njeriu duhet ta ruajë vazhdimësinë në devotshmëri dhe mos të humbi shpresën, duke e përshpejtuar shërimin.

### **A lejohet shkuarja tek magjistarët dhe fallxhorët për të përfituar prej tyre?**

Nuk lejohet, sepse në gjërat e ndaluara nuk gjendet shërimi i sëmundjeve. Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “*Kush shkon tek fallxhori, ose falltari dhe i beson atij, e ka mohuar atë që i është shpallur Muhamedit.*” (Ahmedi).

Në një hadith tjetër ai thotë: “*Kush shkon tek fallxhori dhe e pyet atë namazi i tij nuk do t’i pranohet dyzet net.*” (Muslimi).

Besimtari duhet të jetë i kujdesshëm dhe mos të lejojë të mashtrohet e të shkojë tek këta njerëz, që pretendojnë se e dinë të fshehtën, ose se mund të shërojnë dikë.

### **Disa shenja me të cilat njihen sihirbazët (magjistarët) dhe falltarët rrenacakë.**

Pyesin për emrin e babës ose të nënës, që të mësojnë diçka për të sëmurin me anë të shejtanëve.

Kërkon diçka që i takon të sëmurit, si fije floku, petka, fotografi dhe të ngjashme.

Jep nuska-hajmali (një copë letër e mbledhur zakonisht si trekëndësh, e mbushur me fjalë kufri, vizatime të çuditshme ose vetëm vija...)

Atë që e lexon si zakonisht nuk kuptohet.

Kërkon prej të sëmurit të therë ndonjë kafshë dhe i thotë të mos e përmendi emrin e Allahut gjatë therjes.

I ndalon të sëmurit të pastrohet me ujë për një kohë të caktuar.

I jep diçka dhe e urdhëron ta fshehë nën tokë.

I jep fletë dhe e urdhëron t’i djegë dhe

pastaj të tymoset me tymin e atyre letrave.

Ndodh që të sëmurit t’ia tregojë emrin e tij dhe emrat e prindërve, si dhe shkakun e ardhjes së tij.

Kërkon prej gruas të zbulohet para tij.

Në lutjet e tij përmenden emrat e xhinëve prej të cilëve kërkon ndihmë.

Të ndalohet veprimi i sihirbazëve dhe i falltarëve është detyrim fetar dhe çdokush duhet ta bëjë atë që ai ka mundësi, që të ndalet hovi i këtyre keqbërësve.

### **Prej veprimeve të dobishme në shpalsjen e gënjeshtreve të tyre po përmendim:**

Shpjegimi i rrezikut të tyre për besimin e njeriut dhe përhapja e teksteve të Shpalljes, që flasin për dëmin e tyre.

Demaskimi i sihirbazëve dhe fallxhorëve, dhe angazhimi për nxjerrjen në pah të gënjeshtreve dhe shpifjeve të tyre.

Angazhimi në përhapjen e dijes fetare me të gjitha mjetet që kemi në dispozicion.

Përhapja e publikimeve dhe e fetvave, që flasin për dëmin e sihrit dhe sihirbazëve (magjisë dhe magjistarëve).

Angazhimi i veçantë në vetëdijesimin e grave, që shumë shpesh bien viktima të këtyre keqbërësve.

Trajtimi në detaje të çështjeve të besimit në të padukshmen (gajb), besimit se Allahu është i vetmi që sundon, drejton dhe ndikon në të gjithë atë që ka krijuar përreth nesh.

Dërgimi i letrave me qëllim këshillimin dhe kontaktet e drejtpërdrejta me pronarët e kanaleve televizive, revistave dhe mediave, që u japin hapësirë këtyre zullumqarëve, që shfrytëzojnë injorancën e njerëzve.

Organizimi i ndonjë fushatë mediatike, që do të përfshinte edhe njerëz me peshë dhe ndikim në shoqëritë tona islame. ■

**Përktheu: T. KURTISHI**

# EDUKIMI I SHPIRTIT

JAHJA EL JAHJA

I falënderuar qoftë Allahu, Zoti i botëve, bekimet dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Allahut. Imam Muslimi në librin e tij prej Enes ibën Malikut, Allahu qoftë i kënaqur me të, e shënon këtë hadith: Pasi u shpall ajeti: **“O ju që keni besuar! Mos ngrini zërin tuaj mbi zërin e Pejgamberit dhe mos bisedoni me të me zë të lartë, ashtu si flitni zëshëm njëri me tjetrin, në mënyrë që mos t’u humbin veprat tuaja – e që ju të mos i hetoni.”** (Huxhurat, 2) Thabit ibën Kajsi u mbyll në shtëpinë e tij dhe thoshte: “Unë do të dënohem në xhehenem...” I Dërguari i Allahut, bekimet dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, e pyeti Sad ibën Muadhin: *O Ebu Amër, ç’po ndodh me Thabitin mos vallë është i sëmurë?* E kam fqinj, por nuk e di se është i sëmurë; u përgjigj Sadi. Pastaj Sadi shkoi te Thabiti dhe i tregoi për fjalët e të Dërguarit. Thabiti tha: **“U shpall ajeti e ju e dini, se unë më tepër se të gjithë e ngrija zërin pranë të Dërguarit të Allahut, bekimet dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të. Unë do të dënohem në xhehenem.”** Sadi për këto fjalë e lajmëroi të Dërguarin e Allahut, i cili pastaj tha: **“Përkundrazi, ai është prej xhenetlive.”**

Mësime dhe dobi nga ky rast:

Allahu, Sunduesi dhe Dhuruesi, u drejtohet besimtarëve me emrin e bukur të imanit me të cilin i ka veçuar dhe i ka dalluar.

Respektimi i të Dërguarit të Allahut, bekimet dhe lavdërimet e Allahut qofshin mbi të, dhe rrjedhimisht i dijetarëve dhe i atyre që janë plakur në Islam. Allahu, i Lartësuar, e ka mëshiruar atë që është plakur në Islam.

Allahu, xhele she’nuhu, e edukon umetin e Muhamed Mustafasë në të gjitha segmentet e jetës dhe kjo është provë për plotësinë dhe përkryerjen e Fesë Islame.

Rëndësia e vigjilencës dhe e kujdesit, si cilësi të kundërta të shkujdesjes dhe mungesës. Të folurit e një besimtari duhet të mbështetet në kuptim dhe në dije të asaj që flet. Një pakujdesi mund të shkaktojë asgjësimin e veprave.

Meditimi i as’habëve rreth Kuranit dhe realiteti se si ata i kanë kuptuar dhe jetësuar ajetet e shpalljes hyjnore.

Akuzimi i vetes duke e analizuar veprën tonë sipas mësimeve hyjnore, gabimi të shihet si gabim, ashtu siç veproi edhe Thabiti, i cili veprën e tij e analizoi në dritën e mësimeve kuranore.

Të shfaqim frikë prej dënimit të Allahut, për veprat tona dhe të mundohemi që ta kuptojmë rrezikun e çdo mëkati, si çështje tejet serioze.

Takimet e Pejgamberit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, me shokët e tij.

Besimtarët i fillojnë miqësitë e tyre në xhami dhe xhamitë janë vendi ku takohen besimtarët.

Ligjshmëria e të thirrurit me llagap.

Fqinjët janë prej njerëzve më të afërt për besimtarin dhe ai do të pyetet për të.

Supozimi i mirë për muslimanët, i cili shihet në fjalët e të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem: ‘Ç’po ndodh me Thabitin, mos vallë është i sëmurë?’*

Takimet me fqinjët dhe dija për gjendjen e tyre është prej veprave të lavdëruara. Kjo shihet nga fjalët e Sadi: “E kam fqinj, por nuk e di se është i sëmurë.”

Interesimi për shkakun e mungesës së fqinjët në xhami.

Mos nxitimi në vlerësime dhe dhënie të fetvave dhe konsultimi me njerëzit e ditur. Sad ibën Muadhi nuk i tha Thabitit: Ajeti nuk u shpall me rastin tënd, sepse ti i je drejtuar të Dërguarit atëherë kur prej teje është kërkuar dhe vetë biseda kërkon ndonjëherë ngritjen e zërit...

Ligjshmëria e përgëzimit të besimtarit.

Largësia e as’habëve nga vetëpëlqimi dhe vetëlavdërimi.

Vazhdimësia në vepra dhe vetëmbikëqyrje. Thabiti edhe pse kuptoi se është prej xhenetlive, nuk e la xhihadin derisa ra si dëshmor në rrugën e Allahut.

Lutja jonë e fundit është: I falënderuar qoftë Allahu, Sunduesi i gjithësisë. ■

**Përktheu: T. KURTISHI**



## DEBAT

# SI PËRKTHEHET: LA ILAHE IL-LALLAH

Lexues të nderuar,

Në këtë rubrikë kësaj radhe po ju sjellim diçka ndryshe nga hoxhallarët tuaj. Do të keni rastin të lexoni një debat të rastësishëm, i cili ndodhi ndërmjet redaksisë së revistës AlbIslam gjatë muajit të shkuar. Debati po zhvillohet në grupin elektronik të redaksisë “ALBISLAMI”.

Për shkak të rëndësisë dhe përkthimit sa më të saktë të shehadetit dhe pasi rrallëkush në trojet tona diskuton në këtë temë, deshëm që sadopak të kontribuojmë në ngjalljen e debatit shkencor në mesin e hoxhallarëve në përgjithësi duke mos i marr gjërat me verbëri, si dhe të bëjmë një tendencë për unifikimin e përkthimit të fjalës madhështore, e cila e shpëton njeriun nga xhehenemi. Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “*Kush thotë La ilahe il-lallah, sinqerisht nga zemra do të hyjë në xhenet*”.

Debatin në fillim e inicioi **hoxha i mirënjohur Ismail Bardhoshi** (Tiranë), i cili pasi kishte lexuar vërejtjen e një prej lexuesve të AlbIslamit lidhur me përkthimin e shehadetit, mes tjerash na shkroi: “...lidhur me përkthimin e shehadetit, dua t’ju shpreh mendimin tim dhe pastaj të dëgjoj edhe qëndrimet tuaja. Besoj se një nga shprehjet që na duhet ta përkthejmë më së shumti në hutbet, derset, artikujt, punimet dhe përkthimet tona është shehadeti. Mendimi im është që shehadeti duhet përkthyer kështu: “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut”,



ose “nuk ka perëndi tjetër përveç Allahut”, ose “nuk ka hyjni tjetër përveç Allahut”, pasi të gjitha këto i përshtaten fjalës ‘ilah’ në gjuhën arabe. Ndërsa shprehja “nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut” duhet të përmendet si shpjegim i kelimetuteuhid. Unë jam menduar gjatë mbi këtë çështje dhe kohët e fundit po veproj kështu siç përmenda më sipër. Kam dal në këtë përfundim pasi shpesh e kam pas të vështirë të merrem vesh me njerëzit këtu në Shqipëri. Ata e dinë që muslimani beson vetëm një Zot, por kur ua përkthen shehadetin në atë mënyrë (d.m.th. “nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut”) ata hutohen. Ndërsa, kur ua

përkthen siç e përmenda më lart, e pastaj e shpjegon se çdo të thotë të besosh në një Zot, se ç'do të thotë 'ilah', cilat janë detyrat dhe kërkesat që rrjedhin nga shehadeti, njerëzit i kuptojnë më lehtë.

Shqetësimin e njëjtë e përkrahu edhe **redaktori gjuhësor i revistës, Roald Hysa** (Tiranë) duke thënë: "të jap të drejtë, se një here me një vëlla, pikërisht kështu më tha se shehadeti përkthehet "nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut" dhe më konsideroi gabim "Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut". M'u duk sikur do të më thoshte se paske "probleme me akiden", duke harruar se "zot në shqip do të thotë diçka që adhurohet..."

Duke dashur të tregoj se vërejtja e lexuesit nuk ishte me vend, **unë u shpreha**: "Unë me vetëdije e kam lënë në AlbIslam dhe jo vetëm në këtë numër, këtë përkthim: "Nuk ka të adhuruar përveç Allahut"; ndërsa shtesa "me meritë" apo "me të drejtë" mendoj se duhet të theksohet gjatë shpjegimit, sepse edhe në arabisht thuhet "la ilahe il-lallah" e jo "la ilahe bihakkin il-lallah", që në shqip përkthehet: "nuk ka të adhuruar me meritë përveç Allahut". Kurse nëse themi se Zot në gjuhën shqipe nënkupton "i adhuruar" atëherë pse askush prej neve nuk po jep fetva, se është haram t'i drejtohemi njerëzve me fjalët: zoti filan fisteku?!

Pas kësaj, **studiuksi dhe hoxha i dalluar shqiptar Justinian Topulli** (Tiranë) na tregoi për përvojën e tij në këtë drejtim: "Unë kam kohë që e praktikoj modelin që përdor Ismaili, pasi praktikisht siç e përmend edhe Ismaili se "nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë" është koment. Për mua fjala "hyjni", megjithëse ka një origjinë pak problematike është në përdorim dhe kuptim më afër fjalës "ilah" në arabisht edhe sipas fjalorit të shqipes:

HYJNIZOJ kal.

1. E quaj perëndi ose e vë në një radhë me perënditë, e shoh si qenie hyjnore me fuqi

“...më tha se shehadeti përkthehet “nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut” dhe më konsideroi gabim “Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut”. M’u duk sikur do të më thoshte se paske “probleme me akiden”...”

të mbinatyrshe (sipas besimeve fetare). Hyjnizonin fuqitë e natyrës.

2. fig. E ngre lart a e lëvdoj shumë, duke e quajtur të përkryer, e ngre në qiell; i thur lëvdata të mëdha një njeriu të shquar; e adhuroj.

Në të folur është e thjeshtë dhe unë vetë i përdor të gjitha variantet, shpesh edhe njëkohësisht, ndërsa në të shkruar më shumë variantin me fjalën Hyj. (d.m.th. Nuk ka Hyj përveç Allahut”.

Për të bërë një sqarim edhe më të thuktë dhe krahasim të drejtë midis arabishtes dhe shqipes, në debat u kyç edhe **hoxha i nderuar Agim Bekiri** (Shkup). Ai u shpreh: “Mendoj që ka raste kur patjetër duhet të përkthejmë tekstet e shariatit fjalë për fjalë, nëse jemi duke përkthyer tekstin së bashku me komentin e tij. Do ta ilustrim me një shembull të thjeshtë: kur përkthejmë (në shkrim) hadithin “bunijel islamu ala hamsin” me koment, do të detyrohemi të themi “islami është ndërtuar mbi pesë” dhe kaq, pasi në koment më poshtë do të përmendet se aty është lëshuar fjala e paramenduar “shtylla ose themele”, siç është te Komentari i 40 haditheve të Neveviut nga Shejh Utthejmini.

Mirëpo në raste kur tekstin nuk jemi duke

e përkthyer së bashku me komentin e tij, por argumentohemi me të për ndonjë temë të caktuar, atëherë duhet të përmendim edhe pjesët e lëshuara të fjalisë dhe në rastin tonë do të themi: “Islami ngrihet mbi pesë shtylla” dhe ecim përpara. E di se shembulli është tejet i thjeshtë dhe tejkalohet kollaj, mirëpo pasi nuk m’u kujtua ndonjë tjetër e përmenda këtë.

Sa i takon shehadetit, mendoj se nuk është shumë me rëndësi fjalën “ilah” si do ta përkthejmë: Hyjni, Zot apo Perëndi (edhe pse dihet se mu këtu ka ndodhur devijimi i Esharinjëve dhe atyre si ata, mirëpo kjo është për arabisht), me rëndësi është që të formulojmë mirë fjalinë në gjuhën tonë me të gjitha gjymtyrët e saj. “la ilahe il-lallah” siç e dimë këtu, kallëzuesi i pjesës gjithmohuese (LA nafije lil xhins) është i lëshuar (mahdhuf), mirëpo kjo nuk do të thotë se nuk është aty, madje ky kallëzues siç thotë Ibën Maliku: “më shumë lëshohet, sesa përmendet në arabisht”. Dua të them se nëse e përkthejmë shehadetin kështu: “nuk ka hyjni të denjë përpos Allahut” apo “nuk ka hyjni të vërtetë përpos Allahut” nuk kemi bërë komentim, por përkthim tekstual, ngase siç e dimë shqipja dallon prej arabishtes dhe shpeshherë detyrohemi të përkthejmë edhe ato gjymtyrë që janë “të lëshuar, por të paramenduar” (mahdhuf mukadder). Këtu mund të na ndihmojë Roaldi apo dikush tjetër dhe të na tregojë: nëse themi “nuk ka hyjni përpos Allahut” a mbetet diçka për t’u nënkuptuar nga kjo fjali? A është e lëshuar ndonjë gjymtyrë?

Sidoqoftë, mendoj se: nëse jemi duke përkthyer analizën gramatikore të shehadetit, atëherë do të detyrohemi ta përkthejmë shehadetin, ashtu siç e ka përkthyer vëlla Ismaili (nuk ka Zot tjetër përveç Allahut), pastaj të tregojmë se kallëzuesi është i lëshuar, i cili doemos paramendohet etj... përndryshe mendoj

se duhet te përdorim fjalinë e plotë pa paramendime, pa pjesë të lëshuara. Kështu më lehtë e kemi ne, më mirë rrënjoret në mendjet e lexuesve dhe dëgjuesve kuptimi i drejtë i shehadetit dhe sa ma merr mendja është më e saktë edhe gjuhësisht, Allahu a’lem!

**Roald Hysa** sqaron: “Vëlla Agimi, tek përkthimi i Ismailit nuk mungon kallëzuesi, që në rastin e shehadetit është folja “ka”, pra, “nuk ka Zot tjetër përveç Allahut”... Gjithsesi ajo që nënkuptohet dhe shumë nga vëllezërit i mëshojnë është pjesa “me të drejtë”, por që ai që beson Allahun, e di shumë mirë që vetëm një Zot mund të ketë dhe atij i takon adhurimi, dhe kushdo qoftë që fillon e thellohet në mësimet e teuhidit domosdoshmërisht që ka për të marrë mësimet për pjesën e komentit “me të drejtë”.

**Agim Bekiri** vazhdon sqarimin e tij: “Vëlla Roald, sido që të jetë, tek shehadeti arabisht “la ilahe il-lallah” kallëzuesi (i pjesëzës LA) nuk duket, por nënkuptohet domosdoshmërisht që është “me të drejtë”, ose arabisht “hakkun apo bihakkin”. E tani, ajo që domosdoshmërisht nënkuptohet nga pozita sintaksore e fjalëve në arabisht, a duhet ta përkthejmë në shqip? Fjalinë e shehadetit shqip që e ka përmendur Ismaili është e plotë dhe s’të jep ta nënkuptosh atë që e nënkupton arabi prej shehadetit arabisht.

Tek fjalia “la ilahe il-lallah” janë këto gjymtyrë:

1. pjesëza mohuese “LA”
2. kryefjala e kësaj pjesëze “ILAH”
3. kallëzuesi i lëshuar (mahdhuf) “HAKKUN ose BIHAKKIN”
4. pjesëza për përjashtim “IL-LA”
5. emri i përjashtuar (el mustethna) “ALLAH”

Gjuhëtarët arabë përmendin se ky kallëzues i pjesëzës “LA” në të shumtën e rasteve nuk përmendet, ngase ndërtimi sintaksor i fjalisë të jep ta nënkuptosh. d.m.th.

nënkuptimi nuk vjen nga njohuritë që do kesh për teuhidin, porse nga renditja e fjalëve në fjali. Allahu e di më së miri.

**Imami i njohur nga Tirana, Ahmed Kalaja** shpreh: “ILAH në shqip përkthehet perëndi ose hyjni. Edhe unë mendoj sikur ju më herët që gjërat kryesore të kenë një standard të përbashkët në përkthim: “Nuk ka Perëndi ose Hyjni të vërtetë përveç Allahut”.

**Ismail Bardhoshi** përkrah këtë më lart duke thënë: “Kjo që thotë Ahmedi: “Nuk ka Perëndi ose Hyjni të vërtetë përveç Allahut”, më duket se është përkthimi më i plotë, por mendoj se edhe shprehja “nuk ka Hyjni tjetër përveç Allahut” të çon po në këtë kuptim, sepse kushdo që e pranon këtë dëshmi është i vetëdijshëm, se ka të tjerë që besojnë hyjni të tjera që në fakt janë të rreme, të kota, kështu që domosdo ata duhet të kuptojnë nga shprehja: “nuk ka hyjni tjetër veç Allahut” se: vetëm Allahu është hyjni i vërtetë, kurse të tjerët janë të pavërtetë. Ndërsa nëse fjala ‘ILAH’ do të përkthehet me fjalën ‘i adhuruar’, atëherë për mendimin tim duhet medoemos të thuhet: ‘Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut’. Në fakt, ky i fundit do të ishte përkthimi më perfekt, por problemi është se njerëzit nuk e kanë të lehtë ta kuptojnë menjëherë. Gjithsesi, me ata që na kuptojnë mirë mund të përdorim këtë të fundit, ndërsa me publikun e gjerë mund të përdorim fjalët, perëndi ose hyjni. Zoti ju shpërbleftë!

**Paskëtaj, unë u shpreha:** “Kuptimi nga ana e njerëzve është relativ. Ajo që më bren mua është fakti se kur e përkthejmë shehadetin “Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut” jomuslimani nuk ka asnjë kundërshtim për këtë dhe thotë: ashtu është! edhe ne besojmë ashtu, përveçse ne e quajmë Zot ndërsa ju Allah. Por, kjo nuk ndodhte me arabët, të cilët edhe pse e besonin Allahun (zotërimin - rububijen e tij) kur u thuhej ta thonë këtë dëshmi, menjëherë kundërshtonin për të

vetmin shkak se duhej t’i braktisnin të adhuruarit e tyre, të cilët i kishin si ndërmjetësues mes tyre dhe Allahut.

Sikurse tha Ismaili, përkthimi më perfekt është “Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut”, mirëpo mendoj se lëshimi i fjalës “me të drejtë” nuk prish punë, për arsye se edhe në arabisht lëshohet dhe për faktin se - sipas mendimit tim - domosdoshmërisht nënkuptohet. Allahu e di më së miri.

**Ndërsa Roald Hysa shton:** “Për ne që po e trajtojmë këtë temë tashmë është bërë e qartë, kuptimi i “La ilahe il-lallah” në të dy variantet e trajtuara, por duke qenë se jemi një mexhlis këtu në këtë listë, unë jam shumë dakord që në punimet tona të përdoret forma: “Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut”, e cila më pas do të sillte edhe lehtësinë në trajtimin e saj nga ana fetare. Gjithashtu ky mexhlis do të krijonte një konvencion të vlefshëm, pra, atë se ne do të binim dakord në përkthimin e kësaj shprehje në këtë formë. Veprim ky shumë i rëndësishëm, sepse do të hapte një hulli të re në fushën e përkthimit në gjuhën shqipe, ashtu siç qe’ edhe takimi i Tetovës. Allahu e di më së miri urtësinë e punëve të veta. Allahu ju ruajt të gjithëve.

**Kurse Agim Bekiri konstaton:** “Kam bindjen se trajtimi i kësaj çështjeje është i dobishëm dhe së bashku mund të arrijmë në përfundime më të pjekura... Sa i takon përkthimit të shehadetit gati kemi rënë në ujdë se përkthimi më i përkryer do të ishte “Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut”, se paku nëse e llogarisim heshtjen e anëtareve të grupit që nuk janë inkuadruar si pajtim.

Mirëpo, pa dashur të bëj imtësime të tepruara mendoj që lëshimi i fjalëve “me të drejtë” është gabim në raste kur shkruajmë apo u drejtohem atyre që nuk kanë njohuri elementare për *kelimeteuhidin* sepse me shehadet, ne pohojmë një të vërtetë e cila

## “H. Ali Korça thotë se fjala perëndi rrjedh nga persishtja... dhe mesa më kujtohet ishte emër xhindi apo shejtani...”

duhet të jetë shumë e qartë dhe logjike, si definicion. Formulimi “Nuk ka të adhuruar përveç Allahut” për mua është njëjtë sikur thënia “Nuk ka fe përveç Islamit”. Një i udhëzuar nga kjo e fundit do të kuptojë se nuk ka fe të pranuar përveç Islamit, mirëpo të njëjtën s’do ta kishte kuptuar një injorant apo një mosbesimtar porse pohimi do t’i dukej jo i sakte. uallahu a’lem.

Më pas, **Justinian Topulli do të shprehet:** “Duke mbrojtur idenë se fjala “hyj” në shqip është më e përshtatshme me fjalën “ilah” po citoj fjalorin e shqipes kur kjo fjalë vjen si mbiemër, ndërsa më parë citova kur ajo vinte si folje. Në fjalor thuhet:

**HYJNIZUAR** mb. 1. Që është quajtur perëndi ose është vënë në një radhë me perënditë, që është parë si qenie hyjnore e me fuqi të mbinatyrshme (sipas besimeve fetare). Qenie e hyjnizuar. 2. fig. Që është ngritur lart a është lëvdur shumë, duke u quajtur i përkryer, që është ngritur në qiell; që i janë thurur lëvdura të mëdha; që është adhuruar. Njeri i hyjnizuar.

Ndërkohë fjala arabe *ilah*, nga thuhet se vjen edhe fjala Allah, merr disa kuptime, kuptime këto që dijetarë të ndryshëm i lidhin me emrin dhe qenien e Zotit:

a) të adhurosh, b) të ngelësh i shastisur, pa mend (kjo për shkak të madhësisë apo prezencës së Zotit), c) t’i drejtohesh dikujt për ndihmë, d) të gjesh prehje dhe qetësi, e) diçka që ngrihet dhe fshihet.

Shejh Ibën Uttejmini shprehet se uluhije (paskajorja e fjalës *ilah* pra hyjnizimi) është: adhurim (ibade) me dashuri dhe madhërim.

Ndërkohë fjala adhurim në shqip sipas fjalorit të gjuhës shqipe do të thotë:

**ADHUROJ** kal. 1. Kam dashuri të zjarrtë dhe nderim të madh për dikë ose për diçka. 2. fet. Sipas besimeve fetare: e quaj dhe e nderoj dikë a diçka si perëndi, i përulem e i falem duke e njohur si hyjni me fuqi të mbinatyrshme.

Siç shihet ajo ka kuptime të ngjashme me fjalën *ilah* në arabisht dhe *hyj* në shqip, dhe vlen si shpjegim për fjalinë e shehadetit, por mendoj se në përkthim dhe në shkrime fjala *Hyj* dhe *Hyjni* është më e plotë dhe më afër qëllimit tonë. Kjo edhe për arsye se, nëse pranojmë mendimin se fjala *hyj* ka ardhur nga fjala *hyll* = yll, siç përdoret edhe sot nga disa zona veriore shqiptare, atëherë fjala *hyj*, qoftë si emër, si folje apo si mbiemër, na tregon se kemi të bëjmë me diçka që qëndron lartë, që lartësohet nga njerëzit, që ngrihet në qiell, ndërkohë që njerëzit qëndrojnë poshtë. Kështu që vetë kjo fjalë të jep një tingëllim qiellor, që kemi të bëjmë me qenie qiellore, lart botës së njerëzve. Përveç kësaj, dëgjimi apo leximi i fjalës *hyj* dhe *hyjni* menjëherë të shpien tek Zoti, pasi vetë fjala *Hyj*, përdoret si emër i përveçëm i Zotit. Pra kur thua se “nuk ka hyj”, menjëherë në mend kupton se “nuk ka zot”, por veç kësaj kupton edhe diçka më tepër sesa fjala zot dhe që është kuptimi që rrjedh nga folja hyjnizoj = adhuroj...etj. Që kjo të jetë më qartë dhe që nga fjala *hyj* të kuptohet vërtetë adhurimi dhe *hyjnizimi* dhe jo thjesht emri zot, më mirë do të ishte të thuhej: “nuk ka hyjni”. Në këtë rast fjala merr trajtën e një emri foljor ku nënkupton edhe subjektin edhe veprimin. Në këtë rast subjekti është Hyji = Zoti dhe veprimi është hyjnizimi = adhurimi. Pra ky artikulum nënkupton se, nuk ka zot tjetër të hyjnizuar. Natyrisht këtu mund të shtojmë edhe fjalë të tjera plotësuese si “*me të drejtë*”, por për mendimin tim “*me të drejtë*” nuk është shumë e nevojshme, sepse vetëkuptohet dhe i përket komentit.

Ndërsa përsa i përket fjalës PERËNDI... edhe kjo fjalë është e përshtatshme për të zëvendësuar fjalën ilah në përkthim, shumë më tepër sesa fjala i adhuruar, vetëm se kjo fjalë nuk ka folje në gjuhën shqipe. Origjina e kësaj fjale është e dyshimtë, disa thonë se ajo rrjedh nga fjala perandor që në latinisht rrjedh nga fjala imperare, të urdhërosh, të komandosoh. H. Ali Korça thotë se fjala perëndi rrjedh nga persishtja... dhe mesa më kujtohet ishte emër xhindi apo shejtani...

Problem tjetër është se kjo fjalë ne shqip është ne gjininë femërore ndërkohë që fjala hyj dhe zot janë në mashkullore dhe po kështu ne arabisht, jo se kjo përbën fetarisht ndonjë problem të madh, pasi vetë Zoti është përtej këtyre koncepteve njerëzore, por çështja është se Allahu e ka bërë burrin superior ndaj grave kështu që edhe emri i Tij në gjuhën e folur të njerëzve është në këtë gjini gjuhësore dhe tregon duam apo s'duam superioritet shumë me tepër sesa një emër në gj. femërore. Po ashtu kjo tregon se fjala perëndi ka origjinë pagane, ku edhe shumësi perënditë, perëndesha...etj janë shumë më të përdorura në shqip sesa zotat apo hyjtë dhe hyjnitë.

Shpresojmë të keni përfituar, ndërsa debati vazhdon... ■

**sollli për ju: Omer BERISHA**

## SI TA KËRKOSH DIJEN

# PERLA DHE MARGARITARË PËR NXËNËSIN E DIJES


**Ka shumë thënie të urta, që zakonisht dijetarët i përcjellin rreth kërkuesve të dijes, që janë të ngutshëm gjatë mësimit dhe dëshirojnë që për një kohë të shkurtër të mësojnë shumë dhe të flasin për to, pa hyrë në studimin e shkencave përkatëse si duhet**

**SHKRUAN: ALAUDIN ABAZI**

**N**ë pjesën e parë të kësaj teme, në numrin e kaluar të revistës, lexuesi pati mundësinë të njihej rreth vlerës së diturisë, klasifikimit të saj dhe të kuptojë normat, të cilat duhet t'i ketë parasysh nxënësi i dijes. Në vazhdim do të flasim rreth disa pikave, që gjithashtu janë të rëndësishme të dihen për nxënësin e dijes.

### METODOLOGJIA GJATË KËRKIMIT TË DUES

Me këtë kemi si qëllim tërësinë e mënyrave dhe të metodave, që duhet të përdorë kërkuesi i dijes, nëse dëshiron të jetë i suksesshëm në punën e tij. Në pjesën e parë të kësaj teme kemi thënë se nxënësi i dijes ndërmerr një rrugë mjaft të gjatë dhe atij gjatë këtij udhëtimi i kërkohet që të pajiset me nozullime e zahire për të cilat do të ketë nevojë, prandaj për të arritur sa më shumë suksese në këtë rrugëtim ai ka nevojë të zgjedhë metodat më efikase dhe më të sigurta, që do t'i japin atij përfundime të mira dhe të mbara. Në këtë fillim duhet të përmendim se metodat që mund të përdoren nga nxënësit e dijes mund të jenë ato bashkëkohoret, të cilat aplikohen nëpër universitete dhe kjo vlen për ata që vazhdojnë studimin e shkencave islame. Por gjithashtu mund të jenë edhe metodat tradicionale, të cilat janë të mirënjohura te muslimanët, që nga kohët e hershme dhe për shekuj me radhë janë



bartur këto vlera nga brezi në brez. Në këtë temë ne do të përqendrohemi në këtë të fundit, meqë është më e përgjithshme dhe më e nevojshme. Për metodën e parë nuk ka edhe nevojë të flitet shumë, meqë vetë regjistrimi në ato shkolla e nënkupton edhe metodologji të caktuara për marrjen e dijes.

### 1. Shkallëzimi gjatë kërimit të dijes, duke filluar nga njohuritë themelore në çdo lëmi:

Ka shumë thënie të urta, që zakonisht dijetarët i përcjellin rreth kërkuesve të dijes, që janë të ngutshëm gjatë mësimin dhe dëshirojnë që për një kohë të shkurtër të mësojnë shumë dhe të flasin për to, pa hyrë në studimin e shkencave përkatëse si duhet. Nga këto porosi janë:

- “Kushdo që dëshiron ta marrë diturinë me të parën, do ta humbë atë me të parën”,
- “Mbushja e tepërt e veshit me dituri, nxënësin e dijes e dërgon në kuptimin e gabuar të gjërave”,
- “Kushdo që nuk e perfeksionon bazën (thelbin e një shkence); pengohet nga arritja e qëllimit në atë dituri”, etj.

Kjo metodë e nxënies së dijes është

<sup>1</sup>Isra, 106.

“...Ndoshta dikush do të thoshte se përdërisa librat janë në dispozicion, kompjuteri dhe interneti janë në gatishmëri të vazhdueshme, atëherë unë e kam mundësinë që të kërkoj dije dhe të mësoj pa pasur nevojë të udhëtoj e të shkoj te hoxhallarët ...”

metodë me të cilën edhe zbriti Kurani i Famshëm. Libri i Allahut nuk zbriti menjëherë te muslimanët e parë, por ai vazhdoi të zbresë në një interval kohor prej 23 vitesh, kështu që ata të kenë mundësinë t'i kuptojnë më qartë arsyet e përligjes së dispozitave dhe që ta dinë se me çfarë ka të bëjë çdo ajet. Allahu i Lartësuar thotë: *“Ky është një Kuran, që Ne e kemi ndarë pjesë-pjesë, që ti t'ua mësosh njerëzve pak nga pak, duke e shpallur atë kohë pas kohe.”*<sup>1</sup> Gjithashtu thotë: *“Jobesimtarët thonë: ‘Përse Kurani nuk i është shpallur i tëri menjëherë?!’ Ne ta kemi shpallur kështu për të forcuar zemrën tënde dhe ta kemi zbuluar qartazi varg pas vargu.”*<sup>2</sup>

Me shkallëzim gjatë kërimit të dijes kemi si qëllim dy gjëra:

**Gjëja e parë:** Kur të fillojmë me nxënien e dijes ta bëjmë atë duke mësuar dituritë më të domosdoshme, pa të cilat nuk mund të jetësohet feja jonë dhe pastaj të kalojmë në ato që janë më pak të rëndësishme e kështu me radhë. Pra, prioritet në këtë drejtim kanë mësimi i gjërave që janë prej detyrimeve individuale (farzeve ajn), pastaj vijnë me radhë mësimi i njohurive tjera që janë më poshtë se kjo shkallë. Nuk duhet të kalojmë në mësimin e çështjeve më pak të rëndësishme, duke i ana-

<sup>2</sup>Furkan, 32.

shkalar ato që duhet t'i mësojmë patjetër.

*Dije se dituria është shumë e gjerë, ndërse jeta e njeriut është shumë e shkurtër dhe nëse ai preokupohet që të përfitojë dituri të parëndësishme, atëherë do ta shpenzojë jetën pa përfituar atë dituri për të cilën kishte nevojë!*

Pastaj duhet të dish se në Islam kemi lëmi, që konsiderohen dituri thelbësore (esenciale), sikurse mësimi i Akides (besimit), Kura-ni dhe komentimi i tij, Hadithi, Fikhu, etj. Dhe kemi dituri që konsiderohen ndihmëse dhe shërbyese, sikurse mësimi i gramatikës arabe, Usuli Fikhut, Terminologjia e Hadithit (Mus-talah) etj. Bërja dallim në mes të këtyre diturive dhe përcaktimi i secilës fushë në cilin lloj bën pjesë, kërkuesit të dijes i japin mundësinë t'i përcaktojë prioritetet e diturive, të cilat duhet t'i studiojë dhe ai e kupton se si disa shkencë mësohen për t'u shërbyer me to në njohjen e disa shkencave të tjera.

**Gjëja e dytë:** Është esenciale për nxënësin e dijes, që në fillim të çdo diturie, të cilën ai dëshiron ta përvetësojë, të fillojë nga gjërat më thelbësore e bazike dhe pastaj të zgjerohet në të tjerat që ndërlihen me atë lëmi. Pra, të fillojë studimin e një fushe të caktuar duke i perfeksionuar gjërat e saj themelore, duke perfeksionuar një libër përmbledhës, që flet për fushën përkatëse, pastaj duke u zgjeruar në atë fushë. Gabimet më të shumta në të cilat bien nxënësit e dijes në këtë aspekt mund të jenë:

Tendenca e nxënësit të dijes që të përvetësojë në një kohë të shkurtër sa më shumë njohuri rreth një fushe të caktuar, duke mos seleksionuar se çfarë është thelbësore dhe çfarë jo, çfarë është primare dhe çfarë është sekondare për atë fushë.

Marrja me librat që përmbajnë përpilime të gjata, të cilat mund të konsiderohen enciklopedi të fushave të caktuara, para se të përvetësojnë gjërat themelore të fushës përkatëse.

Ndërrimi i librave gjatë leximit dhe studi-

mit të gjërave, duke kaluar nga njëri në tjetrin dhe kjo pa dyshim është nga mungesa e durimit.

Shpërfillja e terminologjisë shkencore; çdo shkencë përmban në vetvete një tërësi termash dhe emërtime të përcaktuara. Moksuptimi si duhet i këtyre termave e huton kërkuesin e dijes, duke ia vështirësuar kuptimin e problematikave dhe kështu e bën atë që të ndjejë mërzi ndaj një fushe të caktuar të diturisë.

## 2. Nxënia e dijes nga dijetarët (hoxhallarët)

Ndoshta dikush do të thoshte se përderisa librat janë në dispozicion, kompjuteri dhe interneti janë në gatishmëri të vazhdueshme, atëherë unë e kam mundësinë që të kërkoj dije dhe të mësoj pa pasur nevojë të udhëtoj e të shkoj te hoxhallarët dhe të ulem para tyre e të dëgjoj nga ata!

Dije se marrja e dijes nga dijetarët është një praktikë e shenjtë e vazhdueshme nga brezi në brez dhe nxënësi i dijes me prezantimin e tij në hallkat e mësimave të dijetarët nuk fiton vetëm dije, por fiton edukatë dhe moral nga mësuesi i tij. Fillimisht kjo është më e dobishme për nxënësin e dijes se sa vetë dija, të cilën ai mund ta fitojë.

Dijetari i njohur Bekër Ebu Zejd, Allahu e mëshiroftë, në librin e tij "Hiljetu Talebil Ilm", ia kushton një kapitull të tërë çështjes së nxënies së dijes nga dijetarët. Ai thekson se baza e marrjes se diturisë duhet të bëhet përmes diktimit dhe përvetësimit nga mësuesit dhe dijetarët. Gjithashtu ai përcjell edhe thënie të ulemave që i kanë kritikuar ata që pretendonin se dituria mund të merret vetëm nga librat. Ndër këto thënie përmendim:

*"Kushdo që hyn në dituri i vetëm, do të dalë i vetëm".*

*"Mos e merr diturinë nga ai personi, që e ka marrë atë vetëm nga shkrimet (librat), mos e merr Kuranin nga personi, që e ka lexuar atë prej mus'hafit, (do të thotë që mos e mëso*



## “Dituria është arkë (thesar i mbyllur), kurse çelësi i saj është pyetja” ...”

*Kuranin tek një person, i cili e ka lexuar atë vetëm nga mus'hafi, pa e mësuar para ndonjë hoxhe), mos e mëso hadithin prej një personi, që e ka marrë hadithin duke lexuar vetë nga librat.”*

*“Kushdo që nuk i lexon librat para dijetarëve, atëherë siguria e tij në çështjet e vështira është supozim.”*

*“Ai që ka mësues librin (merr diturinë vetëm nga librat), gabimet e tij do të jenë më të shumta se sa të saktat e tij.”*

### 3. Sjellja e nxënësit të dijes me mësuesit e tij

Sqaruar më lartë se dituria nuk realizohet fillimisht prej librave, por është e nevojshme të merret nga mësuesit dhe dijetarët, në mënyrë që të sigurohen çelësat e diturisë (që ta mbrojmë veten nga gabimi dhe rrëshqitja). Pasi ta kuptojmë këtë, atëherë duhet të kuptojmë edhe se e kemi për detyrë që dijetarët dhe mësuesit tanë të jenë njerëzit më të dashur dhe më të respektuar nga ana jonë. Respekti që duhet t'i shfaqim dijetarëve dhe mësuesve tanë duhet të jetë i njëjtë me atë që ua shprehim prindërve tanë. Shembulli më i mirë në këtë drejtim kuptohet në ajetin me të cilin Allahu i Madhërisëm i mëson shokët e të Dërguarit, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, se me çfarë etike duhet të sillen me të:

*“Mos iu drejtoni të Dërguarit, njësoj si thirrni njëri-tjetrit; Allahu me siguri i di ata që shkëputen prej jush tinëzisht. Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij, që të mos i arrijë ndonjë sprovë ose që të mos i godasë një dënim i dhembshëm.”<sup>3</sup>*

Prandaj nxënësi i dijes merr nga aspektet gjithëpërfshirëse të etikës kur ulet me mësuesin e tij, apo kur flet me të, apo kur e

pyet atë i dëgjon me vëmendje të madhe përgjigjet e tij. Po ashtu, ai i shmanget thirrjes së tij me “Ti”, apo me emër, apo ta thërras atë prej një distance pa qenë nevoja.

### 4. Pyetjet e shpeshta

Një nga mënyrat, të cilat nuk duhet ta harrojmë kurrë asnjëherë nxënësi i dijes është që të pyesë vazhdimisht mësuesit e tij për ato gjëra që ai nuk i kupton, apo që ai has vështirësi gjatë shpjegimit të tyre. Allahu i Lartësuar thotë: **“Pyesni dijetarët nëse ju nuk dini.”** Në Sunenin e Ebu Davudit tregohet një hadith në të cilin një person ishte i plagosur në kokë dhe i pyet ata që ishin me të se çfarë duhet të bëjë meqë ishte bërë xhunub. Ata i thanë se ai duhet të merrte gjithësi gusul dhe pasi ai u pastrua, vdiq. Kur Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dëgjoji për këtë ndodhi tha: **“E kanë mbytur, i mbyttë Allahu, pse nuk pyetën kur nuk e dinin, vërtet shërimi i padijes është pyetja”.** Aishja, Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë: **“Allahu i mëshiroftë gratë e ensarëve, nuk i ndalonte turpi që të pyesnin për çështjet e fesë së tyre”.** Me një rast e pyetën Abdullah Ibën Abasin, Allahu qoftë i kënaqur me të, si e arrite diturinë? Ai tha: **“Me gjuhën e pyetësit dhe zemrën e mprehtë”.** Ibën Shihabi thotë: **“Dituria është arkë (thesar i mbyllur), kurse çelësi i saj është pyetja”.**

### 5. Mbajtja e shënimeve

Ibën Rexhebi, Allahu e mëshiroftë, thotë: **“Dituria është gjueti, kurse shkrimi është nxënia (kapja) e saj. Prandaj lidhe gjahun tënd me litarë të fortë. Prej budallallëkut është që ta zësh drerin, pastaj ta lesh të lirë.”**

Nxënësi i dijes duhet të bëjë maksimumin, që ta ruajë diturinë në formën e shkruar, sepse ta lidhësh diturinë përmes shkrimit është të sigurohesh nga humbja e saj, dhe kjo është një rrugë e shkurtër për kohën që do të të marrë kur të kesh nevojë t'i kthehesh asaj.

<sup>3</sup>Nur, 63.

<sup>4</sup>Nahl, 43

Dijetarët këshillojnë që kërkuesi i dijes duhet të mbajë fletore në të cilën duhet t'i shënojë dobitë e çmuara, të cilat do t'i dëgjojë nga dijetarët nga të cilët ai po merr dije, ose nga librat që ai lexon. Kështu që lidhe diturinë tënde duke e shkruar atë, në veçanti dobitë unike, të cilat nuk mund të gjenden në çdo vend, gjërat që janë të fshehura në qoshet e shkencave, dobi të cilat janë margaritarë të shkapërderdhur që i shohim dhe i dëgjojmë, por frikësohemi, se do të na ikin. Kështu, sepse kujtesa jonë do të dobësohet dikur dhe harresa është e evidente, prandaj Shabiu ka thënë: “Nëse dëgjon diçka, shkruaje, madje edhe në mur”.

### 6. Përkujdesja në mos-humbjen e kohës

Në Sahihun e Buhariut Abdullah Ibën Abasi, Allahu qoftë i kënaqur me të, na përcjell se Resulullahu, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Për dy begati shumë nga njerëzit mashtrohen: shëndeti dhe koha e lirë”. Nëse koha është e vlefshme për këdo, atëherë për nxënësin e dijes është nga gjërat për të cilat ai nuk duhet ta neglizhojë në asnjë moment. Hasan Basriu, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Ruajtu nga vonimi i ditëve, vërtet ti je me ditën tënde e jo me të nesërmen. Nëse ti ke të nesërme, atëherë bëhu të nesërmen ashtu si je sot, por nëse nuk ke të nesërme, atëherë nuk do të pendohesh pse e ke humbur atë ditë”.

### 7. Përsëritja e dijes së nxënë

Pa u zgjeruar shumë në këtë çështje themi se argumenti më i drejtpërdrejtë që aludon për rëndësinë e përsëritjes së diturisë është hadithi në të cilin tregohet, se i Dërguari, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, e përsëriste Kuranin së bashku me Xhibrilin, alejhi selam, çdo herë. Abdullah Ibën Xhafer Ibën Muhamedi ka thënë: “Zemrat janë tokë (vendmbjellje), dituria është ajo që mbillet, përsëritja është ujitja. Kur t'i ndërpritet tokës

uji, thahet ajo që është mbjellë.” Ndërsa Zuhriu thotë: “Me të vërtetë harresa dhe mos përsëritja janë ato që e humbin diturinë.”

### 8. Përcjellja e diturisë

Me përcjellje të diturisë kemi si qëllim që dijen e marrë nga kërkuesi, duhet t'ua përcjellim të tjerëve patjetër. Allahu i Lartësuar thotë: “**Me të vërtetë, ata që fshehin shpalljet Tona të qarta, pasi ua kemi shpjeguar njerëzve në Libër do të mallkohen nga Allahu dhe do të mallkohen nga ata** (engjëj e njerëz) **që janë ngarkuar të mallkojnë.**”<sup>5</sup> Në një transmetim të saktë Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: “Kush e fsheh diturinë Allahu i Lartësuar do t'i vërë frerët e zjarrit Ditën e Gjykimit”. Mirëpo këtu duhet të kemi parasysh se përcjellja e diturisë bëhet në formë të shkallëzuar. Dahaku, Allahu i mëshiroftë, e sqaron më së miri këtë gjë kur na thotë: “Kapitulli i parë në dituri është heshtja, i dyti është dëgjimi i diturisë, e treta të punuarit me të, kurse e katërta shpërndarja dhe të mësuarit e të tjerëve.” Kështu që mos u ndal nga detyrimi i mbartjes dhe kalimit të diturisë (tek të tjerët) me pretekstin se kanë arritur kohë të këqija, apo se njerëzit e këqij mbizotërojnë dhe se efektet e dhënies se këshillave të sinqerta janë të dobëta, meqë detyrimi yt është përcjellja, kurse pranimi apo refuzimi i asaj nuk është në dorën tënde.

### 9. Mosdhënia pas kësaj bote

Seid Huderiu, Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë: “Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, u ul në minber, ne u ulëm rreth tij dhe ai tha: “Vërtet ajo nga e cila i frikësohem për ju pas meje është që Allahu do t'ua hapë dynjanë me lulëzimet e saj dhe zbukurimet.”

Imam Muhasibiu, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Dije se drita e ditës nuk i bën dobi qorrit e gjithashtu edhe drita e diturisë nuk i

<sup>5</sup>Bekare, 159.

<sup>6</sup>Muslimi.

*bën dobi përveçse të devotshmëve. Sikurse të vdekurit që nuk i bënë dobi ilaçi (bari), ashtu edhe etika (moral) nuk i bën dobi pretenduesit. Dhe sikurse shiu nuk e gjallëron tokën me gurë (jopjellore), ashtu edhe zemra e cila është e dhënë pas dynjasë nuk mundet të shfaqë urtësi”.*

### 10. Maturia dhe kontrollimi i entuziazmit

Shumë nga të rinjtë që e fillojnë rrugën e nxënies së dijes preokupohen me entuziazmin e tyre dhe e ngarkojnë veten me më shumë se sa kanë mundësi ta përballojnë. Kjo në fillim mund të jetë efektive, por pas një farë kohe, ata lodhen, mërzhiten dhe kjo i bën që të largohen nga rruga që kanë nisur. Prandaj ata kanë nevojë të jenë të matur në këtë drejtim dhe të ecin rrugës së diturisë, duke iu përmbajtur një rregull të paracaktuar, që e ka vënë kërkuesi i dijes, duke u këshilluar me mësuesit dhe hoxhallarët nga të cilët ai po merr dije, dhe duke i pasur parasysh mundësitë dhe aftësitë e veta.

### 11. Zbatimi i diturisë me vepra

Nxënësi i singertë i dijes duhet sa herë që përparon me dituri dhe shkencë t'i duket fryti i saj, në besimin dhe devotshmërinë e tij. Ai duhet ta pyesë veten, se: a i vëren shenjat e diturisë në veten e tij, Allahu i Lartësuar thotë: ***“O besimtarë, përse thoni atë që nuk e bëni? Është shumë e urryer për Allahun të thoni atë që nuk e bëni!”*** Prandaj kërkuesi i dijes karshi diturisë që ka marrë duhet t'i plotësojë këto detyrime:

- Ta praktikojë diturinë e fituar.

- Ta urrejë që të lavdërohet për diturinë që ka marrë, ose të ketë dëshirë të marrë komplimente apo të tregojë mendjemadhësi ndaj të tjerëve.

- Ta shtojë modestinë sa më shumë, që kjo e shton diturinë.

- T'i iki famës, dëshirës për të qenë i pari në

udhëheqje dhe kënaqësive të tjera të dynjasë.

- T'i braktisë pretendimet, se ka dituri dhe mburrjen me këtë gjë.


### 12. Kujdes nga fanatizmi me dijetarët dhe mësuesit

Një nga problemet me të cilat ballafaqohet nxënësi i dijes është fanatizmi ndaj dijetarëve nga të cilët ai ka marrë dije dhe pretendimi se e vërteta mund të burojë, vetëm nga ajo që thotë mësuesi dhe dijetari nga i cili i ka marrë ato dije. Kërkuesi i diturisë duhet të ndjekë rrugën e atyre që kanë qenë para tij (selefët), duke pasuar Sunetin e të Dërguarit, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, dhe nga metodologjia e tyre ishte sa ata kapeshin pas së vërtetës dhe jo pas njerëzve. Pa u zgjatur shumë në këtë çështje mund të themi se thëniet që nuk janë të Allahut të Lartësuar apo të Dërguarit të Tij (pra, nuk janë Kuran dhe Hadith), nuk janë fjalë të pagabueshme. Kushdo përveç profetëve fjala e tij ka mundësi të jetë e gabuar apo është e mundshme të jetë e pasaktë, prandaj nuk pranohet thënia e tij, derisa të peshohet me Librin e Allahut dhe Sunetin e Profetit, lavdërimi dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të. Me pak fjalë thënia e kujtdo nuk merret si e saktë apo e refuzuar pa iu nënshtruar peshores së Kuranit dhe Sunetit; ajo që pajtohet me të merret, jo për hir të thëniesit, por për hir të së vërtetës dhe ajo që është në kundërshtim me këto dy baza, lihet dhe nuk merret, pa marrë parasysh kush është thënësi dhe çfarë qëllimi kishte ai, të mirë apo të keq.

Te muslimanët nuk ka njerëz të shenjtë dhe të pagabueshëm, pasi e dimë dhe jemi të bindur, se në mesin e njerëzve nuk ka të pagabueshëm, përveç të Dërguarve, të cilët janë në mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Allahut të Lartësuar. Prandaj është Urtësia e Allahut të Lartësuar, që thëniet e dijetarëve të mos trajtohen në Islam, si argumente më vete dhe të veçanta, të cilat pranohen pa iu nënshtruar peshores së Kuranit dhe të Sunetit. ■

<sup>7</sup> Saff, 2-3.

# NË KËRKIM TË LUMTURISË



**Nuk është e vështirë që të ecësh në drejtimin e kundërt, duke ngulur këmbë në botëkuptimin, se të tjerët duhet të përkujdesen në maksimum për ty, t'i akuzosh të tjerët dhe t'ua hedhësh fajin atyre se janë ata përgjegjës nëse ty nuk të shkojnë punët si duhet**

## PËRGATITI: AGRON TERZIQI

**T**ë gjithë e synojmë dhe e kërkojmë lumturinë, por duhet të kemi parasysh se ajo nuk është objektiv në vetvete, mirëpo ajo duhet të jetë rezultat i një pune, që e duam dhe e admirojmë, si dhe i raporteve të sinqerta që ndërtojmë me të tjerët.

Lumturia prehet në atë që të jesh vetvetja, vendimet e mëdha t'i marrësh vetë, të punosh atë që dëshiron, sepse e ke me qejf, të jetosh jetën duke u kënaqur me të gjitha pjesët dhe momentet e saj. Ajo arrihet atëherë kur fiton pavarësinë nga të tjerët dhe ua mundëson atyre që të përjetojnë lirinë dhe pavarësinë e tyre - duke pasur në konsideratë gjithmonë dispozitat e sheriatisht - dhe të zbulosh gjërat më të vlefshme në vetvete dhe në botën që të rrethon.

Nuk është e vështirë që të ecësh në drejtimin e kundërt, duke ngulur këmbë në botëkuptimin, se të tjerët duhet të

përkujdesen në maksimum për ty, t'i akuzosh të tjerët dhe t'ua hedhësh fajin atyre se janë ata përgjegjës nëse ty nuk të shkojnë punët si duhet, dhe se je duke jetuar në margjina, në vend që të jesh në qendër të vëmendjes.

Ti bën një jetë jo të lumtur, kur nuk e jeton atë sipas natyrës së saj të vërtetë, dhe atëherë ndihesh se jeta për ty nuk ka ndonjë kuptim apo synim. Allahu e bëri jetën që ajo të jetë për ty, Ai t'i dhuroi të gjitha dhuntitë e mundshme dhe të bëri ty mëkëmbës në tokë, që ta realizosh kuptimin real të jetës. Nëse jeta ecën në atë drejtim që ti nuk je i kënaqur prej saj, atëherë mos akuzo askënd tjetër përveç vetes tënde. Askush nuk të ka ty borxh për asgjë, ti je i vetmi njeri që mund të bëjë ndryshime në jetë, sepse një përkrahje e vogël që mund të ta ofroj dikush aty-këtu, nuk mund të konsiderohet asgjë, nëse nuk ngulmon që ta përshkosh të tërë rrugëtimin i vetëm pavarësisht nga pengesat, që has në rrugë.

## “Askush nuk të ka ty borxh për asgjë, ti je i vetmi njeri që mund të bëjë ndryshime në jetë...”

Çfarëdo premtimesh që të japin të tjerët nuk kanë kurrfarë peshe dhe force, që ta realizojnë atë ndryshim. Tradhtia dhe kapitullimi – edhe përkundër ndikimit të madh – nuk kanë fuqi që ta ndalojnë rrugëtimin e përparimit tënd dhe pengimin e suksesit, nëse ti nuk krijon prej tyre një alibi për të dështuar.

Allahu të ka vendosur në veten tënde një forcë të madhe, që të triumfosh ndaj të gjitha barrierave, me qëllim që të përballesh me jetën në mënyrë të drejtpërdrejt. Ti si një njeri që dëshiron të bëjë një jetë të lumtur duhet të ballafaqohesh me lloj-lloj sfidash gjatë tërë kohës dhe t'i tejkalosh ato. Gjëja e parë me të cilën duhet të përballesh, është ai botëkuptim i kotë, se ekziston dikush, që duhet të hyjë në jetën tënde, që t'i bëjë të gjitha ndryshimet e duhura. Mos ëndërro se do të vijë dikush e të të shpëtojë, të të japë një shtytje të madhe për të ecur përpara e të përparosh, dhe që do t'i zbulojë aftësitë tua e t'i hapë dyert e jetës.

Pas caktimit të Allahut, ti je i vetmi njeri që mund të luajë rolin e shpëtimtarit, ose përndryshe do të jetosh si i mjerë. Ti meriton të jesh i lumtur, je i denjë gjithashtu që të arrish atë që synon, prandaj kur t'i vështrosh gjërat e mjerueshme në jetën tënde do të vësh se ato janë një regjistër i gjërave që ke dështuar për të qenë vetvetja.

Dëshpërimi yt në realitet nuk është gjë tjetër veçse një zile, e cila tingëllon me qëllim që të përkujtojë, se ka gjëra që duhen bërë për ta rikthyer lumturinë. Përjetimi i lumturisë është që njeriu të pëlqejë mënyrën se si ndjehet, sepse të qenit i palumtur do të thotë se nuk preferon ndjesinë që ti po ndjen.

Ji i hapur ndaj së ardhmes dhe mos u frikëso prej saj. Duaje veten tënde me të gjitha cilësitë dhe karakteristikat që ke – ndoshta nuk meriton të duhet çdo gjë tek ti –, mirëpo esenca jote gjithsesi e meriton një gjë të tillë.

Realizimi i lumturisë kërkon shpesh nga ti, që të futesh në disa aventura të vogla e të rrezikshme, mirëpo në të njëjtën kohë shumë të rëndësishme. Ti ke nevojë që t'i bindësh të tjerët të të vlerësojnë drejt, prandaj largohu prej polemikave dhe debateve të panevojshme.

Duhet të flasësh gjithmonë të vërtetën dhe të ndalesh së gënjeri veten. Përfundoje luajtjen e rolit të viktimës, që të kesh mundësi të kënaqesh me sukseset e tua pa u ndier fajtor. Që ta arrish lumturinë duhet të jesh vetvetja e jo të shtiresh se je dikush tjetër.

Ti ke nevojë që të lirohesh prej mendimeve, të cilat kanë rezultuar nga botëkuptimet, se si do të duhej të ishte jeta, ashtu që më pas të mos gjykosh pa të drejtë për njerëzit se janë egoistë dhe interesaxhi. Mos e shiko jetën përmes kujtimeve të kaluara. Duhet të mësohesh të praktikosh faljen dhe ndjesën, sepse kjo do ta lehtësojë shumë rrugëtimin e jetës. Sillu në mënyrë serioze, mirëpo jo deri në atë shkallë sa ta detyrosh veten të jesh gjatë gjithë kohës i përsosur, duke lënë anash njohjen e gabimeve dhe të anëve negative. Dije se ti je në gjendje të përparosh vazhdimisht, prandaj ke shumë nevojë që t'i përcaktosh vetes një objektiv, i cili do ta orientojë jetën tënde. Pastaj duhet të punosh me zell deri në realizimin e plotë të atij objektivi, duke ndërtuar kështu jetën, që ti e ke dëshiruar gjithmonë. Realizimi i lumturisë kërkon punë gjatë gjithë jetës. Meqë ti do ta bësh jetën të veçantë për veten tënde, atëherë mundohu ta jetosh në formën dhe mënyrën më të mirë. ■

# BOTIMI I VEPRËS SË HAFIZ ALI KORÇËS – NGJARJE E MADHE KULTURORE

(Në shtatorin e vitit 2007 doli në qarkullim vepra e plotë – në dymbëdhjetë vëllime – e Hafiz Ali Korçës (1873-1956), të cilën e hulumtoi, e studioi, e analizoi dhe e përgatiti për botim prof. dr. Ismail Ahmedi. E botoi Shtëpia Botuese “Logos – A” në Shkup, drejtues i së cilës është mr. Adnan Ismaili.)

PROF. DR. MEHDI POLISI

**K**ëtë shkrim po e bëj jo pse jam njëri nga recensentët e kësaj vepre madhore – që të them të vërtetën e ndiej veten shumë të nderuar e të respektuar, - por e bëj pikërisht për faktin se vepra ka vlera të larta politike, patriotike, edukative, arsimore, letrare, gjuhësore, përkthyes, historike, publicistike, kulturore, islamistike etj., - të gjitha këto në shërbim të shoqërisë njerëzore përgjithësisht dhe të shoqërisë shqiptare veçanërisht. Duke u nisur nga këto vlera të pakontestueshme mora guximin dhe sigurisht që nuk gabohem, që botimin e veprës së Hafiz Ali Korçës, të përbërë prej dymbëdhjetë vëllimesh ta konsideroj si një ngjarje të madhe kulturore. Për daljen në dritë të kësaj vepre madhështore, profesori i

nderuar Ismail Ahmedi punoi për vite me radhë, duke gjuarmuar, siç thotë ai, nëpër institute, arkiva, biblioteka publike e personale nga njëra anë, dhe duke shfrytëzuar dokumente arkivore, vepra biografike, korrespondenca të ndryshme që Hafiz Aliu mbante me burra shteti, me



intelektualë, me universitete, me redaksi të ndryshme të vendit dhe të jashtme, nga ana tjetër. (Vepra 1, fq. 18). Për këtë dhuratë të madhe, të cilën profesor Ahmedia ia dha lexuesit dhe kulturës shqiptare e shoh të arsyeshme që të bëj një vështrim të shkurtër.

Ndër veprat e shumta që tashmë ka lënë pas vetes prof. Ahmedia do të thosha se vepra jetike e tij është vepra që lidhet me njërin nga personalitetet e shquara shqiptare, Hafiz Ali Korçën. Hulumtimin dhe studimin e veprës së kësaj figure të madhe shqiptare, të nisur disa vite më parë, Ahmedia e realizoi me sukses në shtatorin e vitit 2007, duke i botuar njëherësh, siç u tha edhe më lart dymbëdhjetë vëllimet, përkatësisht pesëmbëdhjetë vepra të Hafiz Aliut, në qoftë se kemi parasysh se në vëllimin nr. 6 janë përfshirë dy dhe në vëllimin nr. 7 tri vepra. Në të vërtetë serinë e këtij botimi të veprave të Hafiz Ali Korçës e përbëjnë: *Hafiz Ali Korça – Jeta dhe vepra*, me këtë nis seria e këtij botimi dhe mban numrin rendor 1; *Shtatë ëndrrat e Shqipërisë* (nr. 2); *Jusufi e Zelihaja* (nr. 3); *Historia e shenjtë dhe katër halifetë* (nr. 4); *Çelësi i Librit* (nr. 5); *Abetaret* (janë dy abetare njëra: Abetare e gjuhës shqipe dhe tjetra Abetare e gjuhës arabe) (nr. 6); *Myslimanija; Mevludët; Treqint e-tri fjalët e Imam Aliut* (nr. 7); *Tefsiri i Kur'anit* (nr. 8); *Bolshevizma a çkatërrimi i njerëzimit* (nr. 9); *Rubajjati* (katrorët e Umer Khajamit) (nr. 10); *Gjylistani a trëndafilishta e Sadiut* (nr. 11) dhe *Publicistika dhe shkrime të tjera* (nr. 12). Vepra nga fusha të ndryshme dhe me tema të llojllojshme.

Është shumë e vërtetë se t'i gjeshe e t'i tubosh të gjitha këto vepra, sidomos kur ato për një kohë të gjatë kanë qenë të shpërndara andej-kënde, të mbuluara nga

**“...Ai ishte largpamës, sepse shumë herët e kuptoi se bolshevizmi dhe komunizmi do të jenë rrezik për shoqërinë njerëzore në përgjithësi dhe për shoqërinë shqiptare në veçanti...”**

pluhuri i kohës dhe me tendencën për të qenë larg syrit të lexuesit, sa për arsye të autorit të tyre, sa për arsye të temave të parashtruara, të cilat nuk përputheshin me rrethanat politike-shoqërore dhe ideologjike, që mbretëronin asokohe në Shqipëri,- ka qenë punë e vështirë, ka qenë punë që ka kërkuar një kohë të gjatë hulumtimi, madje një angazhim të veçantë, por mendoj se dëshira, vullneti, bile do të ishte më mirë të thosha obligimi intelektual për t'i dalë hakut dhe për ta ndriçuar figurën e madhe të kombit tonë, Hafiz Ali Korçën, kanë qenë për Ahmedin shtytje për t'i kapërcyer të gjitha pengesat, që i kanë dalë eventualisht përpara. Sidoqoftë merita e Ismail Ahmedit këtu është jashtëzakonisht e madhe, sepse me këtë ai ia doli në krye detyrës që këtë kapital kulturor ta bëjë pronë të bibliotekave tona dhe që edhe brezi ynë, pas mbi pesëdhjetë vjet nga vdekja e intelektualit tonë të madh, Hafiz Ali Korçës, për të cilin njohuritë tona fatkeqësisht kanë qenë shumë të mangëta, të komunikojë me të. Kjo është punë e madhe dhe për këtë e përgëzojmë prof. dr. Ismail Ahmedin.

Hafiz Ali Korça ishte një burrë plot vlera shpirtërore e patriotike, një shembull atdhedashurie, një

përparimdashës për atdheun tonë. Deviza dhe ëndrra e tij kryesore ishte kjo që ai gjithmonë dëshironte që vendin dhe popullin e vet ta shohë të ditur, të shkolluar, të kulturuar, të qytetëruar, me të drejta të barabarta me të gjithë popujt e tjerë të botës. Hafiz Ali Korça pra, është një figurë e madhe e kombit tonë. Ai ishte autor tekstesh shkollore, sepse përpiloi, për shembull, *Abetaren e gjuhës shqipe*, *Abetaren e gjuhës arabe* (në gjuhën shqipe), *Morfosintaksën e gjuhës arabe në gjuhën shqipe* (ka të ngjarë që kjo të jetë e para vepër e këtij lloji në gjuhën shqipe) etj., pikërisht në kohën kur shqiptarët dhe shkolla shqipe kishin nevojë më shumë për to, gjithmonë duke u përpjekur të gjente metoda të reja për mësimdhënie e mësimnxënie. Hafiz Aliu, duke shfrytëzuar tekstet shkollore të përgatitura në Evropë dhe përvojën e tij personale, pati sukses të jashtëzakonshëm në këtë fushë. (Shih vep. 2, fq. 48 e tutje). Kjo kërkesë është mjaft aktuale në ditët tona.

Ai ishte edhe publicist e gazetar. Duke dhënë artikuj të shumtë e me vlerë në periodikun e vendit dhe të huaj, sidomos në atë turk, persian dhe arab, emri i tij gjithnjë e më tepër bëhej i famshëm. Prandaj redaktorët, kryeredaktorët dhe drejtorët e shtëpive botuese, duke parë vlerën e tij, i drejtoheshin Hafiz Aliut me fjalët “*Lutemi të na zbukuroni shtyllat e fletoreve me artikujt e bukur të zotërisë suaj.*” (Vep. 10, fq. 12). Duhet thënë se veprimtarinë e tij Hafiz Ali Korça e nisi në gazetari, që në vitin 1894, posa kishte mbaruar studimet në Stamboll. Hyrja e tij në gazetari pa dyshim se nuk ka qenë e rastësishme, por kërkesë e kohës, sepse në këtë kohë, pra, në fundshekullin e 19, vendin tonë siç dihet edhe nga historia, e kishte përfshirë një valë e problemeve politike, sociale, kulturore etj. Në fakt

pyetjes përse i jepte artikuj, sidomos shtypit të huaj, Hafiz Aliu i përgjigjet më së miri vetë, prandaj t’ia japim atij fjalën: “*Qëllimi im, thotë ai, s’ka qenë tjetër vetëm se kam dashur t’i qaj hallin e t’iu kallëzoj se ç’pa drejtësi e rreptë iu bë Shqipërisë...*” për të vazhduar më poshtë “*Unë iu shkruanja kësi soj me një qëllim që kur të vinte do një ditë – kështu si ardhi sot – edhe kur të shtroheshin burat politikanë reth tavolinës për ta caktuar fatin e shteteve, atëherë na shqiptarët me anën e radios t’iu adresoheshin këtyre...*” (Vep. 2, fq. 116).

Ai ishte shkrimtar – poet, sepse shkroi veprat poetike *Shtatë ëndrat e Shqipërisë*; *Historia e shenjtë edhe të katër Halifetë*; *Jusufi me Zelihan*; etj. Vepra letrare *Shtatë ëndrat e Shqipërisë* është me temë kombëtare e patriotike. Idetë që shfaq në këtë vepër janë plotësisht aktuale edhe sot e kësaj dite. Është luftëtar i denjë kundër politikanëve të papërgjegjshëm dhe të pandërgjegjshëm. Me rastin e zgjedhjeve të para demokratike në Shqipëri, më 1923/4, Hafiz Aliu punon në dy rrafshë: në njërin i drejtohet popullit, duke i thënë: “*Sot zgjedhja e asamblastavet është në dorët tuaj. Frikën, interesën flakeni prapa krahëvet. Për asamblast zgjidhni ata që janë të zotët e punës, janë fetarë të drejtë, atdhetarë të vërtetë edhe trima që s’tremben prej kujt...*”, kurse në tjetrin u drejtohet “asamblastavet”, duke ua tërhequr vërejtjen me fjalët: “*Sot fati i Shqipërisë është në duart e juaja*”.

Ai është islamolog, sepse në fushë të islamistikës ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm, duke shkruar e botuar artikuj të njëpasnjëshëm në revistën *Zani i Naltë*, nga viti 1924 deri në vitin 1929. Paraqitjet e Hafiz Ali Korçës në tubime të ndryshme linin mbresa dhe ndikonin te çdonjëri për nivelin e ngritur fetar e



kulturor, për temat e trajtuara etj. Ai i përgatiste ato me kujdes, krejtësisht në mënyrë të rregullt, ashtu siç e kërkonte koha, pra, në përputhje me shqetësimet e popullit, problemet edukative, me një fjalë me situatat dhe rrethanat e krijuara. Ashtu si në shkollat laike, edhe në shkollat islame ai ishte reformator. Megjithatë referenca kryesore në fushë të islamistikës për Hafiz Aliun ka qenë përkthimi dhe komentimi i Kur'anit (tefsiri). Sipas shënimeve që kemi nxjerrë nga vepra e tij, shohim se Hafiz Ali Korça e kishte përfunduar përkthimin dhe komentimin e Kuranit në vitin 1920 në një shtrirje prej 2,000 (dy mijë) faqesh, por për shkak të mungesës financiare nuk kishte arritur ta botonte. Ja se si shprehet ai për këtë punë: *“Para dhjetë vjet (1915-1920) dyk e vënë shumë llojesh Tefsirë përpara pata shkruar gjër e gjatë mjaft tefsirë. Por për qitjen e tij në dritë më duheshin më tepër se dy mijë napolona; pra shtypjen e këti e lashë për një kohë më vonë...”* (Shih Vëll. 8, fq. 11). Ky tefsir jo që nuk është botuar, por mjerisht edhe dorëshkrimi të tij me sa jam në dijeni, nuk i ka mbetur as nami, as nishani. (Vepra të pabotuara të Hafiz Ali Korçës kanë mbetur edhe shumë të tjera, bile ç'është më e keqja, nuk dihet gjë për fatin e tyre). Një humbje e madhe, sidomos kur dihet se është shkruar nga dora e një mjeshtri të madh i kësaj fushe të dijes, nga një njeri plot energji.

Ai ishte filolog i mirëfilltë, sepse i njihte rrënjësisht gjuhën turke, persiane, arabe, frënge etj.; njihte gjerësisht dhe thellësisht edhe letërsinë e tyre. Se ka qenë vërtet i tillë e dëshmon vepra e tij, që kryesisht është rezultat i njohjes së këtyre gjuhëve. Kjo në një mënyrë mund të vërehet nga rreshtat e sipërshënuara. Ai ishte largpamës, sepse shumë herët e kuptoi se bolshevizmi dhe komunizmi do të jenë rrezik për shoqërinë njerëzore në

përgjithësi dhe për shoqërinë shqiptare në veçanti, prandaj kësaj teme do t'i kushtojë një vepër të veçantë me titullin e qëlluar *“Bolshevizma a çkatërimi i njerëzimit”*, të cilën e botoi në vitin 1925. Ai ka qenë pedagog dhe drejtues i institucioneve të larta: ka qenë profesor i gjuhës arabe, turke, persiane dhe i letërsive të tyre, pastaj i matematikës, historisë, gjeografisë, si në shkollat laike, ashtu dhe në medresetë. Ka qenë Këshilltar i Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë, Drejtor i Përgjithshëm i Arsimit dhe Kryetar i Këshillit të Naltë të Sheriatit. Prej këtij postit të fundit është shkarkuar me rastin e botimit të veprës *Shtatë ëndrrat e Shqipërisë*. Pra, njeri me kapacitet të lartë.

Ndërkaq në veprën e tij *Hafiz Ali Korça – Jeta dhe vepra*, e cila është në ballë të serisë së botimit të dymbëdhjetë veprave për të cilat po flasim këtu, e shtrirë në 376 faqe, Ismail Ahmedi, duke u mbështetur në veprat origjinale të dijetarit të madh, Hafiz Ali Korçës, po ashtu e ndjek veprimtarinë politike-patriotike, kulturore-pedagogjike të tij nga shumë aspekte dhe në hollësi. Kjo flet sesa me përkushtim i ka hyrë kësaj pune të madhe. Përmes përshtimit real të aktivitetit politik, shoqëror, pedagogjik, letrar, kritik, gjuhësor, islam etj. të Hafiz Aliut, të përfaqësuar në këtë vepër monografike, Ahmedi na jep dhe shumë e shumë të dhëna e njohuri të shumta për rrethanat politike, ekonomike, arsimore etj., pastaj për shumë personalitete të njohur, pak ose aspak të njohur, revolucionarë ose reaksionarë të periudhës kur jetoi e veproi patrioti ynë, Hafiz Ali Korça. ■

# NJË BOTË KU GRUAJA SUNDON FUQIPLOTË (FRYTET E RIVLERËSIMIT TIM)

Një grua e shkolluar dhe me nivel, më parë e martuar me një diplomat, ajo kishte hequr dorë nga mënyra perëndimore e jetesës për ta zëvendësuar me shaminë. Në mendjen time ajo e kishte dënuar veten me burgim të përjetshëm

## MERI UOKËR

**K**ur dy vite më parë hyra në grupin e serialit “Islami i përjetuar”, perceptimi im për Islamin sundohej nga paragjykimi dhe mosdija, teksa më neveriste trajtimi nga ana e tij e gruas. Për mua shamia simbolizonte shtypjen e femrës, duke e kthyer në të padukshme, anonime dhe të pagojë dhe fryti i kësaj shtypjeje ishte krijimi i një hierarkie familjare me bazë patriarkale – themeli bazë i Shoqërisë Islame. Më ishte krijuar përshtypja, se ajo kishte ulur kokën para justifikimit hyjnor të rolit të saj si grua dhe nënë.

Për realizimin e serialit “Islami i përjetuar” janë kryer dy vite punë në 19 vende të ndryshme me një grup xhirimi mashkullor përjashto mua, të vetmen femër. Isha e vetëdijshme se duhej të tregoja sjellje shembullore. Në mendjen time gruaja sipas traditës nuk duhej, as të shihej, as të dëgjohej. Udhëtimi i parë ishte në Mali – në një komunitet atipik që jetonte në djerrinë. Në përpjekje për të mbuluar çdo centimetër të trupit teksa meshkujt silleshin përreth me mëngë të shkurtra, para se të lëvizja, vrisja mendjen se në cilat dhoma më lejohej të hyja dhe me cilët njerëz më lejohej të flisja. Ndërkohë pyesja veten nëse qëndrimi im ishte rrjedhojë e reagimit ndaj një shoqërie

patriarkale ku rastisa. A përjetonte të njëjtën ndjesi dorëzimi edhe një grua myslimane para një situatë të pamundur?

Gruaja e parë, të cilën e hasa në këtë vend ishte shumë larg imazhit të mjegulluar të deriatëhershëm për gruan muslimane. Ishte gruaja e një sheiku, i cili i ishte përkushtuar kthimit në Islam të fshatarëve paganë. Një grua e shkolluar dhe me nivel, më parë e martuar me një diplomat, ajo kishte hequr dorë nga mënyra perëndimore e jetesës për ta zëvendësuar me shaminë. Në mendjen time ajo e kishte dënuar veten me burgim të përjetshëm. Ndërkohë para meje s’shihja asnjë të burgosur, as ndonjë skllave të tiranizuar, por përkundrazi një grua të zgjuar dhe me autoritet, të themi një grua “me pantallona”. Ky lloj izolimi e kishte kompensuar me një vend të nderuar, duke i dhënë mundësinë të ushtronte kontroll nga brenda katër mureve pa u përballur me njeri. Ajo hynte në marrëveshje me këdo, ishte kryefamiljare dhe i dëgjohej zëri në punët e bashkëshortit.

Gruaja e emancipuar në Perëndim përballë me konfliktin mes pranimit të saj si femër, privilegjeve që e shoqërojnë këtë tipar dhe mospranimin e kufijve, që cakton roli i saj si grua, shoqëruar me gjithë kufizimet e imponuara nga mashkulli. Bazuar në një këndvështrim të tillë, gruaja në fjalë i kishte



kthyer këto kufizime në privilegje.

Në udhëtimin vijues në Nigerinë e veriut u takova me dy gra që më bënë të ndryshoj më tej mendim. Ishin dy pjesëtare të familjes së Sheik Zakzakit, një predikues i zjarrtë, i cili i nxiste mbështetësit e tij ta zëvendësonin regjimin aktual imperialist perëndimor me një shtet islam. Zejna Ibrahim, gruaja e Zakzakit dhe Fatima Junusi, shoqja e saj pranuan të japin një intervistë mbi rolin e gruas në Islam. Ato mbanin shami, ndërkohë që mund të bisedonin vetëm me një grua. Producenti më kërkoi ta zhvilloj unë intervistën. Isha disi në ankth, sepse ishte hera e parë që kryeja një intervistë. Më mundonte fakti se simpatitë e mia feministe do të më armiqësonin me të dy gratë. Mirëpo ishin pikërisht këto simpati, për të cilën Zejna dhe Fatima treguan kureshtje. Edhe këtë herë, gratë ishin të arsimuara dhe të ngritura. Gjithashtu ato kishin mohuar mënyrën perëndimore të jetesës, që vlerësohej si një

## “S’është liri kur thoni se gruaja duhet të zhvishet. Është shtypje, pikërisht sepse burrat i duan ashtu ...”

shkallë më e lartë se Islami për sa i takon trajtimit të femrës.

Teksa u ula mbi një tapet në oborr, kufiri i padukshëm që ndante mjedisin mashkullor nga ai femëror ishte i mirëpritur dhe brenda tij sundimi i gruas ishte i plotfuqishëm. Ky ishte një kontrast i thellë me ndjesinë që më ishte krijuar duke qëndruar në vende me meshkuj, ku prania ime ishte trajtuar vetëm si “mik nderi”. Kishim filmuar festimet e faljes, që shënonte fundin e muajit Ramazan. Kudo vetëm burra: 500 000 syresh, të mbledhur për faljen e bajramit derdheshin ngado në oborin e Emirof Kanosë për të kryer ritin e shenjtë – isha mirënjohëse që isha lejuar të merrja pjesë, por me çfarë çmimi, ama? Me asgjësim të identitetit femëror?

Dhe ja tani ku marr frenat në dorë, në sajë të gjinisë sime. U harrua ndjesia e inferioritetit dhe e përjashtimit, si një fillestare e rrethuar nga mjeshtra njohës të Islamit, në rolin e pjesëtares së një shoqërie patriarkale. Tashmë të përjashtuar ishin burrat. Përveç kameramanit dhe teknikut të zërit, të tjerët duhej të qëndronin larg. Kameramani e mbuloi kamerën dhe kokën me një copë të zeze – shamia e tij. Tashmë ndodhesha në një botë, ku ishte zëri i burrit që nuk dëgjohej.

Gjatë intervistës vura re frytet e rivlerësimit tim. Gratë theksuan se shamia përfaqëson mohimin e një sistemi të papranueshëm vlerash, që e poshtëron gruan, ndërsa Islami e ngrë gruan në një vend të nderuar dhe të respektuar. “S’është liri kur thoni se gruaja duhet të zhvishet. Është shtypje, pikërisht sepse burrat i duan ashtu.” Për ne shtypja personifikohet tek shamia,

ndërsa për ato te minifundi dhe dekolteja. Ato ishin të mendimit se në Perëndim gratë mashtrohen nga burrat. Më lanë të besoj se jemi të çliruara në një mënyrë, por të skllavëruara nga shikimi mashkullor. Sido që unë ngul këmbë mbi të drejtën e zgjedhjes së veshjes, s'mund ta mohoj se kjo zgjedhje shpesh diktohet nga ajo çka do ta bëjë trupin tim më tërheqës për një mashkull. Gruaja nuk mund ta përjashtëjë pamjen e jashtme nga identiteti i saj si femër, prandaj ne biem në kurthin e konceptit tradicional për femrën, ku rregullat vendosen nga meshkujt.

Duke zgjedhur veshjen e shamisë, këto gra kishin marrë një vendim të vetëdijshëm për përcaktimin e rolit të tyre në shoqëri dhe marrëdhënies me meshkujt. Kjo marrëdhënie ishte e bazuar më tepër në respektin e ndërsjellë (një respekt që mungon në marrëdhëniet ndërpersonale në Perëndim), në kundërshtim me modelin zotëri/shërbëtores, që kisha krijuar në mendje. Shamia ishte dëshmi e përkushtimit fetar, urë lidhëse mes burrit dhe gruas, dhe që për Zejnën dhe Fatimën ishte më i fortë se ideali politik.

Ku shfuqizohej nocioni im i shtypjes i lidhur me shaminë? Nëse përkufizimi i barazisë përkthehej me vullnet të lirë, atëherë as shtypjen nuk mund ta trajtoja më si një simptomë të Islamit. Gratë në fjalë kishin bërë një zgjedhje. Në një farë mënyre, ato ishin më të lira se unë – unë vetë kisha më pak kontroll mbi fatin tim. Nuk mund t'i tregoja me gisht si të shtypura duke harruar veten time. Jeta ime ndikohej nga meshkujt ashtu si jeta e tyre – por elementi i zgjedhjes tek e imja mungonte. Situata dhe argumentet e tyre kishin shërbyer për të vlerësuar të metat lidhur me pikëpamjen mbi lirinë time. ■

*(autorja është koordinatore produksioni në realizimin e serialit "Islami i përjetuar" nga BBC2. Marrë nga Impact Magazine).*

Përktheu: A. GUNI

# SI TA KULTIVOJMË LOGJIKËN E FËMIJËS?

**Mësimi në fëmijëri është më efektiv, se sa më vonë. Para nesh shtrohet pyetja se çfarë mësojnë fëmijët tanë?**

Fëmija ka një tru të kthjellët, sepse ai nuk është i angazhuar me probleme, të cilat angazhohen me to të mëdhenjtë, por në të njëjtën kohë është edhe mjet i mprehtë. Për këtë arsye vërejmë se fëmijët janë në gjendje të mësojnë shumë shpejt dhe të mbajnë mend shumë. Mësimi në fëmijëri është më efektiv, se sa më vonë. Para nesh shtrohet pyetja se çfarë mësojnë fëmijët tanë?

Nëse ia hedhim një vështrim situatës së fëmijëve tanë shohim se një numër i konsiderueshëm i tyre mësojnë këngë, emra këngëtarësh, emra lojtarësh futbollit, emra artistësh etj. Ndërsa në programin e tyre nuk ekziston se duhet të mësohet diçka nga Kurani apo hadithi i Muhamedit *sal-lallahu alejhi ue selem*. Nëse i qorton prindërit e tyre për një gjë të tillë, ata arsyetohen se nëse do t'ua bënin fëmijëve një program ku të mësojnë Kuran apo hadith do të ngarkohen shumë dhe kjo do të ndikojë

në përgatitjen e mësimeve shkollore.

Pra, ne jemi pranë një situatë, e cila kërkon prej nesh që të jemi sa më të kujdesshëm për të ardhmen e fëmijëve tanë, duke shfrytëzuar dhuntitë e tyre intelektuale në dobi të tyre. Për të arritur një gjë të tillë do të përmendim disa gjëra për të cilat duhet të kujdesemi për to.

Fillimisht prindi duhet t'i japë përparësi mësimit të Kuranit.

Nëse prindi i mëson Kuranin fëmijës së vet do të ketë shpërblim prej Krijuesit të tij.

Na përcjell Hakimi, se i Dërguari i Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: *“Kush lexon Kuran, ua mëson të tjerëve dhe punon me te, Ditën e Kiametit do të ketë mbi kokë një kurorë prej drite si dielli. Ndërsa prindërit e tij do të vishen me një petk të cilin nuk e ka askush, e do të thonë pse u veshëm ne me këtë petk. Do t'u thuhet për hir të Kuranit që ia keni mësuar fëmijës tuaj.”*

Pas Kuranit prindi duhet që t'i mësojë fëmijës së vet ndonjë hadith të Muhamedit *sal-lallahu alejhi ue selem*, duke zgjedhur për këtë hadithe të shkurtra dhe të lehta për nga kuptimi, që i përshtaten moshës së fëmijës. Sa për ilustrim kemi hadithin, të cilin na e përcjell Tirmidhiu nga Rebia ibën Shejban, *radijallahu anhu*, ku thotë: *“I thashë Hasanit birit të Aliut radijallahu anhu: Çfarë ke mbajtur mend nga Muhamedi sal-lallahu alejhi ue selem. Ai tha: kam mbajtur në mend nga i Dërguari i Allahut kur ka thënë: Largoju prej gjithçkaje që është e dyshimtë, e përmbaju asaj që nuk është e dyshimtë. Vërtetësia shpie në siguri, kurse gënjeshtër në dyshim.”*

Enes ibën Maliku ka pasur një vajzë. Ajo e kishte mësuar librin e tij el Muveta përmendësh. Kur e shpjegonte imam Maliku *Muvetanë* para nxënësve të tij ajo rrinte afër derës, dhe kur ndokush nga nxënësit e tij gabonte ajo i binte derës, kurse imam Malikut i kujtohej dhe menjëherë e

**“Për t'i dhënë kurajë fëmijës që të mësojë ai duhet të shpërblehet, qoftë duke e lavdëruar gojarisht, apo duke i dhënë atij ndonjë dhuratë...”**

përmirësonte!

Pasi prindi ta ketë stolitur fëmijën e vet me mësime të hadithit ai duhet t'ia mësojë atij lutjet e përditshme, të cilat na i ka mësuar i Dërguari i Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem*, siç janë: Lutja e ushqimit, çfarë thuhet kur hyjmë dhe kur dalim nga nevojtorja, çfarë thuhet kur hipim në mjetet e udhëtimit, çfarë pas namazit, lutjet e mëngjesit dhe të mbrëmjes. Abdulla ibën Abasi *radijallahu anhu* thotë: Një herë isha tek teza ime Mejmuneja. Aty erdhi Muezini pastaj doli për namaz duke thënë: *“O Zot bëje dritë zemrën time, gjuhën time, para meje, prapa meje, mbi mua dhe nën mua. O Zot më jep mua dritë.”* (Ibni Huzejme)

Por nuk është e ndaluar që t'u mësohen fëmijëve poezi dhe vjersha, me qëllim që ta pasurojnë fjalorin e tyre dhe të bëhen më entuziastë në dashurinë ndaj fesë dhe të dërguarit të tyre, dhe duke i larguar ata nga poezitë dhe vjershat, që ndikojnë në shkatërrimin e moralit të tyre.

Këtu mund t'ia bashkëngjitem edhe mësimin e disa shprehjeve, teksteve apo këshillave nga gjeneratat e para, të cilët merren si shëmbëlltyrë për ta, si për shembull këshilla e Abdullah ibën Mesudit *radijallahu anhu*, i cili na thotë: *“Kush ka të mira, Allahu i ka dhënë atij. E kush është i mbrojtur nga të këqijat Allahu e ka mbrojtur atë.”*, kurse në një rast tjetër thotë: *“Gjëja më e nevojshme për njeriun në sipërfaqen e tokës është që ai ta frenojë gjuhën.”*

### Kur duhet të mësojë fëmija?

Koha më e mirë për të mësuar fëmija është që nga mosha pesë deri në moshën pesëmbëdhjetë vjeçare, siç e vlerësojnë pedagogët: periudha e artë. Pas namazit të sabahut, kur truri i tij është i kthjellët dhe barku i tij është i zbrazët. Këto janë dy faktorë që ndihmojnë në procesin e kuptimit të shpejtë.

Për t'i dhënë kurajë fëmijës që të mësojë ai duhet të shpërblehet, qoftë duke e lavdëruar gojarisht, apo duke i dhënë atij ndonjë dhuratë, e cila do ta nxitë atë për të vazhduar mësimin. Na përcillet se Salahudin Ejubi njëherë ishte duke kaluar mes ushtarëve, kur dëgjoji zërin e një fëmije, i cili lexonte shumë bukur Kuran dhe iu afrua atij. Ai ishte me prindin e vet. Për shkak të leximit të tij të bukur e shpërbleu atë me ca gjëra ushqimore. Ndërsa prindit të tij si shpërblim që e kishte përgatitur djalin e tij i dhuroi një pjesë të tokës së vet.

Ndërsa Ibrahim Ed'hemit i thoshte babai i vet: O biri im mëso hadith, sa herë që të mësosh një hadith do të kesh një dërrhem dhe kjo u bë shkak që unë të mësoj hadithin, na tregon ai.

**Si përfundim:** Prindi duhet ta mbrojë fëmijën e vet nga gjërat, që e pengojnë për të mësuar. Ndër më të rëndësishmet është që ai të mbrohet nga mëkatet. Ibën Kajimi Allahu e mëshiroftë në librin e tij "El Xhevabul kafi" thotë: "Mëkatet e dëmtojnë meditimin e njeriut. Truri i njeriut ka dritë, mëkatet e shuajnë atë dritë. E kur të shuhet ajo dritë atëherë dobësohet të menduarit."

Gjithashtu duhet që fëmija mos të ngopet shumë, sepse të ngopurit e shpie drejt përtacisë. Por shumë e rëndësishme është që prindi mos ta ndërpresë duanë për fëmijët e vet... ■

Përktheu: Enver AZIZI

# ADHUROJE ALLAHUN DERI NË VDEKJE

Allahu thotë: "Dhe adhuro Zotin tënd deri sa të arrij e pashmangshmja e sigurt (vdekja)." (Hixhr, 99).

PËRGATITI: BASHKIM BAJRAMI

Nëpër Medinë u përhapë lajmi i rëndë, i cili errësoi dritën dhe hapësirat qiellore të mbarë Arabisë, për vdekjen e më të dashurit, Muhamedit *sal-lallahu alejhi ue selem*. Sahabët i goditi një pikëllim i madh, por në këtë çast u paraqit i dituri, i urti, besniku Ebu Bekri dhe iu drejtua me këto fjalë të arta besimtarëve: "Ai që e ka adhurar Muhamedin le ta dijë se ka vdekur, e kush e adhuron Allahun dhe e beson atë, le ta dijë se Allahu është i gjallë. Ai kurrë nuk vdes."

Ai që e ka adhurar Ramazanin le ta dijë se Ramazani ka shkuar e ai që e ka adhurar Zotin e Ramazanit le ta dijë se është i gjallë dhe nuk vdes.

Allahu Fuqiptotë e ka urdhëruar të Dërguarin e Tij, si dhe të gjithë muslimanët, që mos ta ndërpresin adhurimin deri në vdekje pa marrë parasysh angazhimet, situatat, sprovat që i godasin, por të jenë të paluhatshëm ndaj adhurimeve.



Kurejshët filluan ta godasin të Dërguarin e Allahut me shpifje të ndryshme duke e quajtur magjistar, rrenacak, i çmendur, përçarës, duke u tallur me fenë e Allahut, filloi t'i ngushtohet gjoksi Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem*, por atij i zbritën porosi hyjnore, duke e këshilluar me falënderim, lavdërim, sexhde dhe adhurim të vazhdueshëm.

Allahu thotë: “***Dhe adhuro Zotin tënd deri sa të arrij e pashmangshmja e sigurt*** (vdekja).” (Hixhr, 99).

İbën Kethiri thotë se fjala në ajet *el-jekin* (e pashmangshmja e sigurt) është vdekja, të këtij mendimi janë Muxhahidi, Salim ibën Abdullah ibën Omeri, Hasan Basriu, Katadja e shumë të tjerë. E jo siç pretendojnë sufitë, se fjala *el-jekin* do të thotë njohja e Allahut, dhe me këtë nënkuptojnë që kur robi arrin ta njohë Allahun plotësisht, atëherë bien detyrimet dhe adhurimi ndaj Tij. Kjo pa dyshim është kufër i madh, që të nxjerr nga feja, siç është mendimi i të gjithë dijetarëve si Sheukani, İbën Kethiri etj.

Allahu thotë: “***Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër përveçse të më adhurojnë Mua***.” (Dharijatë, 56).

Aliu *radijallahu anhu* thotë, se nuk i ka

krijuar Allahu xhinët dhe njerëzit, pos që t'i **urdhërojë** me adhurim. Ndërsa imam Shafiu thotë se i ka krijuar për një çështje madhështore shumë të rëndësishme, që për këtë i dërgoi edhe të gjithë pejgamberët vetëm që ta adhurojnë Allahun.

**Çka është adhurimi?** - Namazi, zekati, agjërimi dhe haxhi, apo është një përkufizim më i gjerë dhe gjithëpërfshirës? Shejhul Islam İbën Tejmije, jep këtë përkufizim: “*Adhurimi është emër përmbledhës për çdo gjë që do Allahu prej fjalëve apo veprave të jashtme dhe të brendshme*”. Prej fjalëve: siç është shqiptimi i shehadetit, dhikri, fjala e mirë etj., prej veprave: namazi, haxhillëku, respektimi i prindërve, lëmosha etj., të brendshme: frika, mbështetja, shpresa tek Allahu etj.

Për këtë qëllim të madh i krijoi qiejt e tokën, xhenetin e xhehenemin, i çoi të dërguarit, i zbriti librat.

Nga kjo kuptohet se kur njeriu e beson Allahun, dhe e di si ta besojë e ta adhurojë, e ka kuptuar qëllimin e ekzistencës së tij, dhe e tërë jeta e tij është adhurim dhe njësim i Allahut. Kjo ka qenë edhe moto e të gjithë pejgamberëve të Allahut “***adhuroni Allahun e mos i bëni shok (shirk) Atij në asgjë***.” Nisa 36. Shirku është prej mëkateve të mëdha, që Allahu nuk e fal siç thotë në Kuranin Famëlartë: “***Vërtetë Allahu nuk fal atë që i bën shok Atij, dhe fal përveç kësaj (çdo gjë tjetër) këdo që ai dëshiron***.” (Nisa, 48).

Allahu na tërheq vërejtjen nga shirku, që është një prej rreziqeve të mëdha që e humb njeriun dhe e shpie në zjarrin e xhehenemit. Prej llojeve të shirkut të njohur janë kërkimi i ndihmës nga të vdekurit (në turbe, varreza), magjia, besimi në fallxhorët, hajmalitë, adhurimi i këngëtarëve, sportistëve, artistëve etj. Muslimani duhet t'i mohojë të gjitha adhurimet përveç adhurimit ndaj Allahut, edhe kjo është kuptimi i fjalës “la ilahe il-lallah”, që duhet të praktikohet në jetën e përditshme.

Para se të bësh qoftë edhe një hap të vetëm

e ke për detyrim ta njohësh rrugën në të cilën ke suksesin dhe shpëtimin. Mos e lodh veten me vepra të shumta, sepse zotëruesit e veprave të shumta nuk i bëjnë dobi asgjë, përveçse lodhet në këtë botë nga kjo gjë dhe dënohet në ahiret e për këtë duhet ta dish para çdo gjëje, se cilat janë kushtet, të cilat duhet të plotësohen, që vepra të pranohet. Është e domosdoshme që të plotësohen dy kushte për çdo vepër, se përndryshe nuk pranohet:

**E para:** pronari i veprës të ketë si qëllim vetëm kënaqësinë e Allahut (sinqeriteti).

**E dyta:** Ajo të jetë në përputhje me Sunetin e Pejgamberit.

Shumë vepra tek ne i bëjnë me bindjen, se është adhurim e ato nuk janë të pranuar tek Allahu, për arsye se nuk e plotësojnë njërin prej kushteve, si p.sh. dhikri i kelimetuihidit (apo siç njihet: qelimet) mund të bëhet me sinqeritet, por nuk është në përputhje me Sunetin e Pejgamberit dhe për këtë arsye refuzohet, siç transmetohet nga Aishja se Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: *“Kush bën një vepër që nuk është prej veprave tona ajo është e refuzuar.”* (Buhariu, Muslimi).

Tërë jeta jote duhet të jetë në adhurim me atë që Allahu është i kënaqur, se për këtë arsye je krijuar, por edhe vdekja jote duhet të jetë për Allahun, siç thotë Allahu në librin e Tij fisnik: *“Thuaj (O Muhamed): Vërtet, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka asnjë shok dhe për këtë unë jam urdhëruar dhe unë jam i pari i muslimanëve.”* (Enam 162-163).

Ibën Kethiri thotë: Allahu e ka urdhëruar të Dërguarin e Tij, që t'i tregojë idhujtarëve (mushrikëve), që adhurojnë dikë tjetër pos Allahut, dhe therin jo në emër të Tij, se kjo është në kundërshtim me mësimet e Allahut; se namazi duhet të jetë për Allahun, therja duhet të bëhet në emër të Allahut, i cili nuk ka shok.

Por edhe e tërë jeta e muslimanit duhet të jetë në adhurim për Allahun, prandaj mësimi

yt, puna jote, ushqimi yt, vizitat etj., nëse i bën me nijet të pastër ato do të llogariten adhurim.

Ilaçi kryesor për qetësimin e shpirtit, zemrës dhe mendjes, nuk është as pasuria e as pozita, e cila është dëshmuar edhe në praktikë, ku njerëzit kanë shpenzuar të holla të shumta në medikamente e konsulta të shumta me psikiatër e psikologë, lodhje duke vrapuar pas ilaçit që e qetëson shpirtin; por kot, derisa i kapën më në fund këshillat hyjnore dhe porositë pejgamberike, dhe aty më në fund e gjetën ilaçin me adhurim, duke e përmendur Allahun, siç thotë Allahu: *“Me përmendjen e Allahut qetësohen zemrat...”*

Dije o musliman, se Allahu nuk ka nevojë për adhurimin tënd, se Ai është Krijuesi i gjithësisë, Furnizuesi, i Plotfuqishmi, që nuk është i nevojshëm për krijesat e Tij, por ne jemi të nevojshëm për adhurimin, se na afron tek Allahu, na qetësohen zemrat, jemi nën mbrojtjen e Allahut, na hapen dyert e riskut, zbret ndihma e Allahut, forcohen muslimanët, ku shkak i dobësimi të muslimanëve, që sot u janë vërsulur armiqtë si kafsha e uritur ndaj pjtatës është lënia pas dore e farzeve të Allahut.

Mos përto, o musliman, t'i falësh pesë kohët e namazit, mos u bë koprrac dhe nuk e jep zeqatin, apo mos të shkosh tani në haxhillëk e ta përjetosh afërsinë tënde me Allahun në Arafat e të kthehesh i pastër nga mëkatet. Kjo është kënaqësi, e cila nuk harrohet, që nesër kur të dalësh para Krijuesit tënd ta kesh të mbushur llogarinë tënde me vepra të mira e të na mbulojë Mëshira e Allahut, se vetëm veprat tona nuk mjaftojnë për të hyrë në xhenet. Siç ka ardhur në hadith për atë personin që i ka bërë adhurim Allahut 500 vite dhe ka kërkuar të hyjë në xhenet me veprat e tij, por kur e pa' se nuk ka mundësi të mbulojë me to vetëm dhuntinë e syrit, që na ka dhuruar i Mëshirshmi, atëherë kërkoi të hyjë me mëshirën e Allahut.

Po ti, o musliman, pyete vetën sa ditë, muaj apo vite i ke bërë adhurim Allahut?! ■



# ASTROLOGJIA SHKENCË APO MAGJI?

Na përcillet nga Ibën Abasi, Allahu qoftë i kënaqur me të, se ka thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, paqja dhe lëvdatat e Zotit qofshin mbi të, se ka thënë: “Kush mëson diçka nga astrologjia<sup>1</sup>, duke pretenduar se përmes asaj dije mund t’i njohë të fshehtat e së ardhmes ai ka mësuar pjesë nga magjia, sa më shumë që e shton këtë dituri, aq më shumë zhytet në mëkat (magji)” .

## SHKRUAN: LULZIM SUSURI

### Zinxhiri i hadithit:

Hadithin e lartpërmendur e përcjell Ibën Abasi, *radijallahu anhu*, dhe e shënon imam Ahmedi në Musnedin e tij, 1/277, 311, Ebu Davudi në “Sunen”, nr. 3905. Këtë hadith e saktëson Abdurrahman ibën Hasen ibën Muhamed ibën Abdulvehab në librin e tij: “Fet’hul mexhid”, fq. 292, ndërsa shejh Albani këtë hadith e konstaton si hadith hasen (të mirë), pra shkallë kjo pak më e ulët se ajo, por mjaft e mjaftueshme për t’u bazuar dhe për të punuar me të. Nuk dua të lë pa përmendur faktin se shejh Albani hadithin e lartpërmendur e ka gjykuar vetëm nga ana e zinxhirit të tij, kurse shejh

Abdurrahmani e saktëson bazuar në metnin (tekstin) e hadithit. Tekst ky i cili për nga kuptimi i tij është mjaft i njohur dhe i mbështetur në argumente të sakta fetare, qofshin ato nga Kurani apo Suneti.

### Komentimi i hadithit:

Ky hadith flet për rrezikun e të mësuarit të ndonjë diturie përmes së cilës njerëzit pretendojnë se mund ta njohin të ardhmen apo gjërat e fshehta. Ata i mësojnë këto gjëra me pretendimin se janë duke mësuar pjesë nga shkenca e astronomisë dhe kështu mundohen të arsyetohen para të tjerëve, kurse në fakt mësimet e tyre, siç thotë edhe vetë Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, nuk janë asgjë tjetër veçse

<sup>1</sup> Astrologji - Dituri e rreme, që përpiqet të parashikojë ngjarjet dhe fatin e njerëzve, duke vëzhguar vendosjen e trupave qiellorë. E kundërta e saj është astronomia, e cila bazohet mbi fenomenet fizike dhe vëzhgimet e bazuara në shkencë. Fillimisht astrologjia përfshinte në vetvete edhe studimin e yjeve për efekte shkencore, por më pas u nda në astrologji dhe astronomi, edhe për faktin e luftës së ashpër që iu bë nga të gjithë dijetarët muslimanë pa dallim, si dhe prej mashtrimeve të vazhdueshme të astrologëve që i demaskuan në popull (shën. red.).

magjia vetë. Me këtë hadith nuk kemi si qëllim të flasim për shkencën e astronomisë në përgjithësi, por me të kemi si qëllim shtjellimin e çështjes, se përmes njohjes së pozitave të yjeve apo planetëve, njeriu: a mund ta mësojë të ardhmen e tij dhe a i lejohet ta mësojë këtë pjesë të kësaj shkence, e cila pretendon njohjen e së ardhmes. Shejhul Islam Ibën Tejmije thotë: “Me fjalën “astrologji” këtu kemi si qëllim argumentimin dhe pretendimin, se përmes gjendjes së yjeve në qiell njeriu mund të dijë të ardhmen e tij në tokë” (Marrë nga Fet-hul mexhid, fq. 290).

Fjala e Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*:

### “Kush mëson diçka nga astrologjia”

Dija e yjeve ndahet në dy pjesë, ajo e lejuara dhe tjetra e ndaluar. Pjesa e lejuar (astronomia) është të mësuarit përmes saj pozitën e yjeve apo planetëve në qiell, e përmes saj të mësohen rrugët dhe drejtimet për të udhëtuar si ditën ashtu edhe natën, si në tokë ashtu edhe në det. Të mësohen drejtimet e tokës, lindja, perëndimi, veriu dhe jugu e kështu të mësohet drejtimi i kibles. Njohjen e lëvizjes së diellit dhe hënës që përmes saj të mësohen kohët e adhurimit, si p.sh. koha e namazeve, ajo e agjërimit, dita e bajramit etj.

Ndërsa pjesë e ndaluar në këtë shkencë konsiderohet mësimi i çështjeve, nga të cilat pretendohet se përmes tyre mësohet e ardhmja e njeriut, kur do të lindë ai, sa do të jetojë, kur do të vdesë... apo pretendimeve se përmes saj mund ta marrin vesh njerëzit se kur do të ndodhin luftërat, ku do të ulen apo ngrihen çmimet e tregut... etj.

Bazuar në shpjegimet e lartpërmendura arrijmë në përfundimin, se teksti i hadithit të mësipërm ka si qëllim kritikën dhe ndalimin e asaj pjese të dijës së yjeve, e cila edhe pse pretendohet se është pjesë e

**“...pa marrë parasysh dituritë sa mund të përparojnë, shkencat të lulëzojnë dhe teknologjia të përparojë, prapë se prapë e ardhmja për njeriun mbetet e panjohur dhe pjesë e së fshehtës...”**

shkencës në fakt është magji e qartë, apo e thënë më saktë futet në llojet e magjisë sipas kuptimit të gjerë të kësaj fjale të fundit.

**Fjala: “duke pretenduar se përmes asaj dije mund t’i njohë të fshehtat e së ardhmes”**

Njeriu vetëm mund të pretendojë se i njeh të fshehtat e së ardhmes. Ai sado të mësojë dhe sado të arrijë të jetë i suksesshëm dhe i ditur në këto lëmi, apo edhe lëmi të tjera çfarëdo qofshin ato, përmes të cilave mund të pretendojë një gjë të tillë, ai vetëm se e ka mashtruar veten e tij dhe i ka mashtruar ata që i besojnë atij. Pra, pa marrë parasysh dituritë sa mund të përparojnë, shkencat të lulëzojnë dhe teknologjia të përparojë, prapë se prapë e ardhmja për njeriun mbetet e panjohur dhe pjesë e së fshehtës, të cilën nuk mund ta zbulojë me asgjë. Njerëzit që merren me mësimin e këtyre çështjeve përmes të cilave pretendojnë se mund ta dinë të ardhmen para se ajo të ndodhë ndahen në dy grupe:

a) Ata që besojnë se me të vërtetë përmes asaj diturie e njohin të ardhmen, pra, e mësojnë, praktikojnë dhe ua tregojnë të tjerëve, duke besuar se ajo që thonë është e vërtetë.

b) Ata që në fakt nuk e besojnë një gjë të tillë në vetvete, por megjithatë u japin lajme

të tjerëve dhe parashikojnë për ta. Ajo që i nxit për të vepruar gjëra të tilla në shumicën e rasteve këtë lloj njerëzish janë interesat ekonomike, ngase tek të tjerët gjejnë terren të lirë për shkak të besimit të dobët që kanë këta të fundit.

### **Fjala: “ai ka mësuar pjesë nga magjia”**

Të mësosh astrologjinë me pretendimin se përmes saj mund të arrihet deri tek njohja e së ardhmes, atëherë kjo lloj diturie futet në rrethin e dijeve të ndaluara mësimi i të cilave është haram, bile shpeshherë kufër. Magjia është disa llojesh, por ne nuk do të ndalemi të flasim për të. Neve në këtë rast na intereson të dimë se prej kujt lloji të magjisë është edhe pretendimi i atyre që thonë se e dimë të ardhmen, ku më e zakonshmja është se parashikuesit e së ardhmes përmes shenjave dhe riteve të tyre mundohen ta njohin të ardhmen. Parashikuesit e së ardhmes ndahen në dy grupe kryesore:

-Ata që vërtetë kanë kontakte me xhinët dhe inspirohen prej tyre për të parashikuar gjëra, të cilat xhinët mundohen t'i dëgjojnë në qiell, duke hipur njëri mbi tjetrin. Këta të fundit ndodh që të dëgjojnë ndonjë lajm nga Allahu dhënë melaqeve e pastaj ta sjellin atë lajm deri tek veshi i magjistarit. Por ndodh që në shumicën e rasteve Allahu i gjuan me yje këta shejtanë e kështu i djeg para se ata ta sjellin lajmin e qiellit deri në tokë. Nuk duhet harruar, se edhe atëherë kur xhinët arrijnë të sjellin ndonjë lajm nga qielli deri tek veshi i magjistarit, këtij lajmi i shtojnë edhe nëntëdhjetë e nëntë gënjeshtër. Njerëzit kur e dëgjojnë këtë lajm dhe arrin ai lajm të realizohet duke u bazuar në një lajm të saktë i harrojnë nëntëdhjetë e nëntë të tjerat që nuk janë realizuar dhe fillojnë të krijojnë bindjen, se parashikuesi realisht thotë të vërtetën. Pra, e krijojnë bindjen vetëm nga një përqindëshi i saktësisë së lajmit të tij e nuk e krijojnë bindjen nga

nëntëdhjetë e nëntë përqindëshi i gënjeshtërave të tij.

Lloji i dytë i parashikuesve janë: Ata që në fakt nuk kanë kurrfarë lidhje me botën e xhinëve, por bindjet e tyre i ngrenë mbi mësime të kota, si shenjat e duarve, mbeturinat në filxhanin e kafesë, zogjtë që fluturojnë apo ulen në vende të caktuar, lëvizja dhe pozitat e caktuara të yjeve, ku kjo e fundit bën pjesë në shkencën e astronomisë etj.

Dua të përmend edhe një dallim mes parashikuesit që bashkëpunon me xhinët dhe atij që parashikon vetëm përmes yjeve, se i pari mund t'ia qëllojë ndonjëherë për ndonjë çështje. Kurse ky i fundit nuk mund t'ia qëllojë asnjëherë, përveç nëse ka folur kot dhe rastësisht mund të ndodhë që të vërtetohet parashikimi i tij, gjë e cila ashtu ka qenë e shkruar nga Allahu të ndodhë, ku në këtë rast mund të jetë fitne apo sprovë, si për parashikuesin ashtu edhe për atë që e dëgjon apo i beson atij.

### **Dispozitat e shariatit mbi të mësuarit e këtyre dy llojeve të parashikimit:**

Të mësuarit e llojit të parë pa kurrfarë dyshimi është kufër. Disa nga dijetarët kanë thënë se edhe të mësuarit e magjisë për ta kundërshtuar atë konsiderohet kufër, prandaj sipas tyre nuk duhet të guxojmë t'i afrohem në asnjë mënyrë magjisë.

Sa i përket llojit të dytë të parashikimit të fatit dijetarët kanë disa mendime për këtë çështje; disa e ndalojnë dhe e konsiderojnë atë pjesë të kufrit. Ca të tjerë fillimisht ndalen nga një gjykim i tillë, nëse njeriu i mëson këto gjëra për t'i kundërshtuar apo për kuriozitet duke mos i besuar dhe duke mos punuar me to. Por që të dy palët në fund janë të pajtimit, se ai që i mëson këto lloj kotësisish duke i besuar, apo duke punuar sipas mësimeve të tyre, apo edhe vetëm duke i mashtruar të tjerët vetëm që të përfitojë prej tyre, edhe pse mund të mos i

besojë ai vetë, ky lloj njeriu del nga Islami dhe konsiderohet qafir. Lind pyetja: pse të konsiderohet qafir, kur ai vetë nuk i beson ato gjëra? Themi se nuk na intereson besimi i tij i fshehtë; neve na intereson se ai me punën e tij është duke i nxjerrë të tjerët nga Islami dhe po bëhet shkaktar për fesad në tokë. Po ashtu mund të lindi dyshimi pse Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, të mësuarit e astrologjisë për qëllimin e njohjes të së ardhmes e futi në llojin e magjisë, duke mos lënë rrugë për dyshim në këtë çështje, kur ne e dimë se kjo lloj dije fillimisht nuk ka të bëjë me kufrin, sepse të mësuarit e pozitivët së planetëve nuk është kurrfarë kufri?

Këtu themi se mësimi i kësaj dije me qëllimin e njohjes të së ardhmes vetvetiu futet në llojin e magjive, edhe pse kjo futje në magji fillimisht është sipas kuptimit të gjerë të fjalës magji, kuptim ky i cili do të thotë se: çdo dije, fjalë, vepër apo gjest përmes të cilit krijohet bindja se njeriu mund të njohë të ardhmen konsiderohet magji, sado që i shtohen bindje më të mëdha, apo qëllime dhe dëme më të rrezikshme përmes të cilave largohet nga Islami, atëherë edhe më tepër futet në magji apo thënë ndryshe në kufër.

### **A lejohet t'i pyesim parashikuesit e fatit apo t'i lexojmë shkrimet e tyre.**

Nuk lejohet pyetja e tyre, as leximi i parashikimeve të tyre. Kjo dispozitë vlen për të gjithë muslimanët pa marrë parasysh a e pyet duke i besuar apo duke mos i besuar. Edhe pse ta pyesësh parashikuesin për fatin e tij, duke mos i besuar aspak, nuk mund ta fusim fillimisht në gradën e qafirëve, por ky person konsiderohet mëkatar me mëkat të madh, i cili më pas mund të kalojë edhe në kufër. Rreth kësaj çështje ndër të tjera transmetohen edhe këto dy hadithe të Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*:

Na përcillet nga disa prej grave të

## **“Mjerë ky njeri i “shkolluar”, i cili nuk i beson besëtytnitë e prapambetura, por i shkreti nga ana tjetër i beson besëtytnive “bashkëkohore”... ”**

Pejgamberit (Hafsës), se ai ka thënë: “*Kush shkon tek ndonjë parashikues (fati) dhe e pyet atë për diçka nuk i pranohet namazi dyzet ditë*”. (Muslimi, nr. 2230) dijetarët e përmendin këtë hadith për njeriun që e pyet parashikuesin duke mos i besuar.

Na përcillet nga Ebu Hurejre, *radijallahu anhu*, se i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “*Kush shkon tek parashikuesi dhe i beson asaj që ai thotë, ai e ka mohuar atë që i është zbritur Muhamedit (Kuranin)*”. (Ebu Davudi, nr. 2230, Tirmidhiu, nr. 135, Nesaiu në librin e tij “Sunen el-Kubra”, 10/124. Hadithi është sahih).

\*\*\*

-Askush nuk ka të drejtë t'i keqpërdorë yjet për interesa të tij, apo përmes tyre t'i sprovovë njerëzit dhe kështu t'i nxjerrë nga Islami. Allahu i Lartësuar u ka dhënë yjeve detyra të caktuara dhe i ka krijuar me urtësi, gjëra të cilat janë përmendur në Kuran dhe assesi nuk duhet të krijohen bindje të caktuara, se yjet vlejné për diçka tjetër pos tri gjërave.

Imam Buhariu, Allahu e mëshiroftë, shënon se Katade ka thënë: “Allahu i krijoi yjet për tri gjëra: Zbukurim për qiellin, për të gjuajtur shejtanët dhe shenja për t'u udhëzuar udhëtarët. Kush pretendon se yjet kanë ndonjë funksion tjetër ai ka gabuar ka dalë (nga Islami) dhe ka marrë përsipër të flasë rreth gjërave për të cilat nuk ka aspak dije”. (Fet-h el-Bari, 2/295) Argument për fjalën e Katades janë fjalët e Allahut: “**Jua**

*kemi zbukuruar qiellin më të afërm me yje të shkëlqyeshme dhe i kemi bërë ato si predha për të larguar djajtë.”* (Mulk, 5).

*“Ai ka vënë edhe shenja të tjera, si dhe yjet, nëpërmjet të cilëve njerëzit orientohen.”* (Nahël, 16).

Nuk duhet ta keqkuptojmë fjalën “orientim”, e cila vjen nga fjala arabe “hidaje”, që do të thotë “udhëzim” e kështu të mendojë dikush se me këtë udhëzim është si qëllim udhëzimi tek e mira për gjërat e ardhshme. Por sipas të gjithë ajeteve kuranore, haditheve profetike dhe komenteve të dijetarëve apo gjuhëtarëve me fjalën “udhëzim” është si qëllim udhëzimi në rrugët e kësaj bote. Pra, udhëzimi nëpër male, dete, shkretëtira etj.

#### **Fjala: “sa më shumë që e shton këtë dituri aq më shumë zhytet në mëkat (magji)”**

Fillimisht e kuptuam se të merresh me diçka të tillë është e ndaluar, është mëkat i madh, i cili kalon në kufër. Ndërsa kjo fjalë na mëson se njeriu sa më shumë që thellohet në këso diturish, në këso punësh, aq më shumë zhytet ai në kufirin e magjisë.

**Vërejtje:** Këtu nuk dua të lë pa përmendur një sprovë të kohëve tona me të cilën mediet, si të shkruara ashtu edhe të dëgjua dhe të shikuara i kanë sprovuar njerëzit në përgjithësi, e kjo është horoskopit. Këtë sprovë mund ta gjesh në çdo cep të secilës gazetë apo reviste, në radio apo televizion dhe kudo tjetër. Në kohën tonë zakonisht ata që e mësojnë astronominë për këso qëllimesh mendimet e tyre për parashikimin e së ardhmes i vendosin në këso shkrimesh, pra, në horoskop.

Njerëzit përmes tij përfitojnë vetëm humbje kohe, dehje të trurit, mashtrim të qartë, marrje të vendimeve të ngutshme dhe të gabuara bazuar në horoskop e jo në arsye dhe argumente të fesë; dhe në fund përfitimi më i madh i tyre është dalja nga feja. Në këtë mënyrë hartuesit e këtyre lloj rubrikave arrijnë të luajnë me njerëzit duke i urdhëruar të

punojnë apo të largohen nga vepra të ndryshme, arrijnë që njerëzit t'i bindin për t'i besuar më shumë horoskopit, se sa fjalës së Allahut apo asaj të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Shpesh e kam pyetur veten, se çfarë përfitojnë këta njerëz nga këto publikime, ku në shumicën e rasteve përfitimet materiale janë jo edhe aq të mëdha, por pa kurrfarë dyshimi, se qëllimi i shumicës së hartuesve të këtyre rubrikave nuk është përfitimi material, sa është nxjerrja e njerëzve nga Islami dhe t'i mbajnë sa më larg tij.

Shpesh në këtë sprovë bien edhe njerëzit e shkolluar, të cilët nëpër seminare apo tubime të ndryshme i kundërshtojnë besëtytnitë dhe e refuzojnë çdo lloj falli duke bërëtitur me gojën plotë se gjërave të tilla i besojnë vetëm injorantët dhe ata të prapambeturit e në anën tjetër ai vetë i beson horoskopit. Mjerë ky njeri i “shkolluar”, i cili nuk i beson besëtytnitë e prapambetura, por i shkreti nga ana tjetër i beson besëtytnive “bashkëkohore”.

Këta lloj njerëzish shpesh i kundërshtojnë edhe disa parime bazë të fesë, të cilat flasin për shumë lajme të së ardhmes, siç janë xheneti dhe xhehenemi, duke pretenduar se janë diçka e panjohur për neve dhe kështu i kundërshton argumentet e sakta nga Kurani dhe Suneti e në anën tjetër i pranon fjalët e kota të mashtruesve bashkëkohorë. Prandaj në fund e këshilloj veten time dhe çdo njeri që të largohet nga këto mashtrime, të cilat e dërgojnë njeriun në kufër, të besojë fjalët e mashtruesve, të cilët pretendojnë se dinë diçka që nuk e ka ditur as më i dashuri i Allahut, Muhamedi *sal-lallahu alejhi ue selem*, pra, njohjen e fshehtësive të së ardhmes. Për të ardhmen neve duhet të besojmë, aq sa na është treguar prej saj në Kuran apo hadithet e Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, as më pak e as më shumë. Kush beson diçka më shumë apo mohon vetëm pak nga ato lajme del nga feja! ■

# REPUBLIKA E IRAKUT

SHKRUAN: DRITON LEKAJ



## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME: <sup>1</sup>

**Emri i plotë:** Republika e Irakut  
**Kryeqyteti:** Bagdadi.  
**Sipërfaqja:** 438. 317 km<sup>2</sup>.  
**Banorët deri më 2009:** 31.204.000  
**Përqindja vjetore e rritjes së banorëve (2000 - 2005):** 2.7 %  
**Përqindja e muslimanëve:** 97 %.  
**Gjuha:** Árabe dhe Kurde.  
**Monedha:** Dinari Irakian.(IQD)  
**Pavarësinë:** 3 Tetor 1932 (nga Britanikët)  
**Anëtar i Kombeve të Bashkuara:** 7 Tetor 1971  
**Anëtar i Konferencës Islamike:** 1975

## Ana Gjeografike

Republika e Irakut është shtet arab, i cili gjendet në anën perëndimore të kontinentit të Azisë. Kufizohet nga Turqia në veri dhe Irani në lindje. Ndërsa në jug kufizohet me Gjirin Arab, Kuvajtin dhe Arabinë Saudite, si dhe në jug-perëndim kufizohet me

Jordaninë. Ndërsa me Sirinë përkufizohet në veri-perëndim.

3.576 km. është gjatësia e kufirit irakian. Kufiri më i gjatë është me Iranin 1.458 km pastaj me Arabinë Saudite 808 km. dhe me Sirinë 605 km. e pjesa e mbetur është me shtetet e lartpërmendura.

Republika e Irakut ndahet në katër forma

<sup>1</sup> Të dhënat kryesisht janë marrë nga: <http://en.wikipedia.org/wiki/Iraq>

relievi: Luginat, sistemi lumor, kodrat dhe shkretëtira. Prej tyre më i veçanti është sistemi lumor, i cili e përshkon Irakun tej-përtej dhe përbëhet prej dy lumenjve të njohur:

**Lumi Tigër:** Buron në Turqi dhe pastaj hyn brenda Irakut, në të derdhen lumenj të ndryshëm të vegjël, duke e bërë atë në një pjesë të madhe të tij të lundrueshëm për anijet. Gjatësia e tij është 1850 km.

**Lumi Euftrat:** Buron nga Turqia dhe pastaj kalon nëpër Siri dhe hyn në tokat irakiane. Gjatësia e tij është 2350 km. Në dallim nga Tigri në Euftrat nuk derdhet asnjë nga lumenjtë e vegjël.

Euftrati së bashku me Tigrin bashkohen tek qyteza e njohur **El Karene** dhe së bashku ata përbëjnë atë që njihet me emrin Shat-tul Arab (Bregu Arab) gjatësia e të cilit arrin në 185 km. Shat-tul Arab më pas derdhet në gjirin Arab duke formuar ujdhesa të vogla dhe për këtë shkak në bregdetin irakian nuk mund të ketë limane të mëdha.

Iraku, Siria dhe Turqia kanë marrëveshje për përdorimin e ujërave të këtyre lumenjve të cilët përshkojnë tokat e tyre.<sup>2</sup> Iraku nga evropianët është njohur si Mesopotami e që në greqishten e lashtë ka kuptimin “Vend mes dy lumenjve”.<sup>3</sup>

### Ana Historike

Republika e Irakut si një vend i lashtë dhe me një pozitë gjeostrategjike ka qenë vend përqendrim i shumë kulturave gjatë historisë së tij, si dhe mozaiku i tij fetar, kulturor, nacional ka qenë nga më të ndryshmit. Mu për këtë do të sjellim kulturat dhe datat më të rëndësishme nëpër të cilat kaloi historia e Irakut e më pas duke u ndalur më tepër te historia bashkëkohore.

### Periodha para Islamit:

Iraku ka qenë shtëpi e shumë civilizimeve që datojnë 6.000 vjet para erës sonë. Këto civilizime së bashku prodhuan shkrimin, letërsinë, shkencat, matematikën, ligjet dhe filozofinë dhe për këtë me meritë Iraku është quajtur “djep i qytetërimit”.

Qytetërimi më i lashtë është ai Sumerian, i cili lindi në luginën pjellore mes lumit Tigër dhe Euftrat 6.000 vjet p.e.s. Atë e zëvendësoi perandoria Akadiane, e cila erdhi në shek. XXIV p.e.s. Më pas prej qytetërimeve më të njohura ka qenë ai i Babilonisë, i cili e rriti dominimin në Irakun qendror dhe jugor, ndërsa po formohej në pjesën veriore qytetërimi Asurian. Vijuan më pas pushtimet e Irakut nga persianët, grekët helenë përmes ekspeditave të Aleksandrit të Madh pastaj për një kohë ka qenë nën romakët dhe më pas persianët Sasanidë. Iraku qëndroi provincë e Persisë për nëntë shekuj gjersa u çlirua nga muslimanët.<sup>4</sup>

Periodha pas-islame gjer në fillim të shekullit 19-të:

**12 h.** – Halid b. Velidi u nis me ushtrinë e tij pasi triumfoi në betejat e Riddes (Betejat kundër Renegatëve) dhe arriti të çlirojë tokat e tij deri në provincën El Enbar.

**14 h.** Çlirimet i vazhdoi Sad ibën Ebi Vekasi, të cilat u kurorëzuan me triumfin e muslimanëve në betejën e Kadisijes, ku pas kësaj beteje kontrolli i Persisë përfundoi përgjithmonë.

**149 h. (766 m.)** Shënon Kohën e sundimit të Dinastisë së Abasidëve, ku edhe u themelua Bagdadi si kryeqytet i Perandorisë Islame. Në këtë kohë kultura arabe dhe islame përjetoi kohën e saj të artë.

**656 h. (1258 m.)** Kjo gjendje vazhdoi gjer

<sup>2</sup> Marrë nga Enciklopedia Historiko - Gjeografike e Botës Arabe.

<sup>3</sup> Marrë nga: <http://en.wikipedia.org/wiki/Iraq>

<sup>4</sup> Marrë nga: <http://en.wikipedia.org/wiki/Iraq> - në formë të shkurtuar

në këtë datë, e cila shënon pushtimin Tartar-Mongol të shtetit islam dhe kryeqytetit të tij Bagdadit. Mongolët ishin një popull luftarak të interesuar vetëm të pushtonin tokën, duke mos iu bërë përshtypje niveli i lartë i qytetërimit në Bagdad, prandaj dogjën biblioteka, dëmtuan shtëpitë, vranë njerëzit e pafajshëm, sa që historia nuk ka përshkruar ndonjë pushtim më të përgjakshëm, se sa ky. Këtë na e përshkruan më së miri Ibën Ethiri – historiani i mirënjohur musliman.<sup>5</sup> Me fillimin e shekullit të pesëmbëdhjetë Safevitë ndërhyjnë në Irak, por u larguan më vonë nga Perandoria Osmane, e cila e sundoi Irakun për pesë shekuj.

Periudha pas sundimit të Perandorisë Osmane:

**1914** - Britanikët e pushtuan Irakun dhe luftuan me Perandorinë Osmane, ku humbën jetën shumë njerëz, më pas këto dhe ngjarje të tjera ndikuan në shpërbërjen e Perandorisë Osmane.

**1921** - Iraku shpallet mbretëri nën udhëheqjen e mbretit Feisal. Në të vërtetë britanikët ishin ata që e ngritën këtë mbretëri hashimite. Megjithatë edhe pas pavarësisë nga britanikët më 1932 Iraku ishte i detyruar t'i lejonte bazat ushtarake britanike, si dhe të lejonte kalimin e këtyre forcave përmes territorit të tij.

**1958** – Këtë vit Iraku shpallet republikë dhe rrëzohet monarkia irakiane nga një grup oficerësh të ushtrisë irakiane të udhëhequr nga Abdus Selam El Kasimi. Por nuk zgjati shumë dhe në vitin 1968 pas një ndërrimi të shpeshtë të pushteteve Partia

**“...Në tërë këtë mesele u përfshi edhe Irani “Islamik”, i cili pa dyshim bashkëpunoi me Djallin & SHBA - të në tërë këtë masakër e rrëmujë, duke shfrytëzuar irakianët shiitë në nderzjen e fitilit të përçarjes medhheboe..”**

Socialiste Arabe BAAS mori pushtetin nën udhëheqjen e Ahmed El Bekrit. Pushteti i partisë socialiste BAAS vazhdoi gjer në pushtimin e Irakut nga forcat Amerikane dhe Britanike më 2003.<sup>6</sup>

#### **Ana politike:**

Që kur partia BAAS mori pushtetin mbi Irakun filloi një erë e re komuniste dhe u afrua më tepër me Bashkimin Sovjetik dhe bllokun e vendeve përreth tij. Metodot komuniste nuk munguan dhe krahas rritjes së fuqisë së partisë rriteshin edhe dhuna e terrori që ushtrohej për të shtypur çdo zë kundër objektivave të partisë. Kështu që me kalimin e kohës Sadam Huseini filloi të merrte nën kontroll drejtimin e partisë dhe pas dhjetë vitesh ai arriti të rrëzonte mikun e tij të afërt – El Bekrin nga pushteti, t'i eliminonte kundërshtarët e tij dhe të bëhej president i Irakut në vitin 1979. Koha e sundimit të tij dëshmon për një diktaturë të

<sup>5</sup> Disa fjalë të Ibën Ethirit për pushtimin e Tartarë-Mongolëve: “Nëse të thotë një njeri se prej kur është krijuar Ademi alejhis selam, njerëzit nuk janë sprovuar me diçka të tillë do të ishte i sinqertë. Historitë e ndryshme nuk përbajnë diçka të tillë që i afrohet... Pasha Allahun ata që do të vijnë pas nesh kur ta lexojnë këtë ngjarje të shkruar, do ta mohojnë dhe do ta llogarisin të pamundur, dhe kanë të drejtë. Muslimanët nuk kanë përjetuar vështirësi dhe nënçmim që prej kohës kur ka ardhur Pejgamberi (paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të) e deri më sot, sikurse e përjetuan tashti.” El Kamil ibni Ethir: 12/358 -359.

<sup>6</sup> Atlasi i Shteteve Islame i Dr. Shevki Ebu Halil.





hekurt dhe si e tillë u vranë me mijëra njerëz, u eliminuan me qindra individë elitë në Irak dhe u abuzua me të drejtat e njeriut.

### **Luftërat e Irakut:**

**1980** – Pas shpërthimit të revolucionit në Iran, irakianët që i përkisnin drejtimit shiit shfaqën afërsi me revolucionin dhe për këtë Saddam Huseini i udhëhequr nga nacionalizmi arab dhe tirania e tij filloi luftën me Iranin në vitin 1980. Kjo luftë zgjati tetë vite dhe viktimat nga të dyja anët supozohet të kenë arritur deri në 1.5 milionë frymë. Shtetet e Bashkuara trajtuan me standarde të dyfishta palët e konfliktit duke ndihmuar që lufta të vazhdonte me qëllim dobësimin e të dy vendeve, prandaj indirekt ka qenë pjesëmarrëse në këtë konflikt.

**1990** – Iraku nën udhëheqjen e Saddam Huseinit shfaqti ambicie për pushtimin e Kuvajtit dhe shfrytëzimin e burimeve të tij e që lidheshin kryesisht me pusët e tij të pasura me naftë. Më 1990 Iraku pushton Kuvajtin, duke shpallur gjithashtu edhe

fundin e ekzistencës së tij si shtet. Pas kësaj Këshilli i Sigurimit vendosi unanimisht për ndërhyrje ushtarake, që të zmbrajte ushtria irakiane. Edhe pse ushtria irakiane iu kundërpërgjigj sulmeve, megjithatë ishte e dobët në përballjen me forcat aleate dhe Iraku u detyrua që të nënshkruante marrëveshjen e armëpushimit më 28 Shkurt 1991. Pas kësaj filloi embargo dhe kërkesat e Këshillit të Sigurimit përmes rezolutave të ndryshme nuk ndaleshin për të cinguar dominimin dhe tiraninë e partisë BAAS. Embargo e vendosur nga Kombet e Bashkuara ka lënë gjurmë të pashlyeshme në popullin e Irakut, i cili u dëmtua më shumë prej saj. Shifrat e përafërta të asaj kohe flasin për një milion fëmijë që vdiqën si pasojë e urisë, ushqimit të dobët dhe mungesës së ilaçeve. Populli irakian mbeti peng i pasojave të luftës mes Saddam Husejnit – ish aleatit të SHBA-ve dhe Kombeve të Bashkuara të prira nga SHBA-të.

**2003** – Ky vit shënon fillimin e okupimit të Irakut nga forcat amerikane dhe

britanike. Amerikanët nën pretekstin e çarmatosjes së Irakut nga armët bërthamore dhe bashkëpunimin e Sadam Husejnit me Al Kaidan ndërmorën okupimin e Irakut duke hapur një faqe të zeze në historinë e këtij vendi, edhe ashtu i rënduar nga diktatura, pushtimi, luftërat dhe embargot, por irakianët nuk e dinin se “liria” që i priste nga operacioni amerikan do t’i bënte të harrojnë sprovat e mëparshme nga tmerri i të ardhmes.

### **Iraku nën pushtimin amerikan.**

Ushtria amerikane dhe ajo britanike për një kohë të shkurtër arritën ta mundnin ushtrinë irakiane edhe ashtu të rraskapitur. Pas pushtimit në Irak filloi një kaos i vërtetë ku u kryen vjedhjet më të rënda në historinë e njerëzimit, ku u vodhën bankat, muzetë, institucionet vitale shtetërore dhe tërë kjo kryhej nën vështrimin e ushtrisë amerikane dhe britanike.

Nuk kaloi shumë dhe vendit në këtë kaos iu shtuan edhe vrasjet e njëpasnjëshme të civilëve dhe njerëzve të pafajshëm. Gjaku njerëzor u bë më i lirë se kurrë më parë. Njerëzit vriteshin, burgoseshin, plaçkiteshin në mënyrën më mizore për qëllime të ulëta, por që iu paraprinin qëllimet me prapavijë politike, fisnore dhe medhhebore, të cilat hapën në Irak një plagë, e cila vështirë se do të mbyllet ndonjëherë.

Nuk ishin të pakta edhe “gabimet” e ushtarëve amerikanë, të cilët vranë shumë civilë të pafajshëm. Por në këtë kontekst u dalluan kompanitë e sigurimit të kontraktuara nga ushtria amerikane, të cilat përgjigjen për veprimet e tyre vetëm para djallit të mallkuar. Ato shkuan aq larg, saqë edhe kolaboracionistët në Bagdad iu duk se e kishin tepruar sikurse ndodhi me

kompaninë e sigurimit “*Black Water*”. Të gjitha këto e bëjnë Irakun me turp në të tërë njerëzimin e sidomos popullin amerikan dhe britanik, të cilët i kanë promovuar prej një kohë të gjatë të drejtat dhe liritë e njeriut dhe që i rrënuan përmes qeverive të tyre në këto luftëra. Thirrjet për ndryshim janë tepër të vonuara pas kësaj trashëgimie të zeze në Irak dhe shumë të dyshimta, ngase mësimi i Irakut nuk ju mjaftoi, por po e përsërisin të njëjtën histori në Afganistan.

Në tërë këtë mesele u përfshi edhe Irani “Islamik”, i cili pa dyshim bashkëpunoi me Djallin & SHBA - të<sup>7</sup> në tërë këtë masakër e rrëmujë, duke shfrytëzuar irakianët shiitë në ndezjen e fitilit të përçarjes medhhebore. Iranianët qenë të interesuar në një sërë çështjesh: Hakmarrje ndaj pjesëtarëve të BAAS-it, hakmarrje për dhunën e ushtruar ndaj shiitëve gjatë udhëheqjes së Sadam Husejnit, por mbi të gjitha zbatimin e protokolleve shiite, të cilat synojnë në formimin e harkut shiit dhe dominimin përfundimtar në disa nga shtetet më të rëndësishme arabe. Për këtë u mobilizuan të gjithë, saqë edhe Hizballahu libanez gjeti hapësirën e duhur të ushtronte të mirënjohurat “Grupet e vdekjes” në Irak mbi të cilat rëndon përgjegjësia e ekzekutimit të qindra mija civilëve të vrarë.

Në anën veriore të Irakut edhe pse të qetë gjetën fushë të lirë spastrimet etnike ndaj Kurdëve, të cilët qëmoti ëndërronin të kenë një shtet të tyre. Këto spastrime zakonisht prekën pjesën rreth qytetit Kerkuk, ku edhe gjenden fushat e pasura me naftë. Me këtë e filluan kurdët në kurrizin dhe mbi dhembjen e të tjerëve ndërtimin e shtetit të tyre, që tashmë ka statusin e krahinës së Kurdistanit verior.

Pas tërë kësaj është shumë e natyrshme që Sunitët të luftonin për të mbijetuar dhe

<sup>7</sup> Emërtimi i zakonshëm i udhëheqësve iranianë për SHBA -të.

## “Ushtritë amerikane dhe britanike pësuan humbje të mëdha, saqë Amerika edhe sot është në kërkim të një rrugëzgjdhje të shpejtë për të dalë nga ferri i Irakut...”

të bënin rezistencën më të vështirë bashkëkohore. Shifrat që flisnin për këto vrasje arritën kulmin në raportet e vitit 2006, ku flitet për afër 1 milion të vrarë, u shpërngulën rreth 5 milion prej tyre, rreth tre milionë jashtë vendit, numri i jetimëve arriti në 500.000, numri i të burgosurve arriti në 400.000 dhe ekzistonte mundësia e shtimit të këtij numri kohë pas kohe.

Burgjet në Irak nuk dallojnë aspak nga burgjet e inkuizicionit famëkeq dhe mjafton të përmendet emri i burgut Ebu Garib dhe kujtdo prej nesh t'i vijë në kujtesë pamjet e trishtueshme nga ai. Megjithatë administrata e re amerikane dhe e vjetra janë të mendimit të mos publikohen pamje të tjera, të cilat për fat të keq janë edhe më trishtuese nga ato që bota ka parë deri më sot.

Tërë kjo e bëri rezistencën sunitë të pashmangshme, prandaj edhe filloi rezistenca e armatosur. Kjo rezistencë edhe pse jo shumë e organizuar arriti të përbëjë një forcë të pathyeshme dhe të ndryshonte peshoren e forcave në Irakun nën pushtim. Ushtritë amerikane dhe britanike pësuan humbje të mëdha, saqë Amerika edhe sot është në kërkim të një rrugëzgjdhje të shpejtë për të dalë nga ferri i Irakut. Gjithashtu arritën të zbrapseshin edhe pretendimet iraniane për t'i zhdukur sunitët nga toka e Irakut.

Padyshim se kjo rezistencë u përshkua nga gabime dhe përçarje, të cilat e zbehën rolin e saj, por megjithatë ajo arriti të ndalte hovin e shfarosjes së sunitëve nga Iraku, që të sjell ndërmend ngjarjet mes fiseve jo civilizuese të Ruandas gjatë viteve nëntëdhjetë, si dhe ndikoi në ruajtjen e unitetit të shtetit të Irakut.

### **Politika bashkëkohore irakiane:**

Pas pushtimit qeverisja amerikane formoi Autoritetin e Përkohshëm të Koalicionit, i cili e udhëhoqi vendin për një vit. Ky Autoritet u formua kryesisht prej Irakianëve, që kishin qenë opozitë jashtë vendit dhe në një mënyrë apo tjetër kishin përgatitur terrenin për ndërhyrjen e forcave amerikane dhe britanike në Irak. Në mesin e vitit 2004 u transformua në qeverinë e përkohshme të Irakut dhe në 2005 u transformua në qeveri të përhershme.

Qeveria federale e Irakut në bazë të kushtetutës së tanishme është përcaktuar si një: republikë islamike, demokratike dhe parlamentare. Qeveria federale nga ekzekutivi, legjislativi dhe gjyqësori.

Kushtetuta irakiane u miratua më 15 tetor 2005 nga një pjesë e madhe e votuesve, të cilët përbëheshin kryesisht nga votuesit e grupit Shiit dhe Kurdët, ndërsa u refuzua me forcë nga Sunitët. Pas miratimit pasuan zgjedhjet, të cilat pasqyruan nivelin e madh të ndarjes, që kishte ndodhur mes tri grupeve kryesore Sunitëve, Shiitëve dhe Kurdëve. Realisht Sunitët për shkak se ishin të ndarë rreth pjesëmarrjes apo jo në zgjedhje rezultuan me një përfaqësim të dobët në qeverisjen e vendit.

Qeveria e tanishme e Irakut është kryesisht e përbërë nga pjesëtarë të shtetit Shiit dhe Kurdë. Udhëheqësit e saj kanë një histori të zezë në këto vite të pas-pushtimit jo vetëm për atë se përfaqësojnë agjenda të

huaja kryesisht amerikane dhe iraniane, por edhe për korrupsionin dhe padrejtësinë e ushtruar ndaj popullit të tyre gjatë këtyre viteve.

### **Jeta fetare në Irak:**

Islami është feja dominuese në Irak, ku rreth 97 % e popullsisë janë muslimanë dhe 3 % janë pjesëtarë të feve të tjera. Në këtë përbërje fetare numrat që përcaktojnë sa janë Sunitë e sa i takojnë sektit Shiit janë kundërthënës ndërmjet tyre. Thuhet se 60 % janë shiitë dhe 40 % janë sunitë, por këto shifra mund të mos jenë të sakta, sidomos pas asaj që thuhet se në llogari nuk janë futur Kurdët, të cilët janë tërësisht sunitë.

**Sunitët:** Përbëjnë përafërsisht gjysmën e banorëve të Irakut dhe ata e përfaqësojnë Islamin real me të cilin u çua i Dërguari Muhamed (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të).

**Shiitët:** Janë sekti më i madh fetar islam, i cili është ndarë nga mësimet parimore islame qysh herët. Mësimet e këtij drejtimi nuk përkrijnë me mësimet islame dhe janë të pabazuara dhe të paargumentuara. Rrënjët e besimit të tyre kthehen te besimet e mëhershme, si ato të krishtere dhe jehudike, por edhe në besimet zjarrputiste, të cilat mbizotëronin në Iranin-Persinë e atëhershme.

Fillimi i shfaqjes së tyre në masë dhe shtimi i tyre në Irak ka ndodhur nga fundi i Perandorisë Osmane. Në Irak si çdo kund tjetër ata njihen si simbol të besëtytnive fetare për këtë edhe janë të dhënë pas varrezave dhe faltoreve të tyre të ndërtuara mbi varreza. Si dëshmi për besëtytnitë e tyre mjafton të shihen sjelljet ditën e dhjetë të Muharremit, ku ata vajtojnë për tradhtinë e tyre ndaj Husejnit – nipit të

“Nafta është një nga shkaqet e përgatitjes për luftë në Irak. Nëse ndonjë person dëshiron të na bindë me të kundërtën definitivisht ai nuk respekton logjikën tonë...”

Pejgamberit (paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të) dhe që e godasin veten e tyre me zinxhirë e sende të ngjashëm.

Ata kanë qenë në krye të dhunës sektare në Irak dhe i janë mbështetur besimit, se sa më shumë të ketë çrregullim në tokë, aq më shpejt do të afrohet dalja e Mehdiut – imamatit të dymbëdhjetë, i cili sipas tyre është fshehur dhe del me rastin e shtimit të së keqes.

Dhuna e arriti kulminacionin e saj kur u eksplodua Mekami<sup>8</sup> të dy imamëve El Hadi dhe El Askerij ne Samurra në shkurt të 2006. Edhe pse nuk dihej se kush e ka bërë këtë megjithatë shiitët ndërmorën hap të guximshëm duke akuzuar sunitët për këtë pasi që Mekami ndodhej mes Sunitëve. Mu për këtë rrënuan me qindra xhamia dhe vranë civilë dhe udhëheqës fetarë të pafajshëm.

**Kurdët:** Për sa i përket kurdëve ata i përkasin drejtimin Suni por i kemi veçuar me qëllim që të tregojmë se nuk përbën ndonjë grup të veçantë fetar, por kërkesa e tyre për një shtet ku do të mblidheshin rreth tij i ka bërë të dallohen nga sunitët e tjerë arabë. Ata përbëjnë rreth 20 % të popullsisë.

**Asirianët së bashku me Armenët:**

<sup>8</sup> Mekam është varri ku është i varrosur në të një nga 12 imamët e tyre dhe pastaj ngritët mbi të një ndërtesë. Atz vizitohet varri dhe bëhen besëtytni të shumta që kryesisht lidhen me hyznizimin e atij të vdekuri.



• **Rrënimi i xhamive nga ekstremistët shiitë në kulminacionin e dhunës sektare**

Përbëjnë shumicën e popullsisë së krishterë në Irak.

**Ekonomia e Irakut:**

Ekonomia e Irakut dominohet kryesisht nga të ardhurat e naftës, e cila u zbulua në Irak qysh në vitin 1927 në Kerkuk dhe Iraku është vendi i dytë në botë për rezervat e naftës, të cilat llogariten të jenë më tepër se 200 miliardë fuçi dhe shumë puse të naftës edhe sot e asaj dite janë të pashfrytëzuara. Vlen të theksohet se këto rezerva të naftës kanë qenë ndër shkaqet kryesore të pushtimit të tij, sepse armët bërthamore që në fillim dihej se nuk ekzistonin në Irak, për këtë edhe Tomas Fridman në vitin 2003 në “Herald Tribune” në artikullin e tij thoshte: *“Nafta është një nga shkaqet e përgatitjes për luftë në Irak. Nëse ndonjë person*

*dëshiron të na bindë me të kundërtën definitivisht ai nuk respekton logjikën tonë.”*

Edhe pse Irakut i janë falur shumë borxhe nga e kaluara megjithatë vazhdon shfrytëzimi i tij në forma të ndryshme, sidomos për ato që lidhen me naftën dhe derivatet e saj. Iraku prodhon gjithashtu edhe grurë, oriz, si dhe përbën rreth 80 % të eksportit botëror të hurmave.

Një gjë që e rëndon edhe më tepër ekonominë irakiane është se nga luftërat e shumta Iraku ka trashëguar një infrastrukturë të dëmtuar rëndë, e cila edhe pse Iraku si shtet i pasur me naftë e ka të vështirë ta riparojë për një kohë të shkurtër. ■

■ Të dhënat kryesisht mbështeten në librin: “Atlas i Shteteve Islame” i Dr. Shevki Ebu Halil, enciklopedinë botërore wikipedia.org në anglisht dhe arabisht, si dhe dosjen Iraku pas gjashtë vitesh në ueb sajtin e mirënjohur: islamtoday.net

# BESËTYTNITË JANË SHIRK

NGA: ALI SHABANI

**Pyetje:** Si është halli i atyre besimtarëve, që deklarohen se janë besimtarë muslimanë, por besimin e tyre e njollosin me besëtytni të ndryshme?

**Përgjigje:** Edhe pse besimtarët besojnë në Allahun xhele shanuhu, ata ndodh që ta njollosin besimin e tyre me besëtytni të ndryshme dhe kjo ndodh si rezultat i padijes së tyre, mosnjohjes së akides, rregullave të besimit islam të bazuara në njësimin e Allahut xhele shanuhu. Allahu i Lartmadhëruar ka thënë: *“Shumica që i besojnë Allahut, i bëjnë shirk (i shoqërojnë Atij shok)”* Jusuf 106; pra, ka prej atyre që e kanë ditur se Allahu është Zoti, Krijuesi i gjithësisë, por megjithatë u kanë besuar idhujve. Allahu i Lartmadhëruar thotë: *“Nëse ti i pyet ata: ‘Kush i krijoi qiejt e tokën, kush i nënshtroi (të lëvizin) diellin dhe hënën?’ Ata do të thonë: ‘Allahul’* Ankebut 61, mirëpo Adhurojnë tjetërkënd. Ata thoshin: *“...Ne nuk i adhurojmë ata për tjetër, vetëm që të na afrojnë sa më afër Allahut,...”* Zumer 3. Këta e kanë besuar Allahun, por adhurojnë dikë tjetër. Kështu ngjashëm është halli i atyre, që edhe pse

deklarohen si besimtarë, por besojnë në disa besëtytni si për shembull, rrëzohet fëmija dhe i thonë fëmijës “pështy në vendin ku je rrëzuar se do të rritesh”; kur e vesh rrobën mbrapsht, thotë “do të gëzohem”; nëse i pret udhën ndonjë mace (e zezë) kthehet mbrapsht, duke menduar se mund t’i ndodhë ndonjë gjë e keqe. Të gjithë këto vepra janë nga besëtytnitë, gjegjësisht shirk. Mirëpo na duhet të përmendim këtu se ky lloj shirku është nga shirku i vogël me të cilin nuk del nga feja, por megjithatë është shirk, besëkotësi dhe janë nga njollat (mëkatet) më të këqija, që e njollosin shpirtin.

**Pyetje:** Shumë gra shtëpiake kur pinë kafe, pasi mbarojnë pirjen e kafes, i kthejnë filxhanët dhe presin pak kohë që të thahen mbeturina e kafes dhe pastaj prej vijave që formohen në brendësinë e filxhanit bëjnë komente për gjendjen, apo të ardhmen e ndonjërës (it). A lejohet një gjë e tillë?

**Përgjigje:** Kjo është ajo që në trojet tona i thonë fall, ajo që Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e ka quajtur “kehane”. Na përcjell Buhariu nga Aishja, se Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë:

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen. Pyetjet mund t’i dërgoni në [albislam@gmail.com](mailto:albislam@gmail.com)



“Melekët zbresin në afërsi të reve dhe përmendin ndonjë gjë që është caktuar (nga kaderi), e shejtanët e vjedhin atë me dëgjim dhe me atë i frymëzojnë fallxhorët, e me atë (një të vërtetë), u ngjisin njëqind gënjeshtër nga vetja e tyre (d.m.th., shejtanët).” Ata njerëz, janë të paditur ndaj fesë islame dhe parimet e saj dhe merren me kësi far besëtytnish, të cilat janë shumë të dëmshme. Asnjëherë njeriu që ka sado pak logjikë të shëndoshë, nuk duhet t’ia lejojë vetes që t’i besojë vijave që formohen në filxhanin e kafes, apo komenteve të fallxhoreve që i bëjnë sipas vijave në shuplakën e dorës. Për dëmin e besëtytnive të fallxhorëve Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* ka thënë: **“Kush shkon te fallxhori nuk i pranohet namazi dyzet ditë, e kush i beson, ai e ka përgënjeshtuar atë që i është zbritur Muhamedit.”**

**Pyetje:** A lejohet të shkohet te këta fallxhorë me qëllim për t’i zbuluar dhe për t’i ndaluar nga kjo vepër e shëmtuar?

**Përgjigje:** Nëse bëhet me këtë qëllim – Allahu e di më së miri – lejohet. Edhe dijitari i shquar Muhamed Salih Uthejmini në fetvatë e tij ka thënë se lejohet të shkohet te fallxhori për ta provokuar dhe për t’ia zbuluar manipulimet që bën ndaj njerëzve, kështu që të dali e vërteta në shesh. Për këtë gjë është argumentuar me rastin kur Ibën Sajadi (për të cilin mendonin se është dexhalli) shkoi te Pejgamberi dhe ai, *sal-lallahu alejhi ue selem*, mendoi diçka me vete dhe pastaj e pyeti: **“Çfarë kam fshehur (në mendje)?** Ai tha: Tým. Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*, i tha: **Largohu se nuk do të rritet nami kurrë.”**

**Pyetje:** Nëse na pyet dikush se ku gjendet shtëpia e ndonjë fallxhori, a na

**lejohet t'ia tregojmë?**

**Përgjigje:** Jo, nuk lejohet t'ia tregosh, as ku është shtëpia e fallxhorit, as të tregohet se ku është kisha, e ku gjendet ndonjë vend ku dihet se ai vend njihet me shirk dhe haram, se nëse i tregon këto vende pyetësit, atëherë bëhesh pjesëtar në mëkatet që do të bëjë ai. Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Ai që tregon (udhëzon) për në veprat e hairit, është si ai vepruesi.” Pra, po e njëjta gjë vlen për atë që tregon, udhëzon dhe i orienton njerëzit në veprat e sherrit. Allahu na ruajt!

**Pyetje:** Shumë të rinj ndjekin komentet për të ardhmen e tyre në horoskopet e revistave të ndryshme. A lejohet të lexohen këto horoskopë?

**Përgjigje:** Horoskopi paraqet njoftime (të rrejshme), që kinse i caktojnë sipas yjeve dhe sipas datëlindjes (prej x datës – deri në x datë) janë gjë e caktuar në atë horoskop. P.sh., ka që sipas datëlindjes janë demi, e tjetri cjapi, e kështu me radhë. Allahu e ka krijuar njeri, e yjet i thonë se është dem. Pastaj aty fusin gënjeshtër, që i sajojnë vetë këta manipulues dhe ky është falli modern. Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Kush merr dituri nga yjet (për të komentuar të ardhmen e dikujt), ai ka marrë një degë nga sihri (magjia).” Pasojat e leximit të horoskopit janë të njëjta me shkuarjen te fallxhorët. E njëjta gjë vlen edhe për ato kanale televizive, ku dalin gra fallxhore dhe hedhin fall me letra, apo kërkojnë t'ua tregosh datëlindjen e pastaj të tregojnë për të ardhmen. Allahu na ruajt nga sherri i tyre.

**Pyetje:** Çfarë mund të na thoni në lidhje me disa njerëz, po edhe besimtarë muslimanë, ndërrojnë kahen e tyre,

gjegjesisht ndërrojnë qëndrimin e tyre kur i ndodh ndonjë gjë, apo kur i del diçka përpara, si për shembull macja (e zezë).

**Përgjigje:** Besimtari musliman, i cili i ka besuar Allahut dhe ka besuar në kada dhe kader, nuk bën ta njollosë besimin e tij me kësi far paragjykimesh. Mushrikët mekas e kanë pasur nga besimi i tyre, që para se të udhëtojnë, të shohin një zog nga do të fluturojë. Nëse ka fluturuar nga ana e djathtë, kanë udhëtuar, e nëse ka fluturuar nga ana e majtë e kanë shtyrë udhëtimin. Në gjuhën arabe zogut i thonë “tajr” dhe nga kjo e kanë quajtur “tijere” këtë bindje të tyre. Me ardhjen e Islamit kjo besëtytni është zhdukur në mesin e arabëve muslimanë. Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*, në lidhje me këtë ka thënë: “Et-tijeretu (oguri) është shirk”. Po ashtu ka thënë: “Zogu fluturon sipas kaderit”, për t'u treguar atyre se zogu nuk fluturon për t'u treguar njerëzve, se a duhet të udhëtojnë, apo jo. Kështu duhet që një herë e përgjithmonë muslimanët të kuptojnë se edhe macja (e zezë) bredh sipas kaderit të Allahut e jo për t'i dhënë shenjë dikujt se duhet të kthehet nga rruga që ka marrë, apo jo.

**Pyetje:** Si i trajton Sheriati këta njerëz që përhapin besëtytni ndërmjet besimtarëve muslimanë?

**Përgjigje:** Ata që fusin besëtytni ndërmjet besimtarëve muslimanë, së pari duhet të këshillohen, e nëse nuk ndalin, atëherë në shariat ka dënime të papërcaktuara (Tazir) dhe të përcaktuara (Hudud). Për ato raste që besëtytnia është nga shirku vogël, si p.sh., të besosh se nëse macja e zezë nëse ta pret udhën, nuk duhesh të vazhdosh, se ka për të ndodhur ndonjë gjë e keqe, dënimi jepet nga lloji tazir dhe këtë e cakton kadiu. Nëse është nga besëtytnitë ku kryhet shirku i madh, si



sihri, ai që merret me sihër ekzekutohet aty ku kapet. Dhe këtë e kryejnë organet kompetente të shtetit islam. Për sa i përket fallxhorit, Ebu Mesudi *radjallahu anhu* ka thënë se Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem, ka ndaluar nga kundërvlera e qenit, mehri i lavires dhe bakshishi për fallxhorin.*

**Pyetje:** Nëse biem në ndonjë besëtytni si duhet të pendohemi, a ka ndonjë dua të veçantë për këtë?

**Përgjigje:** Për çdo gjë që është mëkat duhet të pendohemi. Sa u përket besëtytnive, si “tijere” Abdullah ibën Mesudi ka thënë: “*Secili prej nesh domosdo...*”, që nënkuptohet se kushdo prej nesh mund të bjeri në kësi far besëtytnish, pa e hetuar. Nëse mëkati ka qenë nga besëtytnitë, si oguri, atëherë duhet bërë kjo dua: “*Allahume la tajre il-la tajruk ue la hajre il-la hajruk, ue la ilahe gajruk.*”, që d.m.th., “*O Zot, s’ka ogur përveç asaj që Ti vendos, s’ka të mirë, përveç të mirës Sate dhe s’ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Teje.*” E kur dyshojmë se kemi bërë ndonjë mëkat që mund të jetë shirk, atëherë duhet bërë kjo dua: “*All-llahumme inní eudhu bike en ushrike bike ue ene ealemu ue estagfiruke lima la ealemu.*”, që d.m.th.: “*O Zot, kërkoj mbrojtje te Ty nga shirku, të cilin e di dhe kërkoj faljen Tënde për atë që nuk e di.*”, sepse Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Shirku në umetin tim është më i fshehtë sesa ecja e milingonës në sipërfaqen e zezë në natën e errët.”*

**Pyetje:** Çfarë do të na thoni në lidhje me disa njerëz që shtiren si hoxhallarë, por ata mbështjellin nuska, apo hajmali dhe ua japin atyre që i ka goditur ndonjë sprovë kinse ajo hajmali do t’i mbrojë, apo do t’ua largojë atë sëmundje, apo sprovë?

**Përgjigje:** Së pari, ata nuk janë hoxhallarë, edhe pse shtiren se janë të tillë dhe ndoshta punojnë në institucione islame, apo ushtrojnë detyrën e imamit në xhami. Këta janë dexhallët e vegjël, që jetojnë në kohët e sotme para se të dalë ai “i madhi”. Besimtarët nuk duhet t’ia lejojnë vetes të bien në kurthet e këtyre manipuluesve. Këta janë ata që i ka përmendur Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem, në hadithin: “...e shesin fenë për interesa të kësaj dynjaje”, Allahu na ruajt neve dhe gjithë besimtarëve nga sherri i tyre.*

**Pyetje:** Disa vendosin nëpër dyert e tyre (në shtëpi), apo nëpër vetura patkonj, duke menduar apo thjesht janë të besimit se do t’u sjelli fat. Si është e vërteta e kësaj pune?

**Përgjigje:** Patkoi është vetëm patkua dhe jo ndonjë gjë tjetër, apo të shërbejë për gjëra të tjera. Ai shërben për ta mbathur kalin. Ata që mendojnë, apo besojnë se patkoi sjell fat, le të mendojë mirë se kali i vet ka pasur katër patkonj, e çfarë fati i ka sjellë?!... Pra, për njeriun është nënçmim që patkoin e kalit ta vari në veturë, apo në derën e shtëpisë kinse po i sjellka nafakë (fat). Po të ishte kështu do të ishte më e arsyeshme të vendosë këpucën e vet, e jo të kalit? Këto janë besëtytni, besëkotësi, d.m.th. shirk.

E njëjta gjë vlen për brirët e dashit, “syrin e kaltër” që e mbajnë kinse i mbron nga mësyshi, druri i frashrit e kësi far gjërash të ngjashme. Këto janë besëtytni të paganëve nga kohët e lashta, prandaj duhet t’i shmangemi atyre. ■

# HISTORIKU I ISLAMIT NË KINË

Në vitin 323h/943m ndodhi një zhvillim shumë i madh në rajonin e Turkestanit perëndimor, kur pranoi Islamin Stok Bugurhani, i cili ishte lider i një fisi turk. Me pranimin e Islamit nga ai e pranuan më pas Islamin më shumë se 200.000 familje turke

**DR. RAGIB SERXHANI**

Umetit islam sot po i kanosen kriza të shumta, përderisa sapo mbyllim një dosje po hapim një tjetër e ndoshta mund të hapim disa dosje njëkohësisht. Problemi i Palestinës, problemi i Irakut, problemi i Sudanit, problemi i Somalisë etj. Problemet e muslimanëve kudo që janë në botë janë zgjeruar aq shumë, saqë nuk ka shpresa për përmirësim. Ky demoralizim është real, por jo nga pikëpamja e kuptimit të shariatit, sepse ne si besimtarë besojmë se çdo gjë është në dorën e Allahut. Kur ne do ta arrijmë përmirësimin tonë me siguri që do të vijë fitorja e Allahut, në atë mënyrë si do Ai dhe ashtu si është optimale për kohën tonë. Ashtu sikurse shkenca e historisë na vërteton se fitorja arrihet me durim, dhe se pas çdo vështirësie vjen lehtësimi, dhe se agimi vjen pas errësirës.

E fillova kështu që të mos shkaktoj dëshpërim në zemrat e muslimanëve, kur ne trajtojmë një fatkeqësi të re prej fatkeqësive



të shumta, që po i ekspozohen umetit islam. Bëhet fjalë për fatkeqësinë e muslimanëve, që jetojnë në rajonin e Turkestanit lindor. Problemet e këtij rajoni ku jetojnë muslimanët i kanë rrënjët shumë të thella. Për ta kuptuar ngjarjen e këtij vendi më mirë është e domosdoshme që t'i hyjmë problemit që në thelb. Na duhet të bëjmë patjetër një shpjegim mbi historinë e Islamit në Kinë në mënyrë të përgjithshme. Po ashtu është e domosdoshme të kemi një pasqyrë mbi tokën e Turkestanit, që kufizohet me Kinën, të njihemi me traditat e popullit dhe vendit ku ata jetojnë.

Togfjalëshi Turkestan përbëhet prej dy fjalëve "turk" dhe "stan", që do të thotë: 'toka e turkut'. Krijohet një pështjellim mes popullit turk dhe osmanli. Shumë njerëz i pështjellojnë fjalët turk dhe osmanli, duke menduar se fjala turk është sinonim i fjalës osmanli. Realiteti është se çdo turk ka qenë osmanli dhe jo e kundërta.

Turqit janë popuj, që jetojnë në rajonin e Azisë së mesme, në malet e Kaukazit, përreth

detit Kaspik. Disa prej tyre emigruan në vende të largëta sikurse osmanlinjtë, të cilët emigruan në Azinë e vogël (Turqia e sotme), mirëpo të gjithë e ruajnë identitetin e tyre (originën turke). Kjo na e bën të qartë optimizmin e popullit turk në veçanti me problemin e muslimanëve në Kinë, të cilët i bashkon origjina krahas ndjenjave fetare islame.

Historianët e ndajnë tokën e Turqisë në dy pjesë të mëdha, Turkestani lindor, që është nën sundimin e Kinës së sotme dhe Turkestani perëndimor, që është një hapësirë më e madhe, në të cilën futen shumë republika, si: Kazakistani, Uzbekistani, Turkmenistani, Kirgizistani dhe Takhikistani. Po ashtu këtu bënë pjesë një pjesë e madhe e tokave të Afganistanit dhe Iranit.

### Zanafilla e Islamit në Turkestan

Islami në Turkestan është futur qysh në kohën e Omerit *radijallahu anhu* dhe Osmanit *radijallahu anhu*, ku popujt e këtij vendi e kanë pranuar Islamit gjerësisht dhe kështu prej Turkestanit perëndimor janë transferuar karvanët e thirrësve dhe tregtarëve në pjesën lindore të Turkestanit dhe kështu arritën deri në Kinë, ku edhe filloi të zgjerohet Islami. Po ashtu gjatë dinastisë emevite u dërguan përfaqësuesit e Islamit në Kinë, deri në 16 delegacione ka arritur numri i atyre, që u kanë bërë thirrje në Islam.

Ja vlen të përmendim se muslimanët në periudhat e para kanë jetuar në shoqërinë kineze së bashku me budistë dhe besime të tjera, në një formë shumë të shëndoshë pa pasur acarime dhe probleme të tjera fetare apo politike.

### Islami i Stok Bugurhan dhe përhapja e Islamit

Në vitin 323h/943m ndodhi një zhvillim shumë i madh në rajonin e Turkestanit

“Shumë njerëz i pështjellojnë fjalët turk dhe osmanli, duke menduar se fjala turk është sinonim i fjalës osmanli. Realiteti është se çdo turk ka qenë osmanli dhe jo e kundërta...”

perëndimor, kur pranoi Islamit Stok Bugurhani, i cili ishte lider i një fisi turk. Me pranimin e Islamit nga ai e pranuan më pas Islamit më shumë se 200.000 familje turke, që na përkujton kështu historinë e sahabiut të nderuar Sad Ibën Muadhrit, kur fisi Eus i Medinës e pranoi Islamit për shkak të tij. Me këtë njeri u ngrit në rangun e një fuqie të madhe Turkestani në pjesën perëndimore. Po ashtu filloi të ngrihet në aspektin e civilizimit e sidomos me ardhjen në pushtet e nipit të Stok Bugurhanit, i cili një të pestën e tokës pjellore e la vakëf për ndërtimin e shkollave dhe medreseve islame.

### Uzuprimi tartaro-mongol

Ndërsa vazhdonte përhapja e Islamit në këto vende bota pësoi një goditje të madhe nga zullumqari mongol Xhingiz Kani në vitin 603h/1206m. Në këtë vit Turkestani lindor përjetoi ndeshjen e parë me Tartarët, nga të cilët përjetuan disa masakra dhe shumë shpejtë Turkestani hyri nën sundimin e tartarëve. Elementi tjetër që shkaktoi humbjen fatkeqe të Turkestanit është se bota islame në mënyrë globale ishte kapluar nga një dështim total. Pas vdekjes së Xhingiz Kani pati një përplasje mes pasuesve të tij, deri sa u arrit në përfundimin, që ta ndajnë perandorinë tartare në disa pjesë. Prej kësaj ndarje ajo që na intereson janë dy pjesë.

**Pjesa e parë** përfshin Mongolinë dhe Turkestanin lindor, ku me kalimin e kohës

filluan të përmirësohen raportet e tartarëve me muslimanët deri sa erdhi puna që njëri nga liderët tartarë ta pranojë Islamin.

**Pjesa e dytë**, që na intereson neve dhe që lidhet me temën është rajoni i Kinës, i cili u fut nën sundimin Kubilaj ibën Tulu Hanit, ku si kryeqytet caktoi qytetin Han Balig, kurse Pekini u caktua si kryeqytet më vonë.

Ajo që na mahnit më shumë është se ky shtet fillimisht ka pasur me muslimanët raporte shumë të mira dhe kanë pasur respekt të veçantë ndaj muslimanëve. Familja e Kubilaj Hanit filloi t'i shfrytëzojë muslimanët në administratën e përgjithshme dhe në pozita të larta. Ndër muslimanët më të njohur, që pati pozitë të lartë ishte Shemsudin Omeri, i cili nga oficer ushtarak më vonë arriti në pozitën e gjeneral armate në qytetin e Tajvanit e pastaj u bë gjykatës në Pekin. Shemsudin Omeri në këtë periudhë u angazhua në ndërtimin e një numri të madh shkollash dhe medreseve fetare në Kinë. Shumë prej xhamive që janë ndërtuar janë ndërtuar në kohën e mongolëve.

Kjo familje mongole vazhdoi të sundojë Kinën deri në vitin 1368, kohë kur sundimi ra në dorën e kinezëve konkretisht në dorën e një familjeje të njohur, që sot quhet dinastia Ming dhe që e shtrinë ndikimin e tyre jashtë Kinës deri në Turkestanin lindor.

### **Persekutimi i muslimanëve gjatë kohës së dinastisë Mançu (viti 1643)**

Në vitin 1643 u formua një shtet i ri kinez, që u vu nën sundimin e dinastisë Mançu i cili krijoi raporte të reja me muslimanët. Këto ishin raport me karakter të vrazhdë dhe të ashpër, dhe kështu në vitin 1648 pas një përplasje realizuan vrasjen e 5000 muslimanëve. Kjo dinasti gjithashtu u mundua disa herë të pushtojë rajonin e Turkestanit lindor, mirëpo orvatjet e tyre dështuan.

Në vitin 1759 fisi Mançu erdhi në fuqi dhe arriti të pushtojë Turkestanin lindor dhe kështu mbeti nën okupimin kinez më shumë se dhjet vjet, mirëpo për një kohë të shkurtër u çlirua nga ky okupim dhe brenda 13 vjetëve u vendos sundimi islam.

Në vitin 1876 Anglia e përkrahu Kinën që ta pushtojë Turkestanin dhe menjëherë pas pushtimit filluan procedurat për ndryshimin e emrit nga Turkestan në provincën e Sinkijangut.

### **Sundimi republikan dhe pranimi i muslimanëve**

Në vitin 1911 me anën e revolucionit u arrit rënia e shtetit Mançu, ku muslimanët dhanë një përkrahje të madhe, që të merret pushteti në dorë nga republikanët, të cilët qysh në ditët e para i pranuan muslimanët ndër popujt kryesorë në Kinë.

### **Autonomia e Turkestanit lindor**

Shteti kinez pati një luftë të madhe me Japoninë në fillim të shekullit të kaluar, ku ushtria japoneze arriti deri në kryeqytetin kinez Pekin në vitin 1925, dhe u masakruan me mijëra kinezë. Në këtë kohë muslimanët e Turkestanit e shfrytëzuan rastin, që të arrijnë një autonomi dhe të formojnë shtetin islam në vitin 1933. Menjëherë pas një viti Kina lidhi një marrëveshje me Rusinë, që ta sulmojnë Turkestanin për ta kthyer nën okupim. Pastaj gjatë Luftës së Dytë Botërore në vitin 1949, si përfundim vjen në pushtet sistemi komunist.

Kjo ishte një përmbledhje e historikut të Islamit në Kinë në shekujt e kaluar, ku tashmë në fund sistemi komunist përdori mjete nga më të ndryshmet për të eliminuar identitetin islam në rajonin e Turkestanit.

Nuk na mbetet gjë tjetër veç ta lusim Allahun, që ta ngrejë Islamin dhe muslimanët kudo që të jenë. ■

**Përktheu: Bedri LIKA**